Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 6 (98). QERSHOR 2014. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.



Market KEN

Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

KRYESORE

Rruga e Arbërit, shumë informacione për asgjë...

Nga **BUJAR KAROSHI** - FAQE 7

INVESTIMI

Albcrome, 20 milionë USD për minierën

Nga **HYSEN LIKDISHA** - FAQE 6

DEBAT

A janë dibranët pasardhës të Doberëve?

Nga **GAFUR ZOTA** - FAQE 18-19

BLOGER

- Ç'kemi asaj Dibre!
- Lapidar për makinat...
- Ditari i një vajze: "Sania"

FAQE 17

SPECIALE MBI SHKOLLIMIN DHE PUNËN E FËMIJËVE

Të shpëtojmë fëmijët nga shfrytëzimi dhe errësira e analfabetizmit

- Zhytur në varfëri, fëmijëve të zonave rurale u mungon e drejta për arsimim
- Vdekje, mjerim dhe fëmijët në industrinë minerare shqiptare
- Puna e fëmijëve në Shqipëri i heq shkëlqimin industrisë së kromit

Nga mungesa e shkollimit të fëmijëve te puna mbi stoqet e kromit


Nga **BUJAR KAROSHI, AXEL KRONHOLM dhe HANE BURNETT**

Speciale në faqet 2,3,4,5



Interviste me shkrimtarin Agim Vinca

Në Dibër të Poshtme gjeta rrënjët e të parëve të mi



Nga krijuesit e sotëm dibranë do të përmendja, në radhë të parë, Agron Tufën, një krijues tejet i talentuar e me energji të pashtershme krijuese: poet, prozator, sudiues, përkthyes, publicist etj., krijimtarinë e të cilit përpiqem ta ndjek rregullisht. E marr shpesh në dorë sidomos librin e tij me poezi *Avangardë engjëjsh*, me elegjitë brilante romake e strofat e lëmuara vjeneze dhe posaçërisht me baladat e mrekullueshme të Drinit të Zi - nga veprat letrare të tij, si dhe librin *Stacioni në shkretëtirë të Brodskit* - nga përkthimet dhe pres me padurim përkthimin tashmë të paralajmëruar të poezive të Mandelshtamit në shqip...

Xhafer Martini ka bërë punë të çmueshme në fushën e etnokulturës së Dibrës, trevë kjo që është një thesar i vërtetë në këtë plan: në gjuhë, në folklor, në etnografi, në kodin zakonor etj. Kam lexuar një libër të tij me titull *Optika e Schmitt-it për Skënderbeun*... Po ta kishte shkruar dikush tjetër këtë libër, ndonjë krijues më pranë vëmendjes së medias dhe të institucioneve, do të kishte pasur jehonë shumë më të madhe se ç'pati në të vërtetë dhe se ç'meriton të ketë.

Përshtypje të veçantë më ka bërë edhe romani *Bibollasit* i Ramiz Gjinit, dibran edhe ky, që jeton në Amerikë; një roman satirik *par excellence*, i cili fshikullon pa pardon, por në mënyrë mjeshtërore, me një sarkazëm të tipit gogolian e suiftian, trillet e tranzicionit shqiptar dhe keqpërdorimin e njeriut nga pushteti "demokratik" sot, sikundër edhe nga ai autokratik diktatorial dikur.

Nga **MENTOR HOXHA** - FAQE 9

vleresim

Ambasada e Izraelit në Tiranë nderon Prof.dr. Shaban Sinanin

Ambasada e Izraelit në Shqipëri ka nderin t'i japë këtë mirënjohje Prof. Shaban Sinanit, në shenjë vlerësimi për studimin e vazhdueshëm, përgjatë dy dekadave, të burimeve mbi marrëdhëniet ndërmjet shqiptarëve dhe hebrenjve, studim që arriti majat me botimin e veprës së tij monumentale mbi mbrojtjen dhe shpëtimin e hebrenjve gjatë Holokaustit.

FAQE 15

cyan magenta yellow black 1


Detyrimi për t'i arsimuar është po aq i madh se ai për bukë, thonë aktivistët, ndërsa kërkohet më shumë vëmendje ndaj braktisjes së shkollës për shkaqe ekonomike.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 6 (98). 1 - 30 Qershor 2014

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.
Njoftojmë zotërinjtë: Xhafer Martini, Sejdi M.Gashi, Ahmet Çaushi, Selman Mëziu, Haki Përnezha, Mentor Hoxha, Dali Tërshalla,, se shkrimet e tyre janë në redaksi dhe do të shqyrtohen për botim në numrat e ardhshëm.
Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.
Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**
JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".
Gazeta publikohet falas në internet me datë 7 të muajit pasardhës.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!



KËSHILLI BOTUES:

Musa RIÇKU
Bujar KAROSHI
Shaqir SKARRA

Kontribuan për këtë numër:
Axel KRONHOLM
Hane BURNETT
Naim ZOTO
Xhafer MARTINI
Gafur MUKA
Gafur ZOTA
Moisi MURRA
Hysen REPA
Ilir SINANAJ
Hysen LIKDISHA
Mevlud BUCI
Xhelal ROÇI
Besnik ALKU
Qamil SULA
Mentor HOXHA
Beqir SINA

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Nga **BUJAR KAROSHI***

Emrahi, një djalosh 15 vjeçar nga një fshat i Dibrës, 180 km larg Tiranës, i gëzohet shumë pranverës, pasi ai ka mundësi të punojë dhe të sjellë të ardhura për familjen. Ai nuk e di çfarë janë 1 Qershori, 12 Qershori apo 20 Nëntori. Ndërsa për të janë thjeshtë data në kalendar, për bashkëmoshatarët e tij dhe fëmijët e tjerë, janë ditët kur sensibilizohet ndalimi i dhunës, abuzimit, kundër punës dhe të drejtave të tyre.

Në këto data dhe të tjera ditë ndërkombëtare që kanë lidhje me grupe të caktuara fëmijësh, mediat krijojnë një hapësirë të veçantë për ta dhe interesohen më shumë se kurrë për të drejtat e tyre -- ku ndër më të rëndësishmet është e drejta për arsimim, që garantohet jo vetëm nga Kushtetuta e Shqipërisë, por edhe nga një numër i konsiderueshëm i konventave ndërkombëtare, të cilat Shqipëria i ka miratuar.

Ndërsa në Shqipëri veprojnë një sërë organizatash për të ndihmuar komunitet në nevojë, si p.sh. romët apo fëmijët e ngujuar, fëmijët e zonave rurale, shpesh herë të zhytur në varfëri, nuk kanë gjetur ende mbështjetje për të drejtën primare për arsimim.

Sipas statistikave zyrtare të Ministrisë së Arsimit, në janar 2012 e kanë braktisur shkollën në arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar në gjithë Shqipërinë mbi 1400 fëmijë, shumica e të cilëve vjen nga familje të varfra. Atyre u shkelet e drejtat themelore për arsimim. Por për qarkun e Dibrës kjo statistikë tregon numrin zero, që, në fakt, nuk është e vërtetë bazuar mbi raportimin në terren.



Foto © Bujar Karoshi

Sipas statistikave zyrtare të Ministrisë së Arsimit, në janar 2012 e kanë braktisur shkollën në arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar në gjithë Shqipërinë mbi 1400 fëmijë, shumica e të cilëve vjen nga familje të varfra. Atyre u shkelet e drejtat themelore për arsimim. Por për qarkun e Dibrës kjo statistikë tregon numrin zero, që, në fakt, nuk është e vërtetë bazuar mbi raportimin në terren.

ANALFABETIZMI RËNDON MË SHUMË SE VARFËRIA

Familja Hoxha në fshatin Laçes, një fshat 10 km në veri të Peshkopisë, është e varfër. Familja prej 6 anëtarësh mbahet me një pension mujor prej 9000 lekësh. Nga larg, shtëpia duket si një ahur bagëtish. Është e ndërtuar me plita, si shumë shtëpi në këtë zonë, dhe e mbuluar me tërnit. Kur afrohesh, shikon se në vend të derës janë disa dërrasa të kryqëzuara, ndërsa në vend të dritareve normale për një banesë, janë disa copëza të tjera dërrase, mbështjellë me plastmas. Kur i shikon derën dhe dritaren, të krijohet përshtypja se ata janë vendosur aty për të penguar daljen, jo se në banesë jetojnë njerëz. Nga dritarja del një bori sobe që nxjerr tym. Ngjitur me shtëpinë është një koshar misri, hambari i shtëpisë. Me vështirësi mund të dallosh disa kallinj të tharë, që duken si rezervat e fundit për ushqim në hambarin e shtëpisë.

Dy vajzat e rritura të kësaj familje, megjithëse me rezultate të mira në shkollë, nuk kanë mundur të ndjekin studimet për shkak të pamundësisë financiare të familjes. Ndërsa djali i madh, Emrahi, 15 vjeç, e ka braktisur shkollën në klasën e 11. Nuk ka mundësi të blejë libra dhe thotë se i vjen turp të shkojë në shkollë. Megjithatë, ai mund të lexojë, por për të shkruar ka harruar. Bën disa veprime të thjeshta matematikore, pasi mendohet jo pak. Po ashtu, mendohet edhe kur e pyet se si quhet mjeti i shkrimit që mbaj në dorë. Herën e fundit që ka shkruar një letër nuk e mban mend. Por Emrahi të paktën punon. Kosit jonxhë gjatë verës dhe për këtë shpërblehet me 1000 lekë për dynym.

Arifi është djali i vogël i shtëpisë. Ai duhet të ishte në klasën e pestë, por ka mbetur në klasën e katërt dhe nuk shkon në shkollë. Rrobat që mban veshur ia kanë sjellë të afërmit në Tiranë. Ata sjellin vazhdimisht për të gjithë familjen. Një vizitor në shtëpi i dhuron Arifit një libër me përralla. Ai e shfleton faqe pas faqeje dhe vë re se shikon vetëm figurat. Aty fillon e kupton se nuk di të lexojë. Kur i kërkohet të lexojë një paragraf, pasi ndalon buzëqeshjen, kthen sytë nga shokët e tij, Kevin 14 vjeç dhe Deni 11 vjeç, sikur do të thotë: "Ç'duhet të bëj"? Por as Kevin dhe as Deni, dy fëmijët në lagjen e tij, nuk e ndihmojnë dot. Ata nuk dinë të lexojnë për vete.

Vizitorët i dhurojnë libra për fëmijë të tre shokëve. Çuditen dhe pyesin: Ç'ish t'bëjmë me kto? U thonë se duhet t'i lexojnë dhe të kënaqen me aventurat e mrekullueshme të librit, por ata shikojnë njëri-tjetrin dhe nuk dinë ç'të bëjnë. Kam marrë me vetë një libër për parashkollorët "Përgatitem për klasën e parë". Shkronjat janë të mëdha, por prapë Arifi nuk di ta lexojë. "Spec" e lexon "mollë" dhe "derri" e lexon "kalë". Ndërsa "banane" e dallon nga figura. Ia mbuloj figurën me njërin gisht të dorëz dhe i kërkoj të ma rilexojë sërish, por nuk e bën dot. Shkronjën "A" e thotë pasi mendohet, ndërsa "C", "M", "LL", "K" dhe të tjera shkronja që zgjidhen rastësisht nga shfletimi i librit nuk di të m'i lexojë. Ndërsa një libër tjetër me historinë e Spiderman nuk ia lexon dot asnjë shkronjë, ndërsa heroin e dashur të fëmijëve e ka parë në filma.

Si Arifi është edhe dy shokët e tij, vëllezërit Geni 14 vjeç dhe Kevin 11 vjeç e kanë braktisur shkollën që në klasë të tretë.

Për të tre bashkëmoshatarët nuk është interesuar njeri. Prindërit nuk kanë qenë asnjëherë në Drejtorinë Arsimore, në komunë apo diku tjetër për të kërkuar ndihmë për shkollimin e fëmijëve. E ëma e Arifit thotë se "fëmijët i kam të zgjuar, por nuk kemi para që t'u blejmë libra". Bilali, i ati, nuk ka qenë asnjëherë në ndonjë institucion të pyesë nëse ka ndonjë mundësi që fëmijët e tyre mund të marrin libra falas, ndërsa mësuesja dhe drejtues të shkollës nuk kanë qenë ndonjëherë në shtëpinë e tyre.

Prindërit nuk janë të ndërgjegjshëm për atë që po pengojnë fëmijët e tyre. I them Bilalit se, sipas Kushtetutës së Shqipërisë dhe Konventave ndërkombëtare për fëmijët, fëmijët e tij duhet të arsimohen falas dhe se ai dënohet për shkak se nuk i çon fëmijët në shkollë. Por Bilali nuk është në gjendje ta kuptojë këtë. Fjalën "konventë" e mendon se është ndonjë fondacion që mund ta ndihmojë ekonomikisht. Ai vuan nga një sëmundje epileptike dhe familja ka në pronësi vetëm 7 dynymë tokë, shumicën e së cilës e kanë mbjellë grurë, "për të mbushur barkun me bukë".

VULLNETARË TË SHOQËRISË CIVILE VEPROJNË, INSTITUCIONET HESHTIN

Haki Përnezha, mësues në shkollën 9-vjeçare Fushë Alie, thotë se janë disa familje që ose nuk i sjellin fëmijët në shkollë, ose e ndërpresin shkollën me periudha të caktuara. Ai numëron rreth 20 fëmijë në këtë fshat që kanë ndërprerë shkollën për arsye ekonomike, ndërsa thotë se edhe familje të tjera rrezikojnë t'i heqin fëmijët nga shkolla, për shkak se nuk munden t'u blejnë as libra.

Zamira Gjeleshi është një tjetër mësuese në Gjimnazin e Maqellarës. Ajo prej 19 vitesh punon si arsimtare. Është diplomuar për studimet master në menaxhim dhe udhëheqje arsimi dhe po tani po kryen studimet e doktoraturës.

"Në vitin 2008, - thotë Zamira, unë kam punuar si vullnetare pranë "Partnerë për Fëmijë" dhe në atë periudhë vetëm në zonën e Maqellarës numëroheshin rreth 96 fëmijë që kishin braktisur shkollën, kryesisht vajza".

Disa nga arsyet ishin kalimi i sistemit arsimor nga 8+4 në 9+3, pasojat e emigracionit të prindërve, keqmenaxhimi i shkollës,largësia e madhe nga shkolla, relievi i thyer, braktisja e fshehtë, kushtet financiare etj. Por me një bashkëpunim prindër-pushtet vendor-drejtori arsimore është arritur që ky numër të ulet shumë dhe të ofrohet shërbim psikologjik për shkollat 9-vjeçare dhe transport.

World Vision, një organizatë që po punon me fëmijët dhe po i ndihmon ata të mbrohen dhe të ruhen nga çdo lloj abuzimi dhe diskriminimi, ka hapur zyrat e saj në Dibër prej vitit 2008. Në vitin 2010, Ministria e Arsimit dhe Shkencës i jep të drejtën World Vision, të hyjë dhe të punojë në shkollat e të gjithë vendit. Prej asaj kohe, kjo organizatë ka punuar vazhdimisht më fëmijët që kanë probleme me braktisjen e shkollës, për shkak të varfërisë, shëndetit apo problemeve të tjera sociale.

Sipas raportit vjetor të organizatës për vitin 2012, janë rreth 4000 fëmijë në tre komuna: Kastriot, Tomin dhe Maqellarë që janë nën monitorim. Aktualisht, sipas një prej vullnetarëve që bashkëpunon me ëorld Vision, në këto tre komuna janë 20 fëmijë që nuk ndjekin shkollën për arsye se nuk kanë mundësinë që të paguajnë për arsimimin e tyre dhe 4 raste të tjera për arsye se fëmijët janë të sëmurë nga leucemia, sëmundje kockore etj.

Një vit më parë gjashtë fëmijë me aftësi të kufizuara iu dhuruan karrige me rrota dhe tani ata e kanë me të lehtë të lëvizin.

Zamira tregon për një fëmijë në Maqellarë që vuan nga autizmi dhe nuk është pranuar as në shkollën e Maqellarës dhe as në një shkollë të posaçme në Durrës.

Ndërsa në një familje tjetër, po në këtë fshat, janë katër fëmijë, tre prej të cilëve kanë probleme me të folurin dhe të dëgjuarin.

Djali 9 vjeç që nuk flet dhe nuk dëgjon do ta përsërisë klasën e dytë, ndërsa i vëllai 10 vjeç ndjehet i dhunuar psikologjikisht dhe nuk është i afrueshëm me bashkëmoshatarët. Zamira tregon edhe për një djalë, i cili vuan nga astma dhe nuk e frekuenton shkollën për shkak të sëmundjes. Ai nuk merr as ilaçe me rimbursim dhe as përkrahje sociale.

arsimi

Arsimimi konsiderohet sot si një ndër të drejtat e njeriut më të sanksionuara nga pikëpamja e legjislacionit ndërkombëtar.

Zhytur në varfëri, fëmijëve të zonave rurale u mungon e drejta për arsimim



Foto © Bujar Karoshi

Për rastet e braktisjes së shkollës për shkaqe ekonomike apo varfërisë flitet pak ose aspak. Ndoshta edhe organizatat joqeveritare e kanë të vështirë të punojnë me këtë kontingjent fëmijësh, për shkak të shtrirjes së gjerë gjeografike.
Megjithëse ligji për arsimin parauniversitar ka si qëllim garantimin e të drejtës kushtetuese për arsimimin për të gjithë, kjo nuk garantohet për të gjithë fëmijët në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në Drejtorinë Arsimore të qarkut të Dibrës nuk mund të marrim statistika për fëmijët që nuk kanë mundësi të shkojnë në shkollë, as për analfabetët funksionalë që arrijnë të marrin një dëftesë të shkollës 9 vjeçare. Një punonjës i saj tha se në fund të vitit do të kishim statistika të sakta, pasi aktualisht janë shumë të ngarkuar me përgatitjet për mbylljen e vitit shkollor dhe maturës shtetërore.

Drejtori Arsimit i zonës nuk i'u përgjigj mesazheve dhe telefonatave për t'u intervistuar për këtë artikull

SHIFRAT ZYRTARE PËR BRAKTISJEN E SHKOLLËS NUK REFLEKTOJNË REALITETIN

Të dhënat e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit tregojnë shifra të ulëta të braktisjes së shkollës, ndërsa është e vështirë të gjesh një statistikë të fëmijëve që nuk arrijnë të lexojnë.

Të dhënat e Ministrisë së Arsimit për braktisjen e shkollës flasin kryesisht vetëm për fëmijët romë dhe egjiptianë. Këto statistika tregojnë se numri i fëmijëve nga ky komunitet janë zero në Dibër e Bulqizë, ndërsa statistikat kombëtare tregojnë se në shkallë vendi janë rreth 2916 fëmijë nga klasa e parë deri në të nëntën dhe mbi 60% e tyre janë të klasave nga e para në të pestë. Në tetor 2013, janë 3370 fëmijë nga klasa e parë deri në klasën e nëntë, ose 65 më pak se një vit shkollor më parë, viti shkollor 2011-2012. Në vitin shkollor 2013-2014 janë mbi 4200 fëmijë romë që ndjekin studimet në arsimin parauniversitar ose gati 150 më shumë se një vit më parë.

Ministrisë së Arsimit i pëlqen që statistikat t'i konvertojë në përqindje, pasi kjo tregon një shkallë të ulët të braktisjes, por kur këto statistika përkthehen në shifra, ato janë shqetësuese. Në fund të janarit 2011 braktisja e shkollës regjistrohej në 0,39%, ndërkohë që kjo shifër në janar 2010 ishte 0,48%, në dhjetor 2009 dhe qershor 2009 ishte përkatësisht 0,53% dhe 0,81%. E përkthyer në shifra, në janar 2011 ishin mbi 1600 nxënës që kanë braktisur shkollën, ndërkohë që kjo shifër në vitin 2009 ka qenë rreth 2300.

Ministria e Arsimit ka ngritur programin "Shansi i dytë" (Udhëzimi nr. 34, datë 8 dhjetor 2004), me anë të të cilit synon rifutjen në sistemin arsimor të fëmijëve që kanë braktisur shkollën apo janë të ngujuar". Sipas këtij programi, vetëm në vitin 2010-2011 kanë funksionuar 31 klasa në gjithë Shqipërinë, ku kanë ndjekur studimet mbi 600 nxënës, mbi 66% e tyre i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian. Ndërsa gjatë vitit 2013 kanë ndjekur shkollën, bazuar në këtë program, 917 fëmijë, ku rreth 300 prej tyre nuk i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian. Por statistikat nuk tregojnë nëse pjesa tjetër e fëmijëve janë nga familjet e varfra apo nga familjet e izoluara nga gjakmarrja.

Ministria e Arsimit ka ngritur një rrjet kombëtar të monitorimit të braktisjes së shkollës dhe përveç mbledhjes së statistikave rrjeti përcakton edhe masat që duhen marrë për parandalimin dhe reduktimin e braktisjes së shkollës. Duke filluar nga viti 2011, fëmijët romë i marrin tekstet shkollore falas në arsimin e detyruar, por një gjë e tillë nuk ndodh me fëmijët e familjeve të varfra jo-rome.

Një udhëzim i MAS në tetor 2013 (nr.31, 02.08.2013) përcakton modalitetet se çfarë duhet bërë në rastet e braktisjes së shkollës te fëmijët e që të paktën nuk kanë ndjekur dy klasë të arsimit bazë. Vendimi flet për të drejtat e fëmijëve kur kanë mbushur tetë vjeç dhe nuk janë regjistruar në një klasë, nuk kanë vazhduar klasën e dytë ose kur janë përsëritës. Vendimi përcakton procedurat e regjistrimit, angazhimin e institucioneve dhe Drejtorive dhe Zyrave Arsimore Rajonale, dhe rolin e shkollës, mësuesit kujdestarë, etj. "Drejtoria e shkollës, në bashkëpunim me mësuesin kujdestar organizojnë hartimin e programeve individuale të mësimdhënies dhe të nxënit", të udhëzimi.

Braktisjen e shkollës për shkak të gjakmarrjes Ministria e ka shumë të ulët. Organizatat joqeveritare flasin për rreth 600 fëmijë që nuk shkojnë dot në shkollë për shkak të gjakmarrjes, por statistikat e MAS tregojnë vetëm Shkodrën me 13 raste, nga të cilat 7 prej tyre janë vajza, si dhe dy raste në Malësinë e Madhe.

NË RREGULL ME LIGJET, POR JO ME REALITETIN

Sipas Kushtetutës së Shqipërisë, Neni 57, pika 1, thuhet se "Kushdo ka të drejtën për arsimim". Pika 2 thekson se "Arsimi shkollor i detyrueshëm caktohet me ligj", ndërsa pika 5 thekson se "Arsimi i detyrueshëm, si dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike është falas".

Gjithashtu, bazuar në Kushtetutë, funksionon edhe ligji nr. 7952 in vitit 1995 (përmirësuar me ligjin Nr. 8387 të vitit 1998), "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar", ku sanksionohen me ligj parimet dhe standardet e Marrëveshjeve Ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, veçanërisht të drejtat e fëmijëve në fushën e arsimit.

Neni 1 thekson se "Arsimi në Republikën e Shqipërisë është përparësi kombëtare. Ai realizohet në përputhje me parimet e sanksionuara në legjislacionin në fuqi, mbështetet në traditat e arritjet e shkollës sonë kombëtare dhe kryhet në përputhje me marrëveshjet dhe traktatet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Arsimi respekton të drejtat e fëmijëve dhe të të rriturve të sanksionuara në këto dokumente.

Ligji, përveç sanksionimit në nenet e tij të së drejtës për arsim parashkollor dhe të detyruar publik, detyrimin e prindërve për t'i dërguar fëmijët në shkollë, ndalimin e punës së fëmijëve, etj., sanksionon edhe "të drejtën e fëmijëve me nevoja të veçanta për arsimim special publik falas dhe detyrimin e shtetit për sigurimin gradual të kushteve të nevojshme për këtë qëllim (neni 40) dhe të drejtën e fëmijëve për raste të veçanta, për arsimim të detyruar pranë familjeve në rrugë private (neni 49).

Arsimimi konsiderohet sot si një ndër të drejtat e njeriut më të sanksionuara nga pikëpamja e legjislacionit ndërkombëtar. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve, miratuar nga OKB në nëntor 1989, i detyrojnë shtetet anëtare për të respektuar standardet e arsimimit, si një ndër të drejtat themelore të fëmijëve. Kjo konventë ka nene të posaçme për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore. Gjithashtu, nga viti 1948 deri në vitin 2006, janë miratuar mbi 10 konventa ndërkombëtare mbi të drejtat e fëmijëve, dhe Shqipëria i ka pranuar të gjitha. Ndërsa UNESCO në vitin 1994 ka miratuar Deklaratën "Salamanca", ku në paragrafin e dytë të saj thuhet: "Çdo fëmijë ka të drejtë themelore për arsim dhe duhet t'i jepet mundësia për të arritur dhe për të ruajtur një nivel të pranueshëm të të mësuarit".

FËMIJËT KANË NEVOJË "TË USHQEHEN" ME ARSIM

Pavarësisht ligjit dhe rregulloreve për rastet e braktisjes së shkollës, veprimet publike kanë qenë drejtuar kryesisht ndaj komuniteteve rome dhe egjiptiane, si dhe ndaj fëmijëve të ngujuar për shkak të gjakmarrjes.

Por për rastet e braktisjes së shkollës për shkaqe ekonomike apo varfërisë flitet pak ose aspak. Ndoshta edhe organizatat joqeveritare e kanë të vështirë të punojnë me këtë kontingjent fëmijësh, për shkak të shtrirjes së gjerë gjeografike. Megjithëse ligji për arsimin parauniversitar ka si qëllim garantimin e së drejtës kushtetuese për arsimimin për të gjithë, kjo nuk garantohet për të gjithë fëmijët në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Emrahi, Arifi, Kevin dhe Deni vazhdojnë ta kalojnë fëmijërinë jashtë dyerve të shkollës. Shpesh flenë të uritur nga mungesa e ushqimit, por gjithmonë janë të uritur nga mungesa e shkollimit.

Ministria e Arsimit ka eksperimentuar me një "shkollë me ushqim" në rrethin e Korçës, dhe një shkollë e tillë edhe në Dibër, pse jo në çdo qark, do t'i shpëtonte katër fëmijët dhe qindra të tjerë nga analfabetizmi. Dhe ndonjëri prej tyre nuk do të mbetej një statistikë, por do t'ia shpërblente vendit duke u bërë dikushi në jetë.

---

* Ky shkrim është pjesë e "Projektit për Raportimin e të Drejtave të Njeriut", i financuar nga Ambasada e SHBA-së me anë të Programit të Granteve të Vogla të Komisionit të Democracisë, i cili mbështet iniciativat e organizatave joqeveritare lokale të angazhuara në ndërtimin e themeleve sociale dhe intelektuale të demokracisë, zgjidhjen demokratike të problemeve dhe institucionalizimin e proceseve të hapura dhe pluraliste politike.

TCJE është një organizatë e shoqërisë civile që përdor një model gazetarie jofitimprurës që është i lirë nga presionet politike dhe komerciale, shërben për të forcuar demokracinë dhe sundimin e ligjit, si dhe ndihmon në modernizimin e shoqërisë shqiptare në përputhje me vlerat Euro-Atlantike.

Shkrimi është botuar në versionin anglisht në Tirana Times, dhe në faqen në web të organizatës www.tcje.org.

Për më shumë informacion: http://tcje.org/en/projects/raportimi-i-te-drejtave-te-njeriut/

Çdo ditë burri im shkon në punë dhe unë nuk jam e sigurt nëse ai do të kthehet në darkë...

Rruga e Arbërit nr. 98

sociale

Vdekje, mjerim dhe fëmijët në industrinë minerare shqiptare

Nga **AXEL KRONHOLM**

Violeta Koçi është 23 vjeç dhe karroca e saj e dorës sapo është thyer. Gjatë pjesës tjetër të ditës ajo duhet të mbajë në shpinë thasët me gurë kromi. Ajo është shtatzënë në muajin e gjashtë.

"Mjeku më thotë se nuk duhet të punoj, por çfarë mundësish të tjera kam," pyet ajo.

Për shumë njerëz në Bulqizë, një qytet gri dhe i pluhurosur rreth katër orë në verilindje të kryeqytetit shqiptar, Tiranë, gjithçka është mbijetesë. Nuk ka shumë punë në dispozicion dhe ti duhet të bësh atë që të del përpara.

Një mundësi për punë është jashtë minierave të kromit të qytetit, mbi grumbujt e gurëve që janë nxjerrë kur është gërmuar për galeritë e reja.

Duke kërkuar mes këtyre gurëve, Koçi dhe punëtorët e tjerë thonë se mund të fitojnë 3 deri në 4 dollarë në një ditë të mirë.

"Mund të marrim rreth 40 lekë për çdo kilogram krom të pastër që mbledhim," thotë Shpend Lloshi, 8 vjeç, që është i zënë duke kërkuar mes gurëve për mineralin e zi.

Dikur një qytet minerar në lulëzim, Bulqiza ka poshtë një nga rezervat më të mëdha të kromit në botë. Që kur është hapur për herë të parë në fundt të viteve '40, kjo minierë ka nxjerrë rreth 18 milionë ton krom, një metal i rëndësishëm në prodhimin e çelikut inoks.

Kjo ka qenë shtylla kurrizore e ekonomisë shqiptare gjatë gjysmë shekullit të regjimit komunist.

Sot puna nuk është si më parë, por sipërmarrjet private sërish nxjerrin mineralin e çmuar, duke gërmuar gjithmonë e më thellë në tokë dhe duke hapur galeri të reja.

Albchrome, në pronësi të oligarkut shqiptar, Samir Mane, është një punëdhënës i madh në qytet.

Krahas këtyre sipërmarrjeve të mëdha, ka edhe një tjetër industri minerare, ajo informale, duke shtrydhur ndonjë fitim nga galeritë e vjetra të braktisura apo nga grumbujt e grurëve të nxjerrë nga minierat.

Këtu punojnë njerëz si Koçi dhe Lloshi.

Edhe pse është vonë pasdite, Lloshi nuk duket i lodhur. Babai i tij, Guri, 37 vjeç, është një minator profesionist, por kur e ka pushim, del e punon me djalin.

"Nuk jam i shqetësuar për djalin," thotë ai, duke i përkëdhelur flokët me dashuri.

Një tjetër djalosh, që nuk do ta thotë emrin e tij, shprehet se punon këtu që kur ka qenë 9 vjeç. Tani është 16 vjeç. Ai duket shumë më keq se Lloshi nga veshja.

"Qëndrova në shkollë në vitet e para, por më pas nisa të punoj me kohë të plotë për të fituar para," thotë ai.

Në një ditë të veçantë, ka të paktën 50 njerëz që punojnë këtu, shumica e tyre fëmijë, po kaq të vegjël sa Lloshi.

Një prej tyre, një djalë disi më i madh, i veshur me një bluzë të kuqe dhe i gëzuar në fytyrë, nuk e ka gishtin e madh në dorën e djathtë. Aksidentet janë të zakonshme. Dy vjet më parë një djalë i ri vdiq kur u shemb një grumbull gurësh, duke e zënë poshtë.

Njerëzit, për të cilët punojnë këta fëmijë, quhen nga vendasit piratë.

Ata janë biznesmenë vendas, që kanë marrë koncesione për të nxjerrë dhe eksportuar krom. Ata e blejnë mineralin nga fëmijët për pak lekë dhe më pas e dërgojnë jashtë, kryesisht në Kinë.

Këta tajkunë të minierave nuk kanë përgjegjësi për punëtorët e tyre dhe shpesh përfshihen në të tjera aktivitete



Violeta Koci, 23 vjeç dhe 6 muajshe shtatzënë.



Shpendi Lloshi, 8 vjeç dhe babai i tij Guri, 37.



Familja Nexha duke ecur për të mbledhur krom.



Personat për të cilët punojnë këta fëmijë, në zonë njihen si "piratë"

Mjeku më thotë se nuk duhet të punoj, por çfarë mundësish të tjera kam?!

Dikur një qytet minerar në lulëzim, Bulqiza ka poshtë një nga rezervat më të mëdha të kromit në botë. Që kur është hapur për herë të parë në fundit të viteve '40, kjo minierë ka nxjerrë rreth 18 milionë ton krom, një metal i rëndësishëm në prodhimin e çelikut inoks.



Familja e dytë që vizitova. Kjo grua më tha se praktikisht në Bulqizë nuk ka jetë fare për gratë. Nëse nuk mbledhin krom, atëherë mbetet vetem të jenë shtëpiake.
Çdo ditë burri im shkon në punë dhe unë nuk jam e sigurt nëse ai do të kthehet në darkë.



Nexhmedin Nezha 42 vjeç, vuan nga çrregullimi post traumatik qëkur pësoi një aksident në minierë.Në foto me gruan e tij. Vajza e çiftit Nezha, më e vogla nga tre fëmijët. Ajo nuk punon (akoma).

të paligjshme. Ata luftojnë me njëritjetrin për të kontrolluar këtë biznes.

Një muaj përpara se të vizitoja Bulqizën, një nga piratët u vra.

Gjin Nica, 35 vjeç, po udhëtonte me motoçikletën e tij Yamaha në rrethinat e Tiranës kur iu bë pritë dhe u vra me një automatik.

Nica dyshohej se ishte përfshirë në vrasjen e dy rivalëve të kromit në Bulqizë, njërit në janar dhe tjetrit në shtator të vitit të shkuar.

Ai ishte arrestuar për falsifikim, por ishte liruar dy javë përpara se të vritej.

Biznesi ilegal i minierave në Bulqizë ilustron se sa i dobët është zbatimi i ligjit në Shqipëri. Është e rrallë që të shohësh në Tiranë teksa respektohen të drejtat e punëtorëve, jo më në qytete të harruara në mes të askundit.

Korrupsioni bën gjithçka të mundur.

Në një shtëpi brej betoni jeton Nexhmedin Nezha, 42 vjeç, me gruan, tre fëmijët dhe një familje që ndan hapësirën me ta.

Nexha të pret ngrohtë, por nuk të jep dorën, pasi krahët i ka të paralizuar. Aksidenti ndodhi 20 vjet më parë.

Që prej atëherë ai nuk ka mundur të punojë dhe ka vuajtur edhe nga ankthi dhe stresi post- traumatik.

Ilaçet e tij kushtojnë 23 dollarë në muaj. Pensioni i tij mujor është 130 dollarë.

Për të mbijetuar familja, dy fëmijët e tij më të mëdhenj mbledhin krom pas shtëpisë. Si Shpendi Lloshi, asnjë prej tyre nuk është akoma adoleshent.

Shumë familje janë në situatë të ngjashme.

Sipas Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë, 88 minatorë kanë humbur jetën vetëm gjatë pesë viteve të fundit. Shumë të tjerë janë plagosur ose paralizuar.

Askush nuk e di me saktësi se sa të plagosur dhe të vrarë ka në industrinë informale.

Por kjo nuk i ndalon fëmijët e Nezhës që të punojnë.

Burimi: https://news.vice.com/article/in-photos-murder-misery-and-children-in-albanias-mining-industry

Bulqizë, Shqipëri – Të fshehur, damarët e kromit vazhdojnë thellë dhe larg.

Burimi: *http://www.torontosun.com/2014/06/06/albanian-child-labour-takes-shine-off-chrome-industry* © *Fotot nga Thane Burnett*

Puna e fëmijëve në Shqipëri i heq shkëlqimin industrisë së kromit

Nga **HANE BURNETT**

Në mënyrë të padukshme, venat e kromit zgjaten nga Shqipëria e deri tek celularët ose lavamanët.

Kjo është historia e kromit, para se të shkëlqejë para syve tanë- dhe se si duart e fëmijëve e nxjerrin nga dheu e malet

Por, në fillim, një kontekst më i gjerë - 12 Qershori është Dita Ndërkombëtare për ndalimin e punës së fëmijëve.

Shumë fëmijë punojnë për vete dhe familjen dhe ky nuk është problem, nëse është e sigurt dhe fëmijët mund të shkojnë në shkollë.

Por, sipas statistikave të World Vision Canada, nga fushata *theirnochildforsale.ca,* 85 milionë fëmijë rreth globit bëjnë punë të rrezikshme, të pista dhe degraduese. Duke qenë se bota po kthehet në një market gjithnjë e më privat, disa konsumatorë janë të shqetësuar se produktet e tyre mund të jenë arritur me djersën dhe gjakun e të varfërve dhe fëmijëve veçanërisht.

Pas mbylljes së fabrikës së veshjeve në Bangladesh në 2013, që kishte më shumë se 1,100 punëtorë, blerësit, grupet humanitare dhe dizenjuesit kanadezë kërkuan kompensim, monitorim të rreptë dhe hapje të kompanive të tjera.

Nëpër botë kjo ka ndikuar në shumë gjëra që nga tregtia e diamanteve deri te shfaqja e aplikacioneve që i lejojnë blerësit për të kontrolluar transparencën e punës së markave. Por ka shumë produkte të përditshme që po gjejnë mënyra të zgjuara që të shmangin shqetësimin global.

Burimi i huaj i kromit, që na jep gjëra si çeliku i pandryshkshëm dhe aliazhe alumini ka arritur të përfitojë nga fëmijët që punojnë, duke pranuar shumë pak faj.

Në ftesën e World Vision Canada, që ngriti këtë projekt, ne gjetëm një prej rrugëve të gjësë më të shndritshme që ka një fillim të errët këtu, në qytetin shqiptar të minierave.

E vendosur në një luginë të gjelbër në veri të Shqipërisë, Bulqiza qëndron mbi një tokë të hollë. Minierat shkojnë deri 2,500 metra nën mal e zgjaten nën këmbët e qytetarëve.

Mbi tokë, pjesë të malit- gurë të shkulur nga miniera- janë bërë pirg. Zhurma e familjeve duke goditur gurë jehon poshtë në luginë.

Keli është një kërkues kromi 13 vjeçar, mamaja e të cilit u shtyp nga një kamion, ndërsa po kërkonte krom.Babai i tij ishte zhdukur prandaj u rrit nga vëllezërit.

Djaloshi punon pëditë në pirgjet e gurëve dhe lodhet derisa i mbyllen sytë.

"Unë ëndërroj që të shoh poshtë dhe të gjej kromin më cilësor," shpjegon ai.

Njëri nga vëllezërit e tij më të mëdhenj, Selimi 21 vjeçar, ndryshe nga Keli, sheh makthe, duke vdekur si nëna e tij.

Ai nuk e pret që kanadezëve t'u bëhet vonë për të, duke menduar: "Ata janë të pasur, ata s'duan që ta dinë se nga vjen kromi".

Rruga nga ky mal deri te pika ku kromi bëhet çelik është kaq e ngatërruar, saqë edhe ekspertët e kanë të vështirë të kuptojnë se ku shkojnë gurët pas përpunimit. Ajo fillon që te fëmijët që gërmojnë me duart e tyre.

Shumë janë vrarë dhe ankohen për probleme me stomakun dhe kurrizin – një kombinim i punës së rëndë dhe ujit të pistë që ndotet nga plehrat e minierave.

Një dekadë më parë rregulla më strikte të qeverisë së atëhershme i pengonin kompanitë të punësonin fëmijë në këto miniera.

Por ekziston një zinxhir furnizues fëmijësh për tregun e zi që "luftojnë" për kromin.

Nga kovat e tyre ata shesin kromin e mbledhur te "bosët kromit" – persona në hije që shesin kromin te kompani në bregun Adriatik.

Duke qenë vendi më i korruptuar në veriun e Europës, gjithkush e di se kush janë bosët e kromit, gjë e cila shihet te shtëpitë e tyre me mure betoni dhe xhama të thyer sipër tyre. Edhe nëse personat të cilët blejnë kromin pyesin se ku merret – bosët e kromit nuk flasin.

Në fakt, disa nga prodhuesit më të mëdhenj të çelikut në Amerikë kanë përfituar nga minierat e Bulqizës.

Janë edhe disa kompani kanadeze që operojnë në Shqipëri, duke përfshirë edhe një firmë me bazë në Vankuver, e cila ka një histori në Bulqizë. Gjithsesi, Jorge Martinez, zëdhënësi për Columbus Copper Corporation, thotë që s'kanë më lidhje me minierat shqiptare.



Një familje mbledhësish kromi pushojnë pak pas punës në Bulqizë.





Një fëmijë shqiptar mban një grusht me copa shkëmbi që do të shtypen dhe të bëhen krom për çelik te pandryshkshëm.



Margarita, një vejushë shqiptare, të cilës burri i vdiq në njërën nga minierat e kromit, bashkë me vajzën e saj, Brikelën, ulet pranë fustanit, të cilin ia bleu djali i saj, Marigleni.



Dy fëmijë shqiptarë, 7 dhe 10 vjeç, mbledhin kanaçe në Durrës. Puna e fëmijëve është një problem i vazhdueshëm në Shqipëri.

Fëmijët në Shqipëri punojnë në faqet e maleve, jashtë minierave, për të gjetur skrap e për ta shitur më pas në tregun e zi.

Por nuk ka asnjë strategji konkrete se si të heqë fëmijët nga puna e mbledhjes së kromit.

Dhe fëmijët punojnë në fshehtësi dhe vështirësi të mëdha.

Fëmijët ecin me këmbë të vrara poshtë e lart kodrave rreth Bulqizës, duke shpresuar që të bjerë shi, sepse ekspozon gurët më të mirë.

Vdekjet brenda minierave shqiptare janë bërë të shpeshta, 1deri në 2 vdekje në muaj. Nuk ka regjistrime se sa fëmijë vriten duke gërmuar jashtë, për të përfituar rreth 8 cent për kilogramë krom.

Kjo është e mjaftueshme për të blerë vetëm miell për bukë.

Margarita, një vejushë 27 vjeçare, humbi burrin e saj nga një shembje miniere vitin e kaluar.

Ai punonte te një operator i palicensuar, kështu që Margarita dhe dy fëmijët e saj nuk kanë marrë më shumë se 60 dollarë në muaj me pensionin e jetimit dhe asnjë ndihmë tjetër.

3 muaj më parë, ajo ju tha fëmijëve të saj – djalit 10 vjeçar Mariglen dhe vajzës 7 vjeçare Brikela, që nuk do të kërkonin më për krom.

Ky gur ju kishte marrë më shumë se ç'ju kishte dhënë.

Por djali i saj nuk e dëgjoi. Për shumë ditë ai largohej fshehurazi dhe punonte te kodrinat.

Dhe në Ditën e Nënës në fillim të marsit, ai i bleu Margaritës lule – të paguara me paratë e fituara nga kromi Ii mbledhur.

Ajo i refuzoi ato. Ajo ishte ende duke mbajtur zi për babain e tyre dhe ishte e pamundur të pranonte ngjyra në shtëpinë e saj.

Prandaj djali iku prapë dhe u kthye pak më vonë me një dhuratë tjetër – një fustan të zi.

Ajo u gëzua, por edhe u mërzit, pasi këto para mund të ishin shpenzuar që fëmijët të vazhdonin shkollën.

Djali i saj nuk sheh asgjë të keqe te gërmimi për të gjetur krom.

Ai kupton vetëm se çfarë mund të blejë nga shitja e tij.

Gurët që blenë një fustan të zi për një vejushë që humbi bashkëshortin në ndjekjen e të njëjtit gur, tani me shumë mundësi janë kthyer në një produkt tjetër me shkëlqim për këtë botë.

Martinez nuk dha shpjegime për shqetësimin për punën e fëmijëve në vend, por tha në një email: "Shqipëria është thjesht një vend shumë i vështirë për të operuar në të".

Qeveria shqiptare është shumë e rezervuar të flasë për problemin e fëmijëve minatorë.

Qeveria e re është parë si progresive në reformat e mbrojtjes së fëmijëve. Njëri prej krerëve të lartë të këtij vendi që aderon në Bashkimin Evropian tha se deri tani ka rreth 200 zyrtarë të akuzuar për korrupsion dhe shpërdorim të detyrës.

Gurët që blenë një fustan të zi për një vejushë që humbi bashkëshortin në ndjekjen e të njëjtit gur, tani me shumë mundësi janë kthyer në një produkt tjetër me shkëlqim për këtë botë.

Nuk është një gjë e keqe që ne kënaqemi nga ky shkëlqim.

Është shumë e rëndësishme të dimë që ndoshta duar të vogla mund ta kenë mbledhur atë me dhimbje dhe lodhje nga damarët e ndonjë shkëmbi.

Përktheu: **Klovis Karoshi**

Rruga e Arbërit nr. 98

aktualitet

Punimet do zgjasin 20 muaj, jetëgjatësia e minierës zgjatet 20 vite, krijohen mbi 200 vende pune.

Albcrome, investim prej 20 milionë dollarësh për **minierën e Bulqizës**

Nga **HYSEN LIKDISHA**



Gjiknuri: Jam këtu për të dhënë përkrahjen dhe mbështetjen time që të vazhdoni në këtë drejtim, sepse kjo është ajo që presim nga kjo industri, jo ai imazh që fatkeqësisht e ka krijuar Bulqiza, por imazhi i investimit serioz që garanton investim afatgjatë dhe të qëndrueshëm.

PËRURIMI: NIS PUNA PËR HAPJEN E PUSIT NR.9

Albcrome, pjesë e Balfin Grup, do të investojë mbi 20 milionë dollarë për të vënë në jetë një projekt për hapjen e thellësisë së pusit nr.9 në minierën e Bulqizës.

Sipas specialistëve të minierave, ky është një nga projektet më të mëdha të kohëve të fundit në industrinë kromnxjerrëse.

Me këtë rast, më 25 qershor 2014, në hyrjen kryesore të minierës është zhvilluar ceremonia e fillimit të punimeve për hapjen e thellësisë së pusit nr.9, siç quhet ndryshe "Pusi i thellësisë"

Në këtë ceremoni morën pjesë minatorë, drejtues ndër vite të minierës, specialistë të fushës kromnxjerrëse, përfaqësues të pushtetit lokal, etj. Gjithashtu, morën pjesë në këtë ceremoni edhe ministri i Energjetikës dhe Industrisë Damian Gjiknuri dhe ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale, Erion Veliaj.

Ata u pritën nga Presidenti i Balfin Grup, Samir Mane, drejtori ekzekutiv i Albcrome, Luan Saliaj dhe drejtorit aktual i minierës së Bulqizës, Edmond Xhafa.

Në fjalën e hapjes, drejtori i minierës Edmond Xhafa, evidentoi se punimet për hapjen e këtij pusi janë parashikuar të përfundojnë brenda një periudhe 20 mujore.

Për realizimin e këtyre punimeve është kontraktuar një nga kompanitë kineze më prestigjioze në industrinë minerare "Wenzhou Mining Co Ltd". Po kjo kompani do të realizojë edhe instalimin e makinerive dhe pajisjeve të nevojshme për punën e minatorëve.

Sipas tij, pusi nr.9 do të përshkojë nëntokën në një distancë prej 600 metrash duke filluar në kuotën 420 metra mbi nivelin e detit dhe duke përfunduar në kuotën 180 metra nën nivelin e detit. Sipas tij, parashikohet që investimi prej 20 milionë dollarësh për realizimin e këtij projekti do t'ia shtojë jetëgjatësinë kësaj miniere edhe të paktën me 20 vite të tjera.

Prej këtij investimi, minierës së kromit Bulqizë i vjen frymëmarrja e duhur për vënien e saj në efiçencë. Prodhimi mesatar vjetor i kromit do arrijë deri në 80.000 ton, si dhe do shtohen vendet e punës e do rritet ndjeshëm siguria në punë për minatorët. Përshëndetën në këtë ceremoni edhe kryetari i shoqatës së minatorëve, inxhinieri Ndoc Uci. Ndërsa presidenti i firmës kineze kontraktuese për realizimin e këtij projekti, zoti Lin Heng, shprehu optimizmin e tij në realizimin e këtij projekti ambicioz, gjë për të cilën, siç tha ai, do të angazhohet një personel prej 70 punonjësish nga Kina. Një pjesë e tyre kanë ardhur dhe janë vendosur në Bulqizë.

Drejtori ekzekutiv i Albcrome, Luan Saliaj, garantoi se fillimi i punimeve për hapjen e thellësisë së minierës jo vetëm që do të ruajë numrin e punëtorëve aktual në vazhdim, por do të çojë edhe në shtimin e punëtorëve të rinj.

MINISTRI GJIKNURI: INVESTIM QË DO TË RILINDË INDUSTRINË E KROMIT

"Përshëndes kompaninë, e cila ka bërë të mundur fillimin e realizimit të një ëndrre të vjetër, që ka mbi 35 vite që Shqipëria e pret, për të rilindur industrinë e kromit", tha në fillim të fjalës së tij Ministri i Energjisë dhe Industrisë. "Industria e kromit po vihej në rrezik pikërisht për shkak të indiferencës dhe mungesës së investimeve."

"Hapja e këtij pusi, hap horizonte të reja, hap mundësi të reja dhe e bën edhe jetëgjatësinë e kësaj miniere të sigurtë, edhe për mbi 20 vite të tjera. Kjo është vërtetë një arritje që meriton përshëndetje", theksoi Gjiknuri

"Kisha vënë bast se nuk do të doja të shkelja në Bulqizë, për shkak të imazhit jo të mirë që kishte krijuar, për shkak të mungesës së kontrollit nga shteti dhe zhvillimit kaotik, e mbi të gjitha për faktin se doja që një koncesionar të zbatonte atë që kishte marrë përsipër", theksoi Gjiknuri. "Fatkeqësisht, më parë të tjerët dështuan, ndërsa unë thashë se do të vij në Bulqizë kur të vij të shoh se si punohet për pusin nr.9.

Tanimë kjo gjë po ndodh dhe është e vërtetë. Kam kënaqësinë më të madhe që të jem këtu, bashkë me ju, për të festuar një ditë shumë të rëndësishme për kompaninë, për industrinë e kromit dhe për gjithë këtë zonë, e cila jam i bindur se do të përfitojë maksimalisht nga puna në këtë minierë".

"Qeveria jonë, ministria, do të jetë në mbështetje si me legjislacionin e ri që së bashku po e përgatisim por ashtu edhe me politikat për të nxitur sa më shumë investimet në sektorin minerar, ashtu sikurse pasurimin dhe vlerën e shtuar që duhet të ketë ky vend nga zhvillimi i sektorit minerar. Jam këtu për të dhënë përkrahjen dhe mbështetjen time që të vazhdoni në këtë drejtim, sepse kjo është ajo që presim nga kjo industri, jo ai imazh që fatkeqësisht e ka krijuar Bulqiza, por imazhi i investimit serioz që garanton investim afatgjatë dhe të qëndrueshëm", mbylli fjalën e tij ministri i Energjisë dhe Industrisë.

MINISTRI VELIAJ: ULET MOSHA E PENSIONIT PËR MINATORËT

Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Erion Veliaj, deklaroi se "ulja e moshës së daljes në pension për minatorët nga 1 janari 2015 dhe hapja e një kursi profesional për minatorët e rinj në këtë qytet, tashmë është realitet".

"Ekziston një formulë ku nuk fiton vetëm biznesi, shteti apo vetëm punëtorët, por ka mundësi të fitojnë të tre: Edhe biznesi të bëjë një punë të pastër e të jetë i suksesshëm; edhe punëtorët të paguhen me rroga dinjitoze, por edhe shteti të marrë atë që i takon", deklaroi ministri Veliaj në fjalën e tij. Ai falënderoi kompaninë Albchrome për investimin në zonën e Bulqizës, ku përveç sigurimit të vendeve të punës për punonjësit aktualë, me hapjen e pusit numër 9 do të krijohen edhe vende të reja pune.

"Dua t'u uroj 'punë të mbarë' 26 të parëve që fillojnë punë sot, por edhe 200 të tjerëve që pritet të nisin punë këtë vit, sepse ky është urimi më i mirë që mund t'i bësh dikujt në një kohë krize", tha z. Veliaj, duke falenderuar edhe sindikatat për presionin e shëndetshëm që ushtrojnë ndaj biznesit dhe qeverisë në të mirë të minatorëve, kur bëhet fjalë për sigurinë në punë apo çështjet e trajtimit të pensionit të tyre.

"Kjo është meritë e sindikatave që i bëjnë presion çdo qeverie, derisa më në fund, erdhi një qeveri e cila i dëgjoi për uljen e moshës së minatorëve. Jam shumë i lumtur që këtë premtim e bëmë realitet. Nga 1 janari 2015, do të kemi minatorë që dalin në pension në moshën 55 vjeç dhe politikanë që dalin në pension në moshën 60 vjeç, sepse gjykojmë se është më e vështirë të jesh minator se sa politikan", deklaroi ministri Veliaj.

Nga ana tjetër, ai u shpreh entuziast për hapjen e kursit të parë të trajnimit për minatorët e rinj në qytetin e Bulqizës. "Kjo minierë ka prodhuar jo vetëm lajme të këqija, por edhe lajme tragjike, kur njerëz janë plagosur apo kanë humbur jetën në punë. Një nga faktorët kryesorë të kësaj ka qenë se shumë prej të rinjve që futeshin në minierë, hynin të papërgatitur. Më vjen mirë që tanimë kemi certifikuar të trajnuarit e parë, të cilët nëpërmjet zyrës së punës janë punësuar në minierë", tha z. Veliaj.

SHEMBET GALERIA, VDES MINATORI

Rreth dy javë më parë se të përurohej fillimi i punimeve në Pusin nr.9, më 13 qershori, një ngjarje tragjike ndodhi në një nga galeritë private të Bulqizës.

Burime nga policia lokale thanë për gazetën se "ngjarja ka ndodhur në pjesën jugore të minierës, thënë ndryshe Zona D".

Sipas këtyre burimeve, në një nga galeritë private të kësaj zone, ka ndodhur shembja e tavanit të galerisë, ku për pasojë ka humbur jetën Ramë Biçi, 30 vjeç. Kanë qenë shokët e tij të punës që e kanë çuar menjëherë 30 vjeçarin pranë spitalit të Bulqizës, por fatkeqësisht mjekët kanë konstatuar se ai kishte ndërruar jetë.

Zona D: Shembet galeria private, vdes minatori 30 vjeçar Ramë Biçi. Pas një viti në koma, ndërron jetë edhe minatori tjetër Sadik Shyti

Policisë kriminale ka mbyllur galerinë ku ndodhi aksidenti i rëndë dhe kanë nisur hetimet për zbardhjen e kësaj ngjarje.

Nga specialistë të minierave, Zona D e Bulqizës është konsideruar si mjaft problematike dhe e pasigurtë për punë.

Madje shpesh nga këta specialistë është artikuluar mbyllja e kësaj zone. Firmat private që punojnë shpesh kanë shfrytëzuar për nxjerrje minerali edhe kolonat e galerive, duke anashkaluar kështu kushtin themelor në shfrytëzimin e galerive të kromit. Specialistë të minierave thanë se qeveria duhet të ndërhyjnë në vendosjen e ligjshmërisë, pasi çdo vonesë në këtë drejtim përkthehet me humbje të jetëve njerëzore që pasojnë njëra-tjetrën.

Një ditë pas këtij aksidenti të rëndë, ka ndërruar jetë edhe minatori Sadik Shyti, 49 vjeç, i cili ishte aksidentuar rreth një vit më parë. Shyti, babai i 3 fëmijëve, punonte si minator në minierën më të madhe në Bulqizë, atë të ACR-së.

Sadik Shyti punonte si minator shembje dhe, ndërsa kishte mbaruar përgatitjen e frontit të parë të punës, ishte ngjitur në lartësi për hapjen e vrimave për përgatitjen e frontit të dytë. Por, një masiv gurësh është shkëputur nga tavani i galerisë duke e plagosur në gjendje të rëndë. Shokët e punës e kanë dërguar për mjekim në spitalin e Bulqizës, dhe prej aty u dërguar me helikopter në Spitalin Ushtarak Tiranë. Mjekët specialistë të këtij spitali, me gjithë përpjekjet e vazhdueshme të tyre, nuk arritën ta nxjerrin atë nga gjendja e komës për gjashtë muaj, dhe më pas, e dërguan në shtëpi po në gjendje kome në fshatin Dragu të Bulqizës, ku ndërroi edhe jetë në mes të muajit qershor.

Sadik Shyti u plagos në galerinë, ku në verën e vitit 2011, 700 minatorët e Bulqizës zhvilluan një grevë urie trejavore dhe protesta 3-mujore për kushte më të sigurta pune dhe rritje page.

Për opinione dhe komente mund të na shkruani në adresën: <rrugaearberit@gmail.com>
OPINIONET DHE KOMENTET E BOTUARA NUK SHPREHIN DOMOSDOSHMËRISHT QËNDRIMIN E REDAKSISË

kryesore

Nga bisedimet kineze te protestat në rrugë:
nevoja për transparencë prodhon statuse facebooku

Rruga e Arbërit, shumë informacione për asgjë...

Nga **BUJAR KAROSHI**

BISEDIMET ZYRTARE: LAJMET PËR RRUGËN ME PIKATORE

Më 8 qershor, Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, z. Arben Ahmetaj, mori pjesë në një konferencë të Ministrave të Ekonomisë dhe Tregtisë nga Kina dhe Europa Qëndrore dhe Lindore. Gjatë ditëve të qëndrimit në Kinë ai u takua me homologun e tij kinez, me të cilin u diskutuan mundësitë e investimeve kineze në Shqipëri. Sipas informacionit zyrtar të shpërndarë për mediat, Ahmetaj e "vuri theksin në disa projekte madhore infrastrukturore, të cilat do të ishin projekte me interes për Kinën, si: Rruga e Arbrit, Autostrada e Kaltër, Porti i Shëngjinit, hekurudhat, apo edhe projekte të tjera në sektorët e energjisë, bujqësisë dhe kultivimin e peshkut".


Ndërsa më 16 qershor, në profilin e tij në FB, deputeti i Dibrës Përparim Spahiu shkroi statusin: "Shumë shpresëplot për rrugën e Arbrit nga takimi që sapo mbaroi në Ministrinë e Transportit, midis ministrit Haxhinasto dhe grupit nga Kina, ku isha edhe unë prezent!"

Një ditë më pas, gazeta "Integrimi", organ zyrtar i Lëvizjes Socialiste për Integrim, shkroi se "Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës, Edmond Haxhinasto, ka zhvilluar ditën e djeshme (16.06.2014 *sh.red.)* një takim me një përfaqësi të kompania kineze 'China State Constructionand Engeneering Corporation', lidhur me Rrugën e Arbrit, për të gjetur zgjidhjen përfundimtare për këtë segment rrugor të lënë pas dore". Sipas gazetës, "qeveria kineze ka propozuar një sërë masash dhe politikash bashkëpunuese në fushën e ekonomisë me Shqipërinë, rezultat i të cilave është dhe lëvrimi i kredive me kushte favorizuese që do të bëjnë të mundur dhe realizimin e këtij projekti mjaft të rëndësishëm në fushën e transportit, siç është edhe Rruga e Arbrit. Oferta për ndërtimin e kësaj vepre aq të nevojshme për Dibrën në radhë të parë, por dhe për vendin tonë në përgjithësi, vjen nga kompania kineze 'China State Constructionand Engeneering Corporation', e cila do të realizojë edhe vepra të tjera të rëndësishme, siç janë tuneli i Qafë Murrizit dhe Ura e Vashës."

Më poshtë, gazeta shkruan se financimi i këtij projekti "merret përsipër nga 'EximBank', në formën e një kredie të butë me kushte favorizuese. I gjithë ky projekt i propozuar nga pala kineze i është paraqitur edhe Ministrisë sonë të Financave disa ditë më parë. Gjithçka që na nevojitet tani është krijimi i grupeve të punës që do të merren me detajet e kësaj marrëveshjeje, me përfaqësues nga pala kineze, nga Ministria e Transportit dhe ajo e Financave. Këto grupe pune duhet sa më shpejt të bëjnë të mundur arritjen e një rezultati të pritshëm e të prekshëm për të gjithë ne". Gazeta citon deputetin e LSI të qarkut të Dibrës të ketë thënë se "Rruga e Arbrit është ndër të vetmet rrugë në vendin tonë, për të cilën janë bërë aq shumë premtime, për të cilën është folur aq shumë e janë prerë shirita për fillimin e punimeve, por që nuk ka pasur asnjë rezultat konkret. Çdo premtim elektoral për këtë vepër është harruar menjëherë pas zgjedhjeve. Por natyrisht qëllimi i të gjithë ne dibranëve nuk është të merremi me të kaluarën, por të shikojmë me shpresë nga e ardhmja. Më në fund duket se gjithçka po merr zgjidhje. Kjo zgjidhje vjen nga Kina e largët, por që me investimet në ekonomi është shumë pranë Shqipërisë.

PIKËPYETJE PËR BISEDIMET DHE DEKLARIMET PUBLIKE

Ndërkohë që gazeta "Integrimi", duke cituar ministrin Haxhinasto dhe deputetin Spahiu thotë se "është Exim Bank që do të financojë projektin e Rrugës së Arbërit", një burim pranë delegacionit në bisedime, tha se "Exim Bank" është larguar nga bisedimet, pasi nuk kanë rëndë dakord për mënyrën se si do të financohet projekti. "Exim bank ka kërkuar dhënien e huasë me 6% interes, ndërsa qeveria shqiptare është duke kërkuar kredi me 2% interes, tha po ky burim për gazetën "Rruga e Arbërit". "Exim bank" do ta financonte projektin deri në Gostivar, pra edhe për pjesën e Maqedonisë, por duket se delegacioni shqiptar nuk e ka bërë punën siç duhet dhe banka është larguar nga bisedimet. Burimi shton se në mes të qershorit ka qenë në Shqipëri një bankë tjetër kineze "China Development Bank", por se si kanë ecur bisedimet nuk mund të na konfirmojë asgjë. Gjithashtu, burimi thotë se kinezët janë shumë të interesuar edhe për hidrocentralin e Skavicës, për të cilën asnjë njoftim zyrtar nuk ka raportuar se "Skavica është në tryezën e bisedimeve".



Tuneli në Qafë të Tujanit.
Foto © Bujar Karoshi

Rruga e Arbrit është ndër të vetmet rrugë në vendin tonë, për të cilën janë bërë aq shumë premtime, për të cilën është folur aq shumë e janë prerë shirita për fillimin e punimeve, por që nuk ka pasur asnjë rezultat konkret. Çdo premtim elektoral për këtë vepër është harruar menjëherë pas zgjedhjeve.

Në një bisede më gazetarët, Ruzhdi Lata, kryetar i Komunës së Dibrës së Madhe, ka zbardhur një bisedë të tij private me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama. Sipas tij, Rama është shprehur se "tani nuk mund të them gjë, por në fund të qershorit do të prononcohem për këtë".

Qershori iku, por bashkë me të nuk kanë ikur paqartësitë: Çfarë po kërkon qeveria shqiptare nga kinezët? Një financim për rrugën e Arbërit apo një koncensionar për ndërtimin e saj? A është miniera e kromit në Bulqizë një pasuri që e duan kinezët dhe bashkë me të ndërtojnë edhe rrugën? Po Skavica, a është një kusht kinez për investimet në rrugë?

DEPUTETI I PD: QEVERIA ASNJË QINDARKË PËR RRUGËN

Në një dalje mediatike në qytetin ku ka drejtuar prej shumë vitesh, deputeti i Bulqizës në Kuvendin e Shqipërisë, Roland Keta, ka akuzuar qeverinë Rama se në buxhetin e vitit në vazhdim 2014-të, nuk ka planifikuar asnjë qindarkë për ndërtimin e Rrugës së Arbërit. Korrespondenti i gazetës në Bulqizë, citon deputetin Keta të ketë thënë se "mungesa e investimeve ka çuar në largimin total të firmave nga vijimi i punimeve në këtë rrugë". Ai i ka ftuar edhe deputetët e tjerë që të bashkohen për çështjen e rrugës së Arbërit, pasi të gjithë e kemi premtuar para popullit të Dibrës ndërtimin e kësaj rruge. Ndaj sot dibranët presin me interesim të jashtëzakonshëm një lobim të fuqishëm të këtyre deputetëve në Parlamentin shqiptar për ndërtimin e Rrugës së Arbërit. "Është momenti ku dibranët mund dhe duhet të bëhen bashkë, aq më tepër edhe përfaqësuesit e tyre në Kuvendin e Shqipërisë, për të mundësuar kështu vëmendjen dhe nxitjen e strukturave shtetërore për ndërtimin e Rrugës së Arbërit, kësaj arterie të rëndësishme rrugore rajonale, që do t'i japë Dibrës dhe dibranëve zhvillimin e duhur ekonomiko-shoqëror", tha deputeti Keta për gazetarët.

SHQIPËRIA MUND TË FUTET NË BE, POR DIBRA AKOMA NUK ËSHTË PRANUAR NË SHQIPËRI

Dr. Gëzim Alpion,iniciuesi i peticionin online për Rrugën e Arbërit nisur më shumë se një vit më parë, në një deklaratë të shpërndarë për mediat, thekson se "Shqipëria edhe mund të pranohet në BE pas 10 vjetësh, por e vërteta e hidhur është se Dibra dhe zona të tjera të 'largëta' akoma nuk janë pranuar në Shqipëri." Duke folur për heshtjen e kryeministrit të Shqipërisë për takimin në lidhje me dorëzimin e peticionit për Rrugën e Arbërit, ai thotë se "Kryeministri zgjodhi heshtjen nga shtatori 2013 deri më 10 maj 2014 për kërkesën e përsëritur disa herë për takim për t'i dorëzuar peticionin për Rrugën e Arbërit. Më 22 maj 2014, pra 11 ditë pasi isha kthyer në Angli pas lobimit në Shqipëri për Rrugën e Arbërit nga 4-11 maj, Zyra e Kryeministrit më dërgoi një letër për të më njoftuar se jam i mirëpritur të shkoja në Tiranë për ta dorëzuar peticionin formalisht kur të dëshiroja. Unë dhe kolegët e mi e mirëpritëm letrën nga Zyra e Kryeministrit ndonëse nuk e kuptuam se përse z. Rama nuk na priti kur ishim në Tiranë, ashtu siç bënë Presidenti i Republikës dhe Kryetari i Kuvendit."

"Që nga 22 maji i këtij viti, ne i kemi dërguar Zyrës së Kryeministrit tre mesazhe për t'i njoftuar se e pranojmë ftesën dhe se jemi të gatshëm të kthehemi në Tiranë, kurdo që të jetë e përshtatshme për z. Rama, në shtator ose në dhjetor të këtij viti. Megjithatë, deri tani askush nuk ka denjuar të na kthejë përgjigje ose të paktën, për kortezi, të na njoftojë se e kanë marrë përgjigjen tonë", thotë Dr. Alpion "Mund të konfirmojmë se, një vit pas ardhjes në pushtet, Qeveria Rama akoma nuk ka siguruar fondet për Rrugën e Arbërit. Dhe kjo ndodh ndërkohë që për vepra në zona të tjera, me sa duket, të 'preferuara', kjo qeveri, si qeveritë para saj, vazhdon të gjejë fonde si me magji", shkruan ai në një reagim për mediat të shpërndarë në fund të muajit.

"Në mungesë të një përgjigje të qartë nga Zyra e Kryeministrit nëse do të na takojë z. Rama për t'i dorëzuar peticionin, ne do të kthehemi në Tiranë kur ta shikojmë të arsyeshme dhe do të zgjedhim metodën tonë të dorëzimit, e cila, ju sigurojmë, se do të jetë brenda normave demokratike. Politika shqiptare ka kohë që dominohet nga rastësia. Megjithatë, as Dibra dhe asnjë zonë tjetër e Shqipërisë e poshtëruar nga injorimi shtetëror njëshekullor, nuk është rastësi dhe zëri i saj si dhe vullneti i më se 8,000 nënshkruesve të peticionit online dhe në formularë do të dëgjohen", thekson dr. Gëzim Alpion.

NË FB FILLOJNË PROTESTAT

Një faqe në FB ka krijuar një event që flet për një protestë për Rrugën e Arbërit. Protesta njoftohet nga datat 1 qershor deri 1 shtator, por pa përcaktuar një datë fikse. Më 1 qershor nuk pati asnjë protestë, por edhe gjatë muajit nuk pati njoftime për një gjë të tillë, megjithëse më shumë se 460 veta kanë njoftuar se do të shkojnë në protestë.

Ndërsa një faqe tjetër, po dibrane, njoftoi se meqë protestat nuk janë gjë e mirë para marrjes së statusit të vendit kandidat, "nuk mendojmë që ka dibranë që do të dëshironte ta shpërfillte këtë ngjarje duke u ngritur në protestë". Profili në FB njofton datën 22 korrik për një protestë të radhës. "Ka shumë prej atyre që na njohin nga afër dhe e dinë mirë forcën që ka rinia dibrane, shkruan në një postim të vetin profili "Për Dibrën", prandaj, në vend që të hamendësoni dhe të sajoni komente që nuk ju burojnë nga zemra, ndajeni mendjen të bashkoheni njëherë të vetme për Dibrën". Profili "PER DIBREN" i fton të gjitha shoqatat që operojnë në Dibër që të mblidhen së bashku për t'i dalë zot vendlindjes, si asnjëherë më parë".

Profilet në FB "Qyteti i Peshkopise" dhe "Për Dibrën" kanë njoftuar në statuset e tyre se detajet mbi protestën do të bëhen të ditura në kohën e duhur!

Gjithashtu, në një falënderim për anëtarët e saj të shpërndarë përmes emailit, "Bashkësia Dibrane", një shoqatë me qendër në Tiranë, i fton qytetarët dhe shoqatat e tjera që t'u bashkohen veprimtarive të saj duke filluar nga shtatori, kryesoret e të cilave janë çështjet që lidhen me Rrugën e Arbërit dhe Radikën.

* * *

Nga deklaratat zyrtare të deklarimet në rrjetet sociale duket se ka një hendek të madh. Me gjithë mundësitë e shumta të shpërndarjes së informacionit, duket se shoqëria civile dhe zyrtarët kanë ndërruar rolet: ndërsa organizatat dhe qytetarët kërkojnë më shumë veprime aktive për ta përfunduar procesin me rezultate pozitive, ndërsa zyrtarët prodhojnë statuse në rrjetet sociale e mediatike pa rezultate. Çdo marrëveshje e arritur për rrugën është e mirëpritur, por që ajo të japë efektet pozitive që me firmosjen e saj, informacionet duhet të jenë të sakta dhe të qarta.

Rruga e Arbërit nr. 98

ekspeditë

Ne kemi një Shqipëri të bukur dhe të pasur sa i përket peizazhit natyror, klimës, bimësisë, gjallesave të pyllit, të ujit, të tokës e nëntokës...

Një ekspeditë në natyrën shqiptare dhe dhjetëra probleme

Nga **Dr. GAFUR MUKA**

Ishte viti 1995. Dy miq gjermanë që kishin udhëtuar rrugës së bregdetit, duke kapërcyer Llogaranë, po tregonin përshtypjet e tyre mbi peizazhin e kësaj zone. Ishin të kënaqur me çfarë kishin parë, sadoqë edhe kritikë për mungesën e infrastrukturës turistike në këtë zonë. Teksa i dëgjoja nuk m'u durua pa thënë: po, ne kemi një bregdet vërtet perlë. Dy miqtë, seriozë, ashtu siç mund të jenë gjermanët, thanë thuajse me një gojë: i bukur ishte vërtet zoti Muka por jo perlë...

E pra ne kemi një Shqipëri të bukur dhe të pasur sa i përket peizazhit natyror, klimës, bimësisë, gjallesave të pyllit, të ujit, të tokës e nëntokës... Përkundruall kësaj Shqipërie ka qenë gjithmonë ajo që ka bërë njeriu shqiptar. Për fat të keq, në gjithë zhvillimin historik, vepra e këtij njeriu ka arritur deri në kufinjtë e të admirueshmes (betejat e Skënderbeut). Më tej si e veçantë është vlerësuar gjuha shqipe, intriguese ka qenë besa, e çuditshme ka qenë mikpritja, proverbiale ka qenë varfëria, idioteske kanë qenë vëllavrasja dhe izolimi. Të pamundur për t'u bërë tok, të pamësuar për të bashkëpunuar, të prirur për të qenë njësha, të paduruar për të gjykuar rezultatet... i kemi bërë "veprat" shkel e shko, i kemi ndërtuar dhe sakaq i kemi prishur, i kemi ringritur dhe sakaq i kemi shembur dhe... kemi mbetur pa kujtesë materiale. Kemi vetëm kujtesën e fjalës. Edhe atë e kemi asgjësuar kur nuk na ka pëlqyer.

Dhe kemi arritur në një kohë që po e quajmë koha... e lirisë së fjalës. Aq e lirë është fjala sa e ke të pamundur të kuptosh përdorimin e saj. Në këtë liri ajo që ka humbur është fjala e mençur. Ajo çfarë dëgjojmë e shikojmë është për të vënë duart në kokë. Kur shtrojmë pyetjen: si do t'i vejë halli këtij vendi? të vetmen shpresë se do bëhet më mirë e kemi tek përdorimi i atyre "çfarë na ka dhënë natyra" pra, atyre që ne i quajmë me të drejtë "bukuritë e Shqipërisë". Nuk është se nuk i njohim këto bukuri. Problemi qëndron tek përdorimi i tyre, pikërisht atje ku ato fitojnë vlerë. Të vjen vërtet keq kur dëgjon vlerësime të tilla: ju të gjitha i keni por... Dhe pas kësaj duhet shtuar: nuk dini t'i bëni të dobishme.

Këto ditë tok me studentët e diplomës "Master Shkencor në Gjeomjedis" bëmë një eskursion praktike në një rrugëkalim interesant: Mali i Robit-Golem- Patok-Shëngjin-Shkopet- Bulqizë-Peshkopi- Dibër e Madhe-Kukës-Rubik-Tiranë. Qëllimi ishte të shikonim e vlerësonim disa nga ato që natyra i vë në dispozicion njeriut dhe përdorimin që i ka bërë njeriu ofertës së natyrës. Kështu prekëm me dorë rërën e "situr" të Adriatikut, u zhytëm në ujin këndellës të detit, u harlisëm në flladin e puhizës detare, i ngopëm mushkëritë me jodin "magjik" të tij dhe... ndërkaq nuk mundëm ta njehsonin pozicionin ku ishim për shkak se sinjalet satelitore pengoheshin nga ndërtesat deri në "kupë" të qiellit dhe deri tek "lakorja" e ujit (kjo e fundit përparon thuajse 10 metra në vit për t'i kurthëzuar ndërtesat), nuk mundëm ta pirgonim rërën e "situr" pasi na ngatërroheshin nëpër duar hedhurinat, nuk mundëm t'i zhysnim këmbët në funddetin natyror pasi uji, në inatin e tij për të mos pranuar "të huajën" e kish "mbuluar" ashtu siç "mbulohet" shtatzënia me një fëmijë të paligjshëm-pasojë e një përdhunimi. Me siguri edhe uji flet. Ai ankohet se e kanë përdhunuar. Po kush e dëgjon...Politikanët, bosët e ndërtimeve, juristët... e kanë kuletën për pushime "ku t'ua dojë kokrra e qejfit". E si mund



të dëgjohet fjala e ujit?!...

Pastaj vjen toka. Hidrocentrali i Shkopetit është aty që nga viti 1963. Ai është përpjekur t'i japë njeriut atë që ka më të mirën-dritën. Dhe e ka bërë e vazhdon ta bëjë më dinjitet këtë. Studentët dëgjojnë me vëmendje historikun e përdorimit me dobi të ujit. Uji dhe drita janë një binom me dobi të përjetshme. Njeriu ka në dorë rritjen dhe uljen e kësaj dobie. Studentëve u mësohet të kontribuojnë në rritjen e saj. Shpresojmë që të kenë jo vetëm veshë për të dëgjuar.

Një ndalesë tek Ura e Topojanit. Poshtë saj rrjedh Drini i Zi. Të gjithë e dinë që në këtë rrjedhë janë ndërtuar hidocentralet më të mëdhenj të vendit tonë. Po me çfarë i shpërblejmë ne mirësitë e Drinit? Po të dëgjonim zërin e troftave të trembura, rënkimet e arave që i sulmon dhe për fat të keq i pushton furia e ujit, ankesat e shtratit mijravjeçar për vjedhjet shtratore të rërës e zhavorrit të tij do të kuptonim se edhe ky lumë është përdhunuar. Ndoshta mendon ndonjë hakmarrje.... Faktet gjeologjike nuk i përjashtojnë katastrofat. Ndaj duhet vëmendje. Dhe duhet sot. Studentët mbushin bllokun e shënimeve... Profesor Çerçizi, profesor Spiro dhe unë rekomandojmë nënvizime.

Tani jemi në Kombinatin e Gipsit. Koordinatat gjeografike na pozicionojnë në Dibër të Madhe. Adresa tregon pronësinë e firmës gjermane "Knauf". Këtu bëhet përpunimi i gipsit. Minerali është disa kilometër larg kombinatit. Ndërsa origjina e metodës së përpunimit të tij dhe stili i të punuarit ndodhen shumë kilometra larg. Gjeologu dibran, Refiku, që na shoqëron e thotë me plot gojën: Këtu trajtimi si i materialit ashtu edhe i njeriut bëhet sipas stilit gjerman. Materiali hyn "gurë" dhe del pllakë. Po njeriu? Ai hyn i angazhuar dhe del i shpërblyer. Studentët konkludojnë vetë që këtu kemi të bëjmë me një model. Si mund ta arrijmë? Ah po, kollaj fare... veçse na duhet fjala e mençur dhe puna me mend.

Minerali nxirrej në një shpat të lumit të Radikës. Me një pastërti deri në 96%- thotë gjeologu Refik. Dhe me një teknologji që nuk lejon të shkojë kot as "kokrriza" (përsëri stili gjerman). Sasitë e rezervave janë milionëshe por ky bollëk administrohet me nikoqirllëk. Brezat e sotëm duhet të mendojnë edhe për brezat e ardhshëm- u thuhet studentëve. Kaq. Epo duhet nënvizuar.

Në kuotën 600 m mbi nivelin e detit, disa metra më lart se pasqyra e ujit të Radikës është hapur galeria e kristalit. Gjatësia e saj 420 m. Veçanësia e saj- kristalet "gjigandë" dhe unikalë të mineralit të Gips-Selenit. Përjetimi ynë: marrja e kampioneve



kristalorë – dëshmia e një vizite të paharruar atje ku natyra ka bërë çudira dhe ku çudirat preken me dorë, biles "pranojnë" të futen edhe në çantën (Ruecksack-un) e prof. Çerçizit duke realizuar një nga ëndrrat e tij për t'i patur atje, në korridoret e fakultetit, si fakte gjeologjike. Po ajo që mbetet këtu? Firma "Kanuf" ka menduar jo vetëm t'i nxjerrë kristalet, por t'i bëjë ato edhe objekt gjeoturistik. Galeria do "lahet" dhe vizitorëve do t'u krijohen të gjitha kushtet ta "prekin" çudinë kristaline të ketij fenomeni të rrallë mineralogo-gjeologjik. Dhe ta dini-u themi ne studentëve- kjo nuk është "të nxjerrish dhjamë nga pleshti" por t'i trajtosh vlerat e natyrës ashtu si ato e meritojnë.



Në rrugëkalimin tonë nuk mund të anashkalohen llixhat e famshme. Studentët kanë lexuar për vlerat e ujrave termale. Ata e dinë origjinën, përmbajtjen, dobinë... Sot e ka rradhën njohja e përdorimit konkret të tyre. Vendndodhja nuk është vetëm ajo që ka bërë natyra. Këtu është ndërtuar një "qytet" kurativ. Rrjedha është disiplinuar nëpër vaska ku uji me temperaturë 38.5 0C ndjehet si në shtëpinë e tij. Këtu marrdhënia ujë-njeri ka një cilësi të veçantë. Njeriu e përfytyron ujin si një mjek, duart e të cilit "gatuajnë" mrekullinë e shërimit. Dhe mjekja që instrukton pacientët duket se i dorëzon ata tek "kolegu" i saj. Ndjehet një erë bezdisëse squfuri por kënaqësia e shërimit është ku e ku më e madhe. Studentët mësohen me erën e squfurit dhe duan të mësojnë më shumë për vlerat kurative të ujit që përmban squfur. Sa vetë e kanë provuar dobinë e tyre? Historia e shkruar për këtë është vërtet një histori suksesi. E shkruar prej natyrës dhe e certifikuar prej

Mëngjesi i 6 qershorit na gjeti tek llixhat e Peshkopisë. Qysh në fillim bie në sy që nuk kemi të bëjmë me një qytet kurativ. Shumë ndërtesa të reja, private. Një rrëmujë urbanistike. Krijohet përshtypja e përpjekjes jo vetëm për të dominuar atë që ka mbetur nga e kaluara por edhe për ta zhbërë atë. Është e qartë që vlerat kurative të ujit janë po ato, si në Dibër të Madhe. Mjeku Mentor i njeh mirë ato dhe studentët i përqasin si identike. Tani vjen radha të flitet për kushtet konkrete. S'ke ç'të bësh. Dielli nuk mbulohet me shoshë. Ambientet e plakura (jo për të pritur pleq), vaskat e ciflosura (jo për të treguar shëndet), aparaturat e heshtura (jo për të treguar respekt), shërbimet e hallakatura (jo për të treguar gjithëgjindje). Doktor Mentori shpjegon shtrueshëm vlerat natyrore të ujit, por edhe ai ndjehet keq kur na shoqëron nëpër ambientet e shërbimit. Më keq ndjehet kur studentet e pyesin për cilësitë e argjilës. "I kemi dërguar provat për analiza por akoma nuk kemi marrë përgjigje sepse duhet paguar". E ç'të thuash më tej. E mira nuk është peshk që vjen vetë në tigan.

Kemi arritur në buzë të Veleshicës, lumit të Korabit. Një lumë tekanjoz si gjithë lumenjtë malorë. Sasia e ujit varet nga stina por s'ka bërë vaki që ai të shterojë. Me siguri para se të arrijë aty tek ura e rrugës Kukës-Peshkopi, ai ka tentuar të fitojë terren në krahun lindor por... nuk ia ka dalë mbanë pasi aty ka zënë vend një masiv solid me bardhësi " të dhuruar" nga bora e Korabit (diapir, thonë gjeologët, gjeomonument, thonë vizitorët edhe pse shteti nuk e ka shpallur të tillë). Tek e hedh vështrimin tek ata shkëmbinj të gdhendur (agjentët atmosferikë nuk e marrin "rrogën" kot) kupton që edhe vetë shkëmbinjtë nuk kanë bërë shumë rezistencë. Janë shkëmbinj që përmbajnë mineralin e gipsit, një pasuri akoma e pashfrytëzuar në këto anë edhe pse sivëllezërit e tij në Dibër të Madhe kanë hyrë mysafyrë në të katër anët e botës. Me siguri edhe këta e duan këtë fat por u mungon... Knauf-i. Edhe ne, edhe studentët e marrim me vete këtë masiv (jo vetëm në fotografi) dhe shpresojmë të jemi në rrugën drejt...Kanuf-it.


Erdhi një ditë që edhe Kukësi, që nuk kishte liqen, ta ketë një të tillë. Tani, përpos të tjerash, flitet edhe për peshkun e liqenit të Kukësit. Ne e shijuam një të tillë dhe mbetëm të kënaqur. Ama, që të ketë peshk të mirë liqeni duhet të ketë dhe ujë të pa ndotur. Po ç'ti bësh që prurjet natyrale të tij mbarsen përdhunisht me aciditetin e bakrit të Gjegjanit dhe mbeturinat e skorjeve të metalurgjisë. Një rrezik i madh ky për shëndetin e liqenit. Meraku i deritanishëm është vetëm fjalë (mbase dhe letra). Studentët interesohen kur do të fillojë puna. Përgjigja e liqenit do ishte: një orë e më parë. Përgjigja e peshkut do ishte: një orë e më parë. Po përgjigja e njeriut?!

Jemi sërish në Tiranë. Udhëtimi ishte edhe i lodhshëm edhe mbresëlënës. Kërkohet njëfarë kohe për ta mbledhur veten. Por në Tiranë nuk mungon tollovia e fjalëve.

Të gjithë flasin. Pakkush dëgjon. Jemi mjaft të pasur në resurse natyrore-themi. Jeni "shih e shkruaj"- na thonë. Ec e merre vesh...







intervistë

Flet profesori, poeti, shkrimtari, albanologu, studiuesi dhe përkthyesi i njohur në arenën mbarëshqiptare

Agim Vinca: Në Dibër të Poshtme gjeta rrënjët e të parëve të mi

Intervistoi: **MENTOR HOXHA**

- Në një artikull të botuar te "Rruga e Arbërit" mësova se origjina juaj është nga fshati Vincë i Sohodollit të Dibrës. Po ashtu, mjaft artikuj të publikuar nga ju dëshmojnë qartë dashurinë tuaj me trevën dibrane. Ju mbajtët edhe fjalën e lamtumirës për intelektualin e shquar dibran, Prof. Dr. Nuri Abdiun? Diçka më shumë për lidhjet tuaja me Dibrën dhe dibranët?

-Të parët e mi, të fisit tim, Vincallarët, si themi ne, kanë rënë në Veleshtë të Strugës nga Dibra e Poshtme dhe, siç e tregon vetëm emërtimi, pikërisht nga fshati Vincë (Vojncë) i Sohodollit. Dy Vincajt e parë që mbahen mend në Veleshtë janë vëllezërit Hasan dhe Beqir, shkurt: Hasa dhe Beqa, pas të cilëve vijnë nja 12-13 breza Vincallarësh, që sot jetojnë kryesisht në Veleshtë, por edhe në Strugë, në Shkup, në Prishtinë, në disa vende të Evropës dhe në Amerikë. E pata "zbuluar" më herët, qysh në vitet '70, djepin e të parëve të mi, fshatin apo lagjen Vojncë të Sohodollit, por për të vizituar e vizitova vetëm në vitin 2000. Në verë të këtij viti qëndrova gati një ditë të tërë në këtë fshat me gjithsej 22 shtëpi e katër fise, ku gjithçka: shtëpitë, njerëzit, toka, gurët, ajri, retë, qielli, pemët, bimët, madje edhe lulet në saksi në ballkonet e shtëpive, ngjanin me ato të vendlindjes sime. Nuk po flas për gjuhën dhe zakonet. Ato dihen. Gjeta aty, thënë figurativisht, rrënjët e të parëve të mi, por edhe relikte e dëshmi materiale, si: Vorret e Vojncës, që kishin ekzistuar deri në vitin 1967 dhe pastaj ishin lavruar me traktor e kishin mbjellë patate mbi to (!) dhe Lisin e Vojncës, të madh e madhështor, me trung e zgavër sa një odë, që kishte ekzistuar deri në vitin 1990-91, kur, në vorbullën e ngjarjeve që shoqëruan ndërrimin e sistemeve në Shqipëri, i kishin futur sëpatën.

Sa i përket, tashmë të ndjerit, Profesor Nuri Abdiu, mund të them se e kam pasur mik, nga ata që njeriu mund t'i quajë me krenari "miq të shtrenjtë". Vonë e kam njohur, pas çlirimit të Kosovës, në vitin 1999-2000, në Prishtinë, por që nga takimi i parë jemi miqësuar dhe kemi mbajtur kontakte pothuajse të rregullta në vitet në vazhdim. Jemi takuar dhe kemi biseduar me mall për gjithçka, përfshirë edhe origjinën tonë të përbashkët dibrane, edhe në Tiranë, edhe në Strugë, edhe në Prishtinë. Planifikonim të shkonim bashkë një verë edhe në Sohodoll, por kjo dëshirë mbeti, mjerisht, e parealizuar. Nuri Abdiu ishte njeri me vlera të veçanta dhe me kontribut të madh në fushën e arsimit dhe të studimeve pedagogjiko-psikologjike, disa prej të cilave i theksova në fjalën që mbajta në varrimin e tij, të cilën e botoi shtypi i Tiranës, si dhe gazeta "Rruga e Arbërit".

- Dibra ka nxjerrë shumë shkrimtarë dhe studiues të shquar. Gjatë një interviste me mua të botuar te "Rruga e Arbërit", Prof. Dr. Shaban Sinani është shprehur: "Do të më dukej një mënyrë e denjë mirënjohjeje të autorëve dibranë organizimi i një panairi të librit, andej e këndej kufirit, në të shkuarën e sot, prej Josif Bagerit e Haki Stërmillit deri tek Agron Tufa e të tjerë më të rinj ose më pak të spikatur prej dijes". Si ju duket ideja e këtij studiuesi të shquar nga Dibra?

- Nuk e kam shumë të qartë këtë ide - idenë e të organizimit të një "panairi të librit, andej e këndej kufirit",panair ky që do të ishte i përvitshëm, çfarë janë, fjala vjen, Panairi i Tiranës dhe i Prishtinës, apo në ndonjë formë tjetër, por, gjithsesi, mendoj se e vlen të mbështetet dhe të përkrahet si ide. Parimisht jam kundër ndarjes së letërsisë dhe kulturës shqiptare në krahina, ngastra a mëhalla, siç do të thoshte Konica, por zona e Dibrës, shumë më shumë se simotrat e saj, ka një specifikë, që e kanë kushtëzuar rrethanat historike: ndarja e Dibrës së Madhe, e qytetit të Dibrës a "shehrit", si është quajtur ndryshe në popull, nga pjesa tjetër e krahinës, pas Konferencës së Londrës në vitin e kobshëm 1913. E tërë Shqipëria u copëtua, madje u masakrua, në tryezat e diplomacisë evropiane si pasojë e pushtimit të tokave shqiptare nga fqinjët serbë dhe grekë gjatë Luftërave Ballkanike, por Dibrës kufiri iu vu si të thuash në oborr, duke e ndarë atë nga fshatrat, nga fusha e nga malet e saj dhe duke e izoluar në mënyrën më mizore të mundshme. Në vend që edhe më tutje të komunikonte normalisht me Dibrën e Poshtme, me Matin dhe me Tiranën, me të cilat kishte komunikuar me shekuj, Dibra, qyteti, qendra e Krahinës, u shkëput nga trungu i vet dhe mbeti uloke, si një trup pa gjymtyrë, si një torzo, e rrethuar me male, me mundësinë e vetme që nëpërmjet grykës së Drinit të komunikonte me Strugën, në njërën anë dhe përmes grykës së Radikës me Gostivarin, në anën tjetër, qendra këto që jo vetëm ishin larg e nën sundim, si Dibra vetë, por as nuk kishin ndonjë kapacitet ekonomik a traditë kulturo-arsimore, çfarë e kishte ajo. Dhe kështu, Dibra e Madhe, Dibra e famshme e Said Najdenit, alias Hoxhë Vokës dhe e Josif Bagerit (ky i fundit nga Reka e Epërme) dhe e sa e sa figurave të tjera të shquara atdhetare e intelektuale, e cila historikisht kishte qenë një qendër e rëndësishme e kombit shqiptar dhe promotore e historisë së tij, erdhi duke u rrëgjuar vazhdimisht gjatë këtyre njëqind viteve të fundit dhe akoma më shumë pas Luftës së Dytë Botërore, gjë që edhe ishte qëllim i pushtuesve, i ideologjisë serbomadhe dhe i politikës shoviniste të Beogradit dhe aleatit të tij të vogël, por besnik, më pas, Shkupit zyrtar. Po tani? Sot? Tani rrethanat pak a shumë kanë ndryshuar, është shembur muri absurd, që ndante fizikisht njerëzit e një gjaku dhe të një gjuhe, që kanë të njëjtën ADN në gjene, i quajtur Kufi Shtetëror mespërmes truallit shqiptar, andaj një vëmendje më e madhe ndaj kësaj treve të rëndësishme të gjeografisë dhe të etnokulturës shqiptare, në të dy anët e kufirit, përfshirë edhe organizimet kulturore, do të ishte e mirëseardhur. Për mendimin tim si intelektual që përpiqet t'i ndjekë zhvillimet në hapësirën shqiptare, hëpërhë projekte prioritare, madje emergjente për këtë trevë dhe banorët e saj, janë: pengimi i derdhjes së ujërave të Radikës në Vardar, çështje për të cilën kam bërë një artikull muaj më parë dhe ndërtimi i Rrugës së Arbërit si një arterie që do ta lidhte Dibrën me pjesën tjetër të Shqipërisë dhe me Kosovën, e që do të ishte mbase shpëtim i saj. Uji dhe rruga, libri dhe kultura, i duhen Dibrës dhe u duhen dibranëve, sikurse gjithë shqiptarëve, kudo që janë, si buka që e hanë.



- Sa i lidhur jeni me krijuesit dibranë dhe kë vlerësoni si ndër shkrimtarët, poetët dhe studiuesit dibranë më të spikatur të të gjitha kohërave, brenda dhe jashtë trojeve shqiptare?

- Lidhjet shpirtërore nuk krijohen në bazë të përkatësisë krahinore ose, më saktë, jo vetëm mbi këtë bazë, por me kritere të tjera: afinitete, shije, botëkuptime etj. Nga krijuesit letrarë dibranë të së kaluarës Haki Stërmilli pat bërë emër si rrallë ndonjë tjetër, sidomos me romanin e tij të mirënjohur sentimental *Sikur t'isha djalë*, i cili përjetoi një sukses të jashtëzakonshëm në kohën kur u botua, në vitet '30 të shekullit të kaluar. Botimi i parë i këtij romani, ai i vitit 1936, me një tirazh prej 1100 ekzemplarësh u shit shpejt, për më pak se një vit, kurse botimi i dytë, një vit pas (1937), doli në pesë mijë kopje. Dhe kjo ndodhte në një kohë kur Shqipëria kishte rreth një milion banorë dhe një shkallë tejet të lartë analfabetizmi, që përfshinte rreth 80% të popullsisë së përgjithshme. Edhe pse receptimi i gjerë i një vepre, nuk është gjithmonë tregues i vlerës së saj, megjithatë shndërrimi i romanit *Sikur t'isha djalë* të Haki Stërmillit në "bestseller", siç do të thoshim me gjuhën e sotme, është një fakt interesant dhe i pakalueshëm historiko-letrar.

Nga krijuesit e sotëm dibranë do të përmendja, në radhë të parë, Agron Tufën, një krijues tejet i talentuar e me energji të pashtershme krijuese: poet, prozator, sudiues, përkthyes, publicist etj., krijimtarinë e të cilit përpiqem ta ndjek rregullisht. E marr shpesh në dorë sidomos librin e tij me poezi *Avangardë engjëjsh* (2005), me elegjitë brilante romake e strofat e lëmuara vjeneze dhe posaçërisht me baladat e mrekullueshme të Drinit të Zi - nga veprat letrare të tij, si dhe librin *Stacioni në shkretëtirë* të Brodskit - nga përkthimet dhe pres me padurim përkthimin tashmë të paralajmëruar të poezive të Mandelshtamit në shqip. Edhe pse ende relativisht i ri në moshë, Agron Tufa ka krijuar një opus të gjerë e të përfillshëm krijues; një vepër e cila që tani mund të bëhet objekt studimi. Por, nuk mund të mos e shprehi me këtë rast një si drojë timen lidhur me këtë krijues: drojën se mos ai, me militantizmin e tij politik, me antikomunizmin e tejtheksuar, obsesiv, do ta dëmtojë veprën dhe jetëshkrimin e vet krijues, ashtu siç e pat dëmtuar jo pak Arshi Pipa, por jo edhe Martin Camaj, i cili, ndonëse nuk ishte apolitik, ndryshe nga miku i tij më i vjetër e, besa, edhe më të ditur, Profesor Pipa, ishte shumë më i përmbajtur në këtë plan, me fjalë të tjera nuk u bë peng i pasionit politik, as në jetë dhe as në veprën e tij letrare.

Për aq sa i njoh unë krijuesit dibranë, e kam fjalën për ata nga Dibra "matanë", do të përmendja edhe dy-tre emra të tjerë. Xhafer Martini ka bërë punë të çmueshme në fushën e etnokulturës së Dibrës, trevë kjo që është një thesar i vërtetë në këtë plan: në gjuhë, në folklor, në etnografi, në kodin zakonor etj. Kam lexuar një libër të tij me titull *Optika e Schmitt-it për Skënderbeun* (Tiranë, 2009), në të cilin ky autor merr në mbrojtje, me argumente shkencore, historike dhe kulturore, heroin kombëtar, Skënderbeun, nga sulmet që i bëri figurës së tij historiani zviceran Oliver Jens Schmitt (Shmit), anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK), i pranuar në radhët e saj në moshën 39 vjeçare! Po ta kishte shkruar dikush tjetër këtë libër, ndonjë krijues më pranë vëmendjes së medias dhe të institucioneve, do të kishte pasur jehonë shumë më të madhe se ç'pati në të vërtetë dhe se ç'meriton të ketë. Përshtypje të veçantë më ka bërë edhe romani *Bibollasit* i Ramiz Gjinit, dibran edhe ky, që jeton në Amerikë; një roman satirik *par excellence*, i cili fshikullon pa pardon, por në mënyrë mjeshtërore, me një sarkazëm të tipit gogolian e suiftian, trillet e tranzicionit shqiptar dhe keqpërdorimin e njeriut nga pushteti "demokratik" sot, sikundër edhe nga ai autokratik diktatorial dikur. Ka edhe krijues (dhe studiues) të tjerë të spikatur dibranë, emrat e të cilëve nuk po i përmendi kësaj radhe, sepse nuk kam pretendime t'i përgjigjem kësaj pyetjeje në mënyrë shteruese.

- Disa nga projektet tuaja krijuese dhe një autobiografi e jetës suaj?

- Pres të dalë nga shtypi së shpejti një roman që kam përkthyer nga frëngjishtja: romani *Grahma* e *fundit* i shkrimtarit francez Romain Gary (Romen Gari), dy herë fitues i Çmimit "Gonkur", vepër që flet për Shqipërinë dhe shqiptarët dhe që besoj të zgjojë interesimin e lexuesve. Kam, sigurisht, edhe mjaft projekte të tjera në duar dhe në mend, për të cilat nuk dua të flas, sepse më duket ende herët. Ndërsa, sa i përket jetëshkrimit tim, atë do ta shkruaj ndoshta dikush tjetër ose mund ta shkruaj edhe vetë një ditë në formë kujtimesh a autobiografie, natyrisht nëse do të më premtojë koha, që rrjedh shpejt dhe pamëshirshëm.

Agim Vinca (Veleshtë, 22 maj 1947), poet, kritik letrar, historian i letërsisë, publicist, polemist, antologjist, profesor në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës, ka botuar këto vepra: Feniksi (poezi, 1972), Bregu i mallit (poezi, 1975), Në vend të biografisë (poezi, 1977), Aspekte të kritikës sonë (studim, 1977), Qasje (kritikë, 1980), Buzëdrinas (poezi, 1981), Struktura e zhvillimit të poezisë shqipe (1945-1980) (monografi historiko-letrare, 1985), Iz savremene albanske poezije u Jugoslaviji (antologji, Sarajevë, 1985), Arna dhe ëndrra (poezi, 1987), Orët e poezisë (kritikë letrare, 1990), Populli i pandalur (publicistikë, 1992), Alternativa letrare shqiptare (kritikë letrare, 1995), Kohë e keqe për lirikën (poezi, 1997), Shqiptarët mes mitit dhe realitetit (publicistikë, 1997), Dri' (poezi, përzgjedhje, Tiranë, 1999), Sonet i vetmuar (poezi, 2001), Kurs i teorive letrare. Prej antikës deri te postmodernizmi (studim teoriko-letrar, 2002), Panteoni i ideve letrare (studim teoriko-letrar, 2003), Fije të pakëputura (sprova letrare dhe kulturore, 2004), Kënga e hapur (antologji e komentuar, 2005), Psalmet e rrënjës (poezi, 2007), Letër Zotit (poezi të zgjedhura, 2008), (Po)etika e fjalës (kritikë, ese, studime, 2010), Arti i reagimit (publicistikë, 2011), Muza e Mëmëdheut (antologji e poezisë atdhetare shqipe, botuar me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, 2012), Teori letrare (botim i dytë i plotësuar, 2012) etj. Në Zvicër (Bazel) është botuar libri me poezi të zgjedhura në dy gjuhë,shqip-gjermanisht: Zogj të plagosur (Verëundete Vögel); në Bukuresht libri me poezi të zgjedhura Urnë e gjallë (Urnă vie), në përkthim rumanisht të Kopi Kyçykut dhe me parathënie të poeteshës rumune Iolanda Malamen; në anglisht (në Shkup) libri me poezi të zgjedhura The Ëorld Revolves Around the South (Bota sillet rreth jugut), pjesë e projektit të financuar nga Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë, në kuadër të të cilit janë përfshirë edhe disa autorë shqiptarë. Është përfshirë pothuajse në të gjitha antologjitë e poezisë shqipe, të botuara në Shqipëri, në Kosovë dhe në botën e jashtme, ndër të cilat vlen të përmenden: An elusive eagle soars (Shqiponja ngjitet kah qielli) e albanologut të njohur Robert Elsie (1993), e financuar nga UNESCO-ja; Antologie de la poèsie albanaise (Antologji e poezisë shqipe prej fillimeve e deri më sot) e përgatitur dhe e përkthyer frëngjisht nga Alexandre Zotos, profesor në Universitetin e Saint-Étienne-it (Francë) (1998); Misterul rugăciunilor. O antologie a poeziei albaneze de azi (Lutjet e mistershme, Antologji e poezisë së sotme shqipe) e Marin Dobreskut (2012) etj. Me rastin e 65-vjetorit të lindjes revista «Fjalë e valë», që del në Mitrovicë, ia kushtoi një numër tematik të saj, i cili doli në formën e librit nën titullin «Krijuesi i pandalur». Ka marrë pjesë në tribuna e konferenca shkencore në Prishtinë, Shkup, Tiranë, Stamboll, Romë, Paris, Nju-Jork, Berlin etj. Agim Vinca merret edhe me përkthime letrare.

(**Marrë libraria elektronike).**

Projekti i rrugës së Arbërit nuk është vetëm Tiranë-Dibër, por ka hyrë në thellësi të shtetit maqedonas.

Kryekomunari Lata: Projekti në lumin e Radikës nuk realizohet

Nga **ILIR SINANAJ**

Projekti në Lumin e Radikës në Maqedoni, i cili ka qenë para disa muajsh në fokusin e politikës dhe të mediave shqiptare dhe maqedonase, nuk do të realizohet. Nga ana tjetër ndërtimi i rrugës së Arbërit në Shqipëri, do të ishte "frymëmarrja" e nevojshme ekonomike e komunës së Dibrës dhe do të sillte mundësi të thellimit të marrëdhënieve ekonomike në shkallë rajonale. Këto ishin pikat kyçe të fjalës së kryetarit të komunës së Dibrës, Maqedoni, gjatë një veprimtarie 2-ditore me gazetarë dhe operatorë turistik nga Shqipëria, të organizuar për herë të parë nga "Macedonia Invest" dhe Agjencisë Kombëtare të Turizmit (AKT), për të promovuar bashkëpunimin në fushën e turizmit nga të dyja anët e kufirit.



Zhvillohet në Dibër turi për promovimin e bashkëpunimit turistik midis Shqipërisë dhe Maqedonisë si edhe shpaloset rëndësia e rrugës së Arbërit për ekonominë e dy vendeve.

"Kjo është një arterie shumë e rëndësishme që i nevojitet së tepërmi dhe finalizimi i saj do të shërbente si një frymëmarrje e madhe për ekonominë e këtij rajoni që ka shumë vlera turistike, kulturore, ekonomike, etj

RADIKA

Për projektin në lumin e Radikës, z. Lata është shprehur në mënyrë kategorike se nuk do të realizohet. Ai thekson se kjo gjë do të sillte dëme për shqiptarët. Ndërkaq, ai e ka cilësuar një fat të mirë për të gjithë faktin, se qeveria shqiptare ka dhënë mbështetjen e saj në lidhje me këtë problematike.

Gjithashtu kryekomunari Lata është shprehur se bashkëpunimi i faktorëve politikë të shqiptarëve të Maqedonisë dhe të shtetit shqiptar, është pozitiv, në lidhje me këtë çështje. "Sa i takon problematikës së lumit të Radikës, duhet theksuar në mënyrë taksative, se më së pari ky lum është një dhuratë e perëndisë për Dibrën dhe dibranët si dhe për trojet shqiptare, ngase buron nga trojet shqiptare dhe derdhet në detin shqiptar. Radika është simbol i Dibrës për ujë të pijshëm dhe është i vetmi lum, ndoshta në Europë, që i tërë uji i tij të jetë i pijshëm, duke qenë se rrjedh nga themelet e Korabit në sasi të konsiderueshme, pa pësuar asnjë ndotje natyrore. Por ka edhe vlerat historike, se ai ujë ka shëruar dhe furnizuar të sëmurin, ka shëruar të plagosurin dhe ka ujitur fushën e Dibrës.

Përveç kësaj, lumi i Radikës furnizon me ujë 4 hidrocentrale: një në Dibër, atë të Shpillës, dhe tre të tjerë në Shqipëri. Kjo do të thotë se, po qe se dëmtohet diçka në lumin e Radikës, dëmtohen të gjithë shqiptarët. Ne jemi kategorik kundër devijimit të lumit të Radikës. Këtë e them me besim të plotë dhe premtime të sigurta se ky projekt nuk realizohet. Banka Botërore është tërhequr. Fatmirësisht, qëndrim shumë rigoroz ka edhe nga ana qeverisë shqiptare. Me vendosmëri mund të them se ky projekt më tepër se një projekt ekonomik është projekt politik dhe nuk realizohet. Këtë gjë dibranët e treguan. Ata protestuan në Dibër, në Peshkopi, në Tiranë, në Bruksel, në Romë edhe para OKB-së. Pra ka një ndjeshmëri absolute të popullatës dibrane, në lidhje me mosrealizimin e këtij projekti. Gjithashtu kemi një rast të mirë mirëkuptimi të faktorit politik shqiptar në Maqedoni dhe të shtetit shqiptar. Prandaj Radika mbetet rrjedhë, për të furnizuar shqiptarët dhe tokat shqiptare më ujë të pijshëm", - nënvizoi kryekomunari i Dibrës, Ruzhdi Lata.

RRUGA E ARBËRIT

Ndërtimi i rrugës së Arbërit do të ndihmonte së tepërmi ekonominë e Dibrës. Por jo vetëm kaq. Rruga e Arbërit do të ngallte edhe interesin për të krijuar arterie rrugore, për të lidhur qytete të mëdha të Maqedonisë me Dibrën. "Sa i takon rrugës së Arbërit, teorikisht kemi bërë një punë të mirë. Rruga e Arbërit ka qenë Dibër-Tiranë. Tashmë, teorikisht ne e kemi zgjatur rrugën e Arbërit. E kemi bërë atë Kërçovë-Tiranë, Tetovë-Tiranë, Shkup-Tiranë. Pra, në këtë logjikë, projekti i rrugës së Arbërit nuk është vetëm Tiranë-Dibër, por ka hyrë në thellësi të shtetit maqedonas.

Në lidhje me ndërtimin e kësaj rruge, atë duhet ta ndërtojë shteti shqiptar. Nga ana jonë ne duhet të ndërtojmë rrugën Dibër-Kërçovë, e cila do të lidhte Dibrën me pjesën tjetër të Maqedonisë", - u shpreh kreu i komunës së Dibrës. Ajo që intereson më shumë investitorët, të cilët vijnë në Dibër, është largësia e qytetit me portin e Durrësit. Sipas kryekomunarit Lata, afrimi me portin e Durrësit duket faktor kyç për investime të mëtejshme në Maqedoni, por edhe për qytetin e Peshkopisë në Shqipëri. "Nëse ndërtohet rruga e Arbërit, për të shkuar nga Dibra në portin e Durrësit, do të duhej maksimumi 2 orë. Kështu që ne do të na hapej një derë shumë e madhe. Sepse të gjithë investitorët, të cilët vijnë këtu, pyesin sesa larg është porti. Prandaj shpëtimi i këtij qyteti, si edhe Peshkopisë, është rruga e Arbërit", - theksoi kreu i komunës Dibër, Ruzhdi Lata.

SI TË BËHESH DIBRAN PA QENË I TILLË?

Kreu i komunës së Dibrës, Ruzhdi Lata, tregon për një takim privat me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama, tek i cili ai i tregon, kreut të qeverisë sonë, se si mund të bëhet dibrani më i madh edhe pa qenë dibran. Kjo lidhej me ndërtimin e rrugës së Arbrit, për të cilën kryeministri Rama, u shpreh se një prononcim zyrtar për këtë do kishte në fund të muajit qershor. "Ishte para 2-javësh në Dibër kreu i qeverisë shqiptare, Edi Rama, në një vizitë private.

Në një bisedë të lirë, unë i them: "Zotëri ju dibran nuk jeni, por mund të bëheni dibrani më i madh". Më pyet se si bëhet. I them se kush e ndërton rrugën e Arbërit mbetet dibran i përjetshëm. Ai më tha: "Ruzhdi tani nuk mund të them gjë, por në fund të qershorit do të prononcohem për këtë", - tregon kryekomunari Lata.

DIÇKA PËR TË MËSUAR MË TEPËR NGA DIBRANËT

Dibra është një qytet i vogël ku pjesa më e madhe e banorëve janë shqiptarë. Ky qytet është i rrethuar nga malet dhe ka një bukuri të veçantë natyrore, duke e bërë atë një destinacion të përshtatshëm për t'u tërhequr për pak kohë nga rutina e vrullshme e një metropoli. Nga ana tjetër, nëse do të krahasohej me qytete të të njëjtave përmasa, të cilat ndodhen në Shqipëri, mund të vihet re se nga ana arkitekturore Dibra është më e rregullt dhe e strukturuar.

Njerëzit në këtë qytet janë shumë miqësor, por ajo që vihet re më shumë është se pavarësisht disa vështirësive ekonomike me të cilat përballet Dibra, ata mbeten pozitiv dhe me një mendësi më të prirur ndaj punës se në zona të caktuara në Shqipëri. Ajo që bën përshtypje në Dibër janë zonat bujqësore. Edhe në ditë të shtunë atje punohet dhe ajo që mund të theksohet për mjetet rrugore është fakti se zonat bujqësore kanë më shumë mjete bujqësore të motorizuara se sa autovetura. Të rinjtë dibranë, si shumë të rinj në Shqipëri janë të prirur për të kryer studimet e larta, por fatkeqësisht edhe në qytetin e tyre papunësia është e lartë. Mjafton një bisedë të shkurtër me ta për të krijuar një peizazh të larmishëm të gjërave të mira dhe problematikave të qytetit ku ata jetojnë.

Kjo bisedë bëhet më e këndshme kur merret në konsideratë se ajo zbukurohet nga shprehjet lakonike dhe ironike të dibranëve, për të cilat ata njihen më së mirë dhe që do të vinin në vështirësi edhe oratorin më të mirë, të trajnuar nga metodat më bashkëkohore të komunikimit. Për të përmbledhur me pak fjalë të rinjtë e Dibrës, të vetëdijshëm për probleme, që ka qyteti i tyre, vënë në pah edhe gjërat pozitive të tij. Ata kërkojnë që Dibra të mos pasqyrohet vetëm më anët negative të saj, por edhe për ato vlera që ka.

Nga ana tjetër, si shumë shqiptarë që jetojnë në troje, mbështetja kryesore që duan nga Shqipëria është një mbështetje morale. Përpos kësaj, mendoj se të rinjtë në Shqipëri kanë diçka për të mësuar nga pozitiviteti i të rinjve dibranë.

TURIZMI DHE SIPËRMARRJA NË DIBËR TË MADHE

Edhe pse një komunë e vogël, Dibra është e prirur për të promovuar vlerat e saj, në mënyrë që të tërhiqnin turistë dhe investitorë. Ajo për të cilën shquhej më shumë kjo komunë janë ujërat termalë të saj, të cilat kanë efekte kurative për sëmundje të ndryshme. Ujërat termalë në këtë zonë janë përdorur, që në kohën e romakëve, por do të ishte gjatë sundimit osman, që do të ndërtohej një hamam, për të frekuentuar atë në mënyrën e një banjoje apo hamami.

Përpos ujërave termalë, ekzistojnë edhe ndërtesa me një histori të veçantë. Një nga këto është edhe Xhamia e Sinqarit. Në vitin 1468, sultan Mehmet II ose Mehmet Pushtuesi, siç njihet në histori për fushatat e shumta luftarake të ndërmarra, ndërtoi në zonën e Dibrës, Xhaminë e Inqarit. Nga emri kjo do të thotë pendim.

Sipas të dhënave historike, kjo xhami u ndërtua në shenjë pendimi nga ana e sulltanit, për shkak të luftës së egër të zhvilluar në këtë zonë, duke u marrë jetën shumë dibranëve.

Një tjetër ndërtesë interesante është edhe manastiri i Shën Gjergj Ngadhënjimtarit , i cili ka një kopsht të bukur me trëndafila, dhe brenda tij besohet se janë një pjesë e eshtrave të Shën Gjergjit. Për sa i përket pasurive natyrore, Dibra është vendi i parë në Europë për mineralin gips më cilësor me pastërti 99.9%. Vetëm dy zona ekzistojnë në botë, të cilat kanë gips me cilësi të tillë: njëra është në Dibër, ndërsa tjetra në Meksikë. Sipërmarrjet kryesore në Dibër janë ato bujqësore, prodhimi i të cilave është i mjaftueshëm për të përmbushur nevojat e zonës.

Ndërkaq, një tjetër sipërmarrje e zonës është edhe prodhimi i jufkave, për të cilat mund të themi se janë makaronat tradicionale shqiptare, dhe për të cilat Dibra është e famshme për këtë prodhim të vetin.

Ndërkaq, sipërmarrësit e Dibrës shprehin nevojën për ndërtimin e rrugës së Arbërit, për të thelluar shkëmbimet midis Shqipërisë dhe Maqedonisë. Këtë gjë e thekson edhe përfaqësuesi i "Invest Macedonia", z. Fatos Mustafa, i cili në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Turizmit, zhvilloi një tur historik në Dibër, për të thelluar bashkëpunimin turistik midis Shqipërisë dhe Maqedonisë. "Kjo është një arterie shumë e rëndësishme që i nevojitet së tepërmi dhe finalizimi i saj do të shërbente si një frymëmarrje e madhe për ekonominë e këtij rajoni që ka shumë vlera turistike, kulturore, ekonomike, etj", - shprehet ai.

(Marrë nga gazeta "Shekulli")

Keni ndonje shqetesim per te ndare me komunitetin?

SHKRUANI NË GAZETË! BASHKËPUNO EDHE TI!

< rrugaearberit@gmail.com >

Çfarë po ndodh me Radikën?

Të krijohet përshtypja se kohëve të fundit, sidomos gjatë periudhës parazgjedhore por edhe pas saj (zgjedhje parlamentare dhe presidenciale në Maqedoni) vërehet një përgjumje dhe nuk evidentohet ndonjë veprimtari, të paktën jopublik për sa i përket çështjes së Radikës dhe ndërtimit të dy hidrocentraleve në parkun nacional të Mavrovës, ai në fushë të Llukovës dhe ai në urë të Boshkut, si nga sektori qeveritar po ashtu edhe nga sektori qytetar.

Siç duket e vërteta qëndron diku mes asaj se faza para dhe pas zgjedhore, respektivisht periudha deri në formimin dhe funksionimin e plotë të qeverisë së re të Maqedonisë, e ka shtyrë për më tej aktivitetet lidhur me projektet në fjalë, apo ndoshta mungesa e financave për realizimin e projekteve në fjalë ka bërë stopimin e tyre.

Duke pas parasysh vendosmërinë e Qeverisë së RM për realizim të këtyre projekteve energjetike, frymë e cila u shpreh haptas edhe përmes manifestit dhe platformës së partisë më të madhe maqedonase VMRO-DPMNE gjatë periudhës parazgjedhore, ku haptas bëhet e ditur se Qeveria (lexo VMRO-DPMNE) nuk ka ndërmend të tërhiqet prej këtyre dy projekteve, duket se bëhet fjalë vetëm për një pezullim të përkohshëm të kësaj agjende dhe ka shumë mundësi që tani me formimin e Qeverisë të fillojnë aktivitetet e planifikuara pikërisht në periudhën e verës, kur pjesa më e madhe e qytetarëve shfrytëzojnë pushimet verore, kështu që do ishte një periudhë shumë e përshtatshme për te realizuar projektet të cilat në natyrën e vet janë thellë negative dhe degraduese për të gjithë dibranët, por jo vetëm për ata.

Aspekti tjetër i cili shkon në favor kësaj teze është dokumenti i gjatë pritur i Bankës Botërore "ESIA" (Environmental Social Impact Assessment), i cili pritet të sqarojë se cilat janë ndikimet mjedisore dhe sociologjike të projektit "Lukovo Pole". Siç është mësuar më herët nga burime të sigurta, ky raport, edhe pse është gati qysh në fund të Janarit të këtij viti, me kërkesë të ministrit të atëhershëm të ekonomisë z. Valon Saraçini, publikimi i këtij raporti shtyhet deri sa të përfundojë krejt procesi zgjedhor dhe formimi i qeverisë së re. E pra, e njëjta gjë do ndodhë edhe me këtë raport, pra publikim i tij në periudhën e pushimeve verore. Ky raport pritet të bëhet publik shumë shpejt, ndoshta qysh në javën e parë të korrikut dhe sipas procedurave të Bankës Botërore, i njëjti do të duhet të qëndrojë për 120 ditë "on-line" në ueb sajtin e Bankës Botërore për diskutim publik, kështu që secili qytetar i interesuar mund të parashtrojë ankesat e tij lidhur me ndikimin negativ ekologjik dhe social që bart projekti Lukovo Pole. Shpresojmë se shumë të interesuar do të lidhen me këtë diskutim publik elektronik dhe do përcjellin JO-në e tyre në mënyrë të argumentuar.

Nga ana tjetër, sidomos për periudhën e qershorit, nuk mund të thuhet se sektori qeveritar ka rënë në letargji totale. Edhe pse gjallëria e sektorit qytetar, posaçërisht në Dibër nuk ka qenë në nivelin e duhur, përsëri disa aktivitete të cilat janë realizuar jashtë Dibre, kryesisht në Shkup.

Kështu duhet përmendur pjesëmarrja e z. Bardhyl Marku si njëri ndër aktivistët kryesorë së ai përket çështjes së mbrojtjes së Radikës në disa aktivitete si: tryeza të rrumbullakëta, konferenca dhe intervista me disa mediume Evropiane.

Në këtë drejtim do përmendim pjesëmarrjen e tij në konferencën ndërkombëtare "ENGAGE 3" e cila u



Protestë para zyrave të Bankës Botërore nga aktivistë të Riwer Watch.

Dibranët kurrë nuk do pajtohen me humbjen eventuale të Radikës

mbajt në Shkup me datë 14.06.2014, me moto "Aktivizimi qytetar". Në këtë konferencë, Z. Marku prezantoi edhe njëherë problemin, rëndësinë dhe aktivitet e realizuara në drejtim të mbrojtjes së lumit Radika dhe parkut nacional të Mavrovës si në Maqedoni (në Dibër dhe në Shkup) po ashtu edhe jashtë saj (Shqipëri, Itali dhe SHBA). Ai gjithashtu potencoi rëndësinë jetike të Radikës për Dibranët por edhe për banorët e Rekës, duke theksuar se përskaj pasojave ekologjike katastrofale që sjellin këta dy projekte për dibranët dhe liqenin e Dibrës, ai bëri shumë të qartë se DIBRANËT KURRË NUK DO PAJTOHEN ME HUMBJEN EVENTUALE TË RADIKËS dhe se kjo letargji në dukje nuk do të thotë se aktivizmi qytetar në Dibër ka përfunduar. Sipas tij dibranët do i shkojnë deri në fund kësaj çështje me mbështetje apo jo të pushtetit vendor në Dibër.

Kur jemi të Pushteti Vendor në Dibër, fitohet përshtypja se udhëheqësia e atjeshme, edhe pse përmes deklaratave publike ka bërë të ditur se nuk do të realizohet projekti "Lukovo Pole" (për projektin tjetër "Ura e Boshkut" kohëve të fundit nuk është evidentuar ndonjë qëndrim i prerë i pushtetit vendor nëse e mbështesin apo janë kundër këtij projekti) përsëri, duke pas parasysh qëndrimin e palëkundur të Kryeministrit, Z. Nikola Gruevski, i shprehur qartë edhe gjatë periudhës zgjedhore, mund të thuhet se qëndrime e bëra publike të Pushtetit Vendor në Dibër janë të pamjaftueshme. Nisur nga Pushteti Vendor duket se nuk ka asnjë strategji alternative se do mbrojë interesat e dibranëve, a atyre dibranëve të cilët në zgjedhjet e fundit lokale u dhanë besimin në përqindje jashtëzakonisht të madhe.

E pra ata e kanë një obligim moral që të përgatisin plan për mbrojtje të qytetarëve të tyre dhe jo të presin në mëshirën e Z. Gruevski. Çfarëdo që të ndodhë, e dinë shumë mirë të gjithë, dibranët dinë të çmojnë dhe të vlerësojnë të mirën, por dinë gjithashtu edhe të dënojnë të keqen, këtë e dinë më së mëri ata që sot udhëheqin pushtetin vendor.

"Kjo periudhë ka qenë shumë e ngjeshur, tha për gazetën "Rruga e Arbërit", Bardhyl Marku. "Unë tha ai, e kam ngritur çështjen e Radikës në disa mediume të vendit dhe të huaja, veçanërisht në disa media të Gjermanisë dhe Zvicrës". "Kësaj çështje do ti shërbejë edhe takimi që do të mbajmë me kryetarin e Republikës së Maqedonisë, Z. Gjorge Ivanov, i cili është parashikuar të mbahet me 30 qershor 2014". Mbi rezultatet e këtyre takimeve, gazetë do të njoftojë në numrat e ardhshëm.

Por ndërsa veprimtaritë në Dibër, si nga shoqatat joqeveritare ashtu edhe nga pushtetit vendor, janë në të pakta, miqtë e Dibrës dhe shoqatat ekologjiste joqeveritare në Maqedoni po përpiqen të jenë aktivë për mbrojtjen e parkut nacional të Mavrovës dhe lumit Radika.

Kështu, shoqatat e ndryshme ekologjike nga Shkupi: MES, Eco Svest, Front21/42, koalicioni "Maqedonia e Gjelbër" etj., por edhe jashtë Maqedonisë: River Watch, Euronatur, IUCN etj., kanë qenë mjaft aktivë edhe gjatë muajit qershor. Kështu është në vijim fushata për vetëdijesim "Save the blue hart of Europe (http://balkanrivers.net), e cila realizohet në Maqedoni por edhe në Shqipëri për mbrojtje të lumenjve Vjosa dhe Radika, ndërsa në të njëjtën kohë realizohet online peticioni nga Riwer-Watch (https://www.rainforest-rescue.org/mailalert/947/macedonia-no-dams-in-mavrovo-national-park), i cili deri në momentin e përmbylljes së gazetës ka kap numrin e 68640 nënshkrues.

Ky peticion do i dërgohet Bankës Botërore dhe Kryeministrit të Qeverisë së RM me apel për ndalimin e këtyre dy projekteve me ndikim të madh negativ jo vetëm për Dibrën por edhe shumë më gjerë.

Korresp. "Rruga e Arbërit"



2 milionë fidanë për Parkun e Lurës

Megjithëse Lura është shpallur Park Kombëtar dhe mbrohet me ligj, gjatë viteve të tranzcionit është prerë dhe shkatërruar nga kontrabandistët, të cilët nuk kanë kursyer as pemët e vjetra e të rralla.

Prerjet e paligjshme dhe të vazhdueshme kanë bërë që dëmi ekonomik, turistik dhe mjedisor në këtë perlë të natyrës të jetë i pallogaritshëm.

Ministria e Mjedisit ka vendosur që të ndërhyjë më në fund jo thjesht për të frenuar shkatërrimin e cfarë mund të ketë mbetur, por për të rimbjellë parkun dhe pastruar liqenet e mrekullueshme.

Ministri i Mjedisit, z Lefter Koka inauguroi më 13 qershor fazën e parë të një projekti për fillimin e punimeve për rehabilitimin dhe ripyllëzimin e Parkut Kombëtar të Lurës. Ai inspektoi zonën në hyrje të Parkut Kombëtar Lurë dhe përuroi fazën e parë të punimeve, pikërisht në rrugën hyrëse të Parkut.

"Dikur Lura ishte simbol i bukurisë së natyrës Në dy dekadat e fundit ajo u shndërua në simbol të masakrës mjedisore. Me këtë projekt synojmë ta kthejmë Lurën në gjendjen e mëparshme. Do të fillojmë me infrastrukturën hyrëse në Park ku do të rehabilitojmë 20 km rrugë për ta bërë udhëtimin e cdo vizitori, të qetë dhe të sigurtë. Pas kësaj do të fillojmë ripyllëzimin me 2 milionë fidanë", tha ai në fjalën e tij.

Duke iu referuar projekteve të rehabilitimit që do të vijojnë në javët e ardhshme Ministri i Mjedisit u shpreh për mediat:" Gjetëm një buxhet të boshatisur, dhe më pak se sa një vit, po zbatojmë projekte që do ta transformojnë tërësisht mjedisin dhe natyrën shqiptare. "

Projekti për Rehabilitimin dhe Pyllëzimin e Parkut Kombëtar të Lurës, i financuar nga Ministria e Mjedisit, fillon me rehabilitimin e 20 km rrugë për ta bërë udhëtimin e cdo vizitori, të qetë dhe të sigurtë. Projekti përfshin vendosjen e sinjalistikës informuese për vendet me interes për t'u vizituar ku 27 tabela do të informojnë këdo që dëshiron të njohë Parkun Kombëtar të Lurës. Pas kësaj do të fillojë ripyllëzimi i Parkut Kombëtar gjatë të cilit do të mbillen 2 milionë fidanë. Rehabilitimi do të përfshijë edhe peisazhin natyror të 7 liqeneve të Lurës. Liqenit të Luleve do t'i kthehet pamja e dikurshme duke rehabilituar pasqyrën ujore të tij.

"Janë mbi 2 milion pemë që janë planifikuar të mbillen në një sipërfaqe prej 300 hektarë. Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit, Alqi Bllako tha se Ministria e Mjedisit ka kontraktuar dy subjekte private, të cilat deri në fund të vitit duhet të kenë përfunduar shtrimin e 18 kilometrave rrugë dhe rehabilitimin dhe pastrimin e gjithë liqeneve".

"Investimi në Parkun Kombëtar të Lurës, në harkun e një vit mendohet të shkojë në vlerën e mbi 1 milion dollarëve të dhëna vecanërisht për rikthimin në identitet të këtij Parku, ku faza e parë do të jetë rehabilitimi i infrastrukturës rrugore hyrëse në Parkun e Lurës, vendosja e sinjalistikës orientuese, pastrimi i ambienteve të parkut dhe liqeneve të tij, për të kaluar më pas në fazën e dytë tek ripyllëzimi i parkut në një sipërfaqje rreth 300 hektarë. Fidanët që kryesisht do të mbillen janë robull, arni dhe hartine", tha për Top Channel Alqi Bllako.

Rehabilitimi i Parkut Kombëtar të Lurës synon të krijojë mundësi për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në zonën e Lurës, të ofrojë mundësi punësimi për banorët vendas, duke synuar të minimizojë presionet ilegale mbi resurset natyrore të zonës si dhe të vendosë ekuilibrin e zhvillimit të turizmit rural, në funksion të resurseve natyrore dhe produkteve që ofron zona.

Rritja e fluksit të vizitorëve në Park, duke përmirësuar infrastrukturën rrugore hyrëse dhe guidën informuese për vendet me interes për t'u vizituar dhe përmirësimi i peisazhit natyror rreth liqeneve janë pjesë e qëllimeve të këtij projekti.



Përtej matit – sa afër dhe sa larg!



Zhvillimi është në dorën tonë, është në pasuritë tona, është te vlerat tona tradicionale...

Nga **BESNIK ALKU**

Mali, lumi, kodra apo një objekt tjeter gjeografik, në të shumtën e kohës ka qenë elementi përcaktues i ndarjes së kufijve mes shteteve por edhe molla e sherrit mes tyre. Në Europën moderne, bashkëpunimi rajonal dhe mekanizmi që sjell zhvillimin rajonal është pikërisht objekti i përbashkët gjeografik, pa vënë në dukje kufirin apo etninë e popullsisë që jeton në këtë rajon. Kështu, kemi masa të përbashkëta zhvillimi për zonën e Alpeve të Europës, të vendeve të Balltikut, të Mesdheut e shumë shembuj të tjerë.

Vargmali Deshat – Korab, maja e të cilit është kufiri ndarës shtetërorë mes Shqipërisë dhe Maqedonisë, është objekti gjeografik i zhvillimit të përbashkët të turizmit të qëndrushëm në dy anët e kufirit, duke përfshirë tetë njësi vendore në Dibër (Kala e Dodës, Sllovë, Fushë-Çidhën, Kastriot, Tomin, Peshkopi, Melan dhe Maqëllarë) si dhe komunat e Dibrës, Rostushës dhe Mavrovës në pjesën e Maqedonisë. Para disa ditësh në kuadër të projektit ""Zhvillimi i qëndrueshëm rural në zonën e vargmalit të Deshatit" financuar nga IPA cross-border mes Shqipërisë dhe Maqedonisë, zbatuar nga ANTTARC, ALCDF në Shqipëri dhe LCDF dhe CSCD në Maqedoni, e që promovon zhvillimin e turizmit malor në vargmalin e Deshatit, mora pjesë në një udhëtim studimor, si pjesëtar i Grupit të Veprimit Lokal për zhvillimin e Turizmit në të dy anët e kufirit.

Ekzistonte një ndjesi e përgjithshme te të gjithë pjesëmarrësit, përfaqësues nga pushteti lokal, shoqërisë civile, biznesit të hotelerisë dhe turizmit, që Dibrën e Madhe dhe pjesën e fshatrave në anën tjetër të vargmalit Deshat-Korab e kemi parë me qindra herë dhe e njohim shumë mirë, por meqë krijohet mundësia të jemi të organizuar, le të shkojmë edhe ta shohim përsëri.

NGA BLLATA NË BANISHT

Mirëseardhja në pikën kufitare të Bllatës. Na pritën dhe na uruan përfaqësuesit e Grupit të Veprimit Lokalë për Turizmin në Dibër të Madhe, Shuip Marku, Flamur Mulladauti, dhe Lumturi Marke. Shuipi dhe kolegët e tij na urojnë mirëseardhjen dhe na shpjegojnë që do përpiqemi të shikojmë gjatë vizitave vendet sa më simobolike të këtij rajoni.

Vizitën e parë e filluam në fshatin Banisht, ku është ngritur kompleksi balnearë "Capa" ose Llixhat e Dibrës, që për vetitë e tyre kurative frekuentohen nga Shqipëria dhe Maqedonia.

Që në pamjen e parë, mrekullia e peisazhit malor të Kërçinit të mahnit me gjelbërimin e tij dhe në oborrin e kompleksit balnerarë të duket sikur e gjithë fusha e Maqellarës, Gjoricës, Shupenzës dhe Drinit të Zi që lundron mespërmes kësaj fushe, janë në dorën tënde. Po të mos jetë aroma e squfurit që të nxit të shohësh me imtësi investimin nga "Capa", të duket vetja si strateg ushtarak.

Menaxherja e qendrës na shoqëron dhe na tregon për çdo funksion dhe mjedis të kompleksit, duke filluar nga vizita, trajtimi fizik (masazhi, kinetika dhe balta) dhe kalon në të gjitha mjediset e tjera të trajtimit kurativ dhe të shërbimeve të tjera të hotelerisë, restorantin dhe gjelbërimin përreth. Pas qendrës balneare është dhe pjesa historike e rikonstruktuar dhe burimet natyrore të ujit të ngrohtë të llixhave që për vlerat kurative të tij është certifikuar me çmimin e parë në nivel europian nga një kompani franceze.

QYTETI I VOGËL I DIBRËS SË MADHE

E lëmë Banishtin dhe nisemi për në Dibër të Madhe. Shuipi dhe Flamuri, me modestinë që i karakterizon, fillojnë dhe na "përgatisin" për surprizat. "Dibra e Madhe ka vetëm emrin, sepse ajo është një qytezë e vogël me 9000 banorë, por që në verë shtohet shumë nga kurbetqarët, që më së shumti jetojnë në Amerikë. Rreth 14000 kurbetlij vetëm nga Dibra."

Ndalemi në qendër të qytetit, te Pallati i Kulturës, ku janë dhe zyrat e Grupit të Veprimit Lokalë Deshati për Dibrën, dhe ku përfaqësuesit e tij na urojnë mirëseardhjen dhe na njohin me programin e vizitës.

Flamuri, Lumi dhe Shuipi na shoqërojnë përgjatë vizitës sonë në lagjet dhe sokaqet e Dibrës. Çdo lagje ka një histori, çdo sokak ka

"Dibra e Madhe ka vetëm emrin, sepse ajo është një qytezë e vogël me 9000 banorë, por që në verë shtohet shumë nga kurbetqarët, që më së shumti jetojnë në Amerikë. Rreth 14000 kurbetlij vetëm nga Dibra."

një ngjarje dhe çdo shtëpi mbart një motiv fisnik interesante. Të papërtuar Flamuri dhe Shuipi na tregojne për **Kodrën e Kasapit**, lagjen e Bejlerëve, për **historinë e Hoxhollëve,** si sunduesit e Dibrës, por që në rrjedhat e historisë u përshtatën me interesat më të mira të Dibranëve, për **sokakun e Dacit** dhe paprekshmërinë e tij, për **kuvendin e Dibrës**, për shkollën e parë shqipe, për traditën e pastërtisë së grave dibrane që pastrojnë rrugicat herët në mëngjes dhe lyejnë më gelqere avllitë, traditë që e transferuan dhe në lagjet e dibranëve në Tiranë dhe në Shkup, e kudo që kanë emigruar.

Vazhdojmë dhe përshkojmë Dibrën në vizitën në **xhaminë e Inqarit** që është një nga xhamitë më të vjetra në Ballkan, e ndërtuar vetë nga Sulltani, në varrin e Hoxhollit (që po nuk e dijte se sa këmbë ka, thuhet që nuk je nga Dibra), në kompleksin industrial të Gjipsit të kompanisë "Knauf", në lagjen e re që është ndërtuar pas tërmetit të 1967-ës, vazhdojmë përgjatë liqenit të pastër të Dibrës, ku bashkohet Radika dhe Drini i Zi, dhe vazhdojmë më **Xhaminë e re** të ndërtuar me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë, e cila në shenje të këtij jubileu ka 100 dritare dhe simbolin e Tiranës, sahatin e tij, ku dibranët kanë historinë e tyre, kontributin e tyre në ndërtimin e zhvillimin e saj, por nga ku kanë marrë dhe mikpritjen e tiranësve, për të cilët u janë mirënjohës.

SHTEGU TURISTIK

Shtegu turistik, që po ndërtohet kryesisht për amatorët e ecjes në këmbë, fillon në pikën kufitarë të Bllatës dhe vazhdon përgjatë malit të Kërçinit në Banisht, përgjatë pjesës së sipërme të Dibrës dhe përfundon në Kosovrast.

Vazhdojmë rrugën për të vizituar kompleksin tjetër balnearë kurativ të Kosovrastit, ku dhe përfundon shtegu turistik. Rrugës për në Kosovrast, Flamuri na tregon për fshatrat rreth Dibrës të cilët për të gjithë pjesëmarrësit janë të njohur kryesisht për faktin e mbiemrave, që banorët e këtyre fshatrave që jetojnë në Peshkopi apo Tiranë ka marrë si mbiemer, si fshati Përpanik, Ballance, Gorence, dhe Kosovrast.

Para se të shkojmë në Kosovrast, ndalemi ne **manastiin e Shën-Gjergjit,** ku janë vendosur shumë motra të besimit ortodoks. Një manastir i rregulluar më së fundmi, me nje aritekturë shumë të bukur dhe me një oborr të mbajtur



E bukur, e pastër dhe plot hijeshi Radika vazhdon të rrjedhë hijerëndë në Drin, dhe ne ngjitemi përpjetë Mavrovës.

Ndalesa e radhës është në manastirin e St. Jovan Bigorski, ose në shqip Mbigurit, një manastir i famshëm për bukurinë dhe arkitekturën e tij madhështore, por dhe për historinë e tij...

shumë mirë. Ky manastir shërben dhe si qendër rehabilitimi për vajzat dhe gratë që kanë problem me drogën, alkoolin apo kanë qenë pjesë e trafikimit.

Për Flamurin, çdo manastir dhe kishë ka histori shqiptare, pasi kanë qenë ngritur nga shqiptarët, por sot këto histori deformohen, uzurpohen dhe përvetësohen nga Maqedonët.

Më pas vizitojmë **qendrën balneare të Kosovrastit**, gjithashtu pronë e kompanisë 'Capa", shumë e mirorganizuar me të gjitha shërbimet dhe funksionet dhe me një mjedis shumë tërheqës. Lumi, na shpjegon që kjo qendër ka dhe një rit të veçantë për të rinjtë që martohen në Dibër, pasi dhëndurët, në momentin e fundit të beqarisë, vijnë dhe lajnë mëkatet e beqarisë në llixha, dhe këtu organizohet dhe festa e beqarisë me shoqërinë.

LUGINA E RADIKËS

Rruga për Shkup, kalon përgjatë **luginës së Radikës**, e cila është shumë e famshme këto ditë në medien dhe opinionin Shqiptar, për shkak të projektit të devijimit që mendohet se do ndodh pas ndërtimit të një hidrocentrali.

E bukur, e pastër dhe plot hijeshi Radika vazhdon te rrjedhe hijerëndë në Drin, dhe ne ngjitemi përpjetë Mavrovës. Ndalojmë dhe shikojmë një nga monumentet e bukura të natyrës, një degë të Radikës dhe urën e "Kaprollit" e ndërtuar që në kohët e lashta, por me një stil të veçantë në ndërtimtari dhe me një lartësi shumë të madhe, e cila shoqërohet me freskinë e lumit dhe peisazhin e bukur të pyjeve krijonte një mjedis tërheqës dhe relaksues.

Vazhdojmë përgjatë grykës së Radikës dhe ndalesa e radhës është në **manastirin e St. Jovan Bigorski,** ose në shqip Mbigurit, përshkak të ndërtimit të tij mbi gurin e shtufit.

cyan magenta yellow black

reportazh



Ne duhet më shumë të bashkëpunojmë mes vetit. Pse duhet vetëm projekte nga EU të na nxisin të bashkëpunojmë, pse të mos kemi bashkëpunim të përhershëm mes nxënësve të shkollave, mes të rinjve, mes fermerëve, mes biznesit, mes pushtetit lokal, mes kulturës, mes historianëve, mes shoqërisë civile, e shumë e shumë bashkëpunime të tjera.

Një manastir i famshëm jo vetëm për bukurinë dhe arkitekturën e tij madhështore, por dhe për historinë e tij, i cili është i ndërtuar nga mjeshtrat vendas si dhe punimet e bukura të drurit dhe afresket janë bërë nga vëllezërit që banonin në këtë zonë. Gjithashtu ky manastir shquhet dhe për shërimin e sëmurëve të ndryshëm.

NGA MAVROVA NË REKË

Ngjitemi sipër grykës së Radikës për në **qendrën e Mavrovës**, ku përshkojmë disa fshatra karakteristikë malorë që pothuajse janë të braktisur, por që shfrytëzohen për turizmin sezonal malorë dhe për fundjava.

Banorët e këtyre fshatrave të komunës së Rostushes dhe Mavrovës, ose sic njihet ndryshe **krahina e Rekës** ka popullsi myslimane dhe ortodokse, ku si çdo gjë ballkanike është e ngatërruar. Pjesa ortotodokse njihen si maqedone, por që flasin shqip, dhe pjesa myslimane njihet si "Torbeshe" dhe here-here Turke dhe flasin maqedonisht.

Në qendër të Mavrovës, ndodhet pika e informimit turistik që ofron informacionin e duhur profesional për çdo vizitor në parkun e Mavrovës, dhe ku ndodhet kompleksi i skive më të mëdha në Maqedoni. Në Mavrovë janë dhe shumë shtëpi pushimi që frekuentohen si në dimër dhe në verë, dhe shumë hotele me standarte të një turizmi të zhvilluar malor, trashëgimni që në kohën e ish-Jugosllavisë, por që janë bërë dhe investime në kohët e fundit, dhe ku Shqiptarë nga Shqipëria kanë investuar shumë para në shtëpi dhe hotele.

Ngjitemi mbi Mavrovë dhe marrim rrugën për në **fshatin Galicnik**, një fshat tipik malorë i famshëm për lartësinë e madhe ku ndodhet dhe për festën tradicionale të "dasmës së gallacnikut", e cila mbahet ne korrik, dhe njihet dhe si festa e Shën-Pjetrit, ku mblidhen shumë turistë nga e gjithë Maqedonia dhe vende të tjera.

Një fshat që shtrihet në kullotat alpine dhe që është i famshëm për djathin e verdhë ose siç njihet ndryshe 'kackavall' dhe që mendohet që nga këtu e ka origjinën. Në pllajat e mëdha, kullosin me dhjetëra tufa bagëtish dhe janë ngritur disa stane, një mjedis tipik malorë, më kuaj dhe qen stani, dhe ku rrugës e ke shumë të lehte të të presë rrugën kaprolli dhe shumë kafshë te tjera të egra, gjë që dëshmon për mbrotjen e faunës dhe të florës.

Pas një kafeje në qendër të fshatit, marrim rrugën për tu kthyer në Dibër, dhe ku ndalojmë buzë liqenit për të ngrënë një drake. Për ironi të fatit gjejmë të njëjtin ushqim si çdo restorant I thjeshtë në Maqedoni. Megjithëse je në Dibër të Madhe, mos kërko të gjesh "jufka me pulë", "sheqerpare" apo gatime të tjera tradicionale, pasi ato nuk shërbehen. Kjo tregon që dhe dibranët janë akoma larg turizmit tradicional, ku më mirë gatuajnë një makaronë "all-italiane" se një pulë më jufka.

NË KOMUNËN E DIBRËS SË MADHE. REFLEKTIME DHE IDE

Megjithëse kemi qenë shumë herë në Dibër, akoma nuk e njohim atë. Dhe pyesim veten: A do kujdesemi edhe ne në Dibrën e Shqipërise për monumentet fetare, historike dhe kuturore?

A do e mbrojme florën dhe faunën si në Mavrovë? A do t' restaurojmë shtëpitë e braktisura në fshat? A do t'I bëjmë fshatrat tona të Rabdishtit, Zagradit, Radomirës, Sllovës apo fshatrat e tjera si Gallacnikun? A do i bëjmë Llixhat e Peshkopisë si kompleksi i Banishtit dhe Kosovrastit?

Vizita e fundit ishte në zyrat e kryetarit të komunës z. Ruzhdi Lata, i cili ashtu siç ishte i madh ne trup, ishte i madh dhe në vyrtytet e mikëpritjes.

Mes fjalevë të ngrohta dhe pritjes të përzemërt, kryetari i komunës ngriti dhe një sërë problematikiash që lidhen për zonën tone, e cila fatkeqësisht ka mbetur si nje xhep i harruar si i qeverisë së Shkupit dhe Tiranës. Por kjo nuk do të thotë që ne të harrojmë veten.

Ne duhet më shumë të bashkëpunojmë mes vetit. Pse duhet vetëm projekte nga EU të na nxisin të bashkëpunojmë, pse të mos kemi bashkëpunim të përhershëm mes nxënësve të shkollave, mes të rinjve, mes fermerëve, mes biznesit, mes pushtetit lokal, mes kulturës, mes historianëve, mes shoqërisë civile, e shumë e shumë bashkëpunime të tjera. Por, ne duhet të jemi më të angazhuar, duhet të heqim disa paragjykime dhe kritika të tepërta mes vetit, të përpiqemi dhe të promovojmë çdo vlerë, që për hir të vërtetës kemi shumë e shumë, por që pak i promovojmë dhe ato më shumë na i promovojnë të huajt se vetë neve.

Nuk duhet të presim që të na zhvillojë vetëm Shkupi apo Tirana, ata të na bëjnë rrugën e Arbërit këtë duam nga ata. Zhvillimi është në dorën tonë, është në pasuritë tona, është tek vlerat tona tradicionale dhe historike, është tek njerëzit punëtorë tanët, por që duhet nxitje, bashkëpunim dhe të mësojmë nga eksperiencat e mira të njërit-tjetrit, jo nga përtej kufirit dhe këtej kufirit, por nga njëra anë e malit dhe nga ana tjetër e tij.

U ndamë nga kolegët tanë të Dibrës së Madhe, për të kaluar në anën tjetër të malit. Dhe për pak ditë do i shohim gjërat "sikur të ishin në anën tjetër të malit", por me një siguri dhe besim që edhe ne do bëhemi një ditë si përtej malit. Pse jo, edhe më mirë!

Botime të reja

"Përtej ëndrrës", një libër me hapësirë, ide dhe përmbajtje...

"Përtej ëndrrës... Një titull ky që sjell te lexuesi një mesazh tepër të qartë", shkruan në hyrjen e librit redaktorja Violeta Neziri. "Nga vetë titulli dallohet se autorja është një personazh real në kërkim të ëndrrave të saj, që burojnë nga skuta të thella të shpirtit. Një titull i goditur, pasi na çon në realitete (përtej ëndrrës), ku jetojnë e pushojnë të rinjtë dhe lexuesit e moshës së adoleshencës. Tregon hapësirë në ide dhe përmbajtje...

Autorja kërkon të gjejë veten në mjedise që janë të gjithkundgjetshme (në çdo vend).

Kryesisht uni lirik shfaqet ndjeshëm, ku stili dhe tematika, të cilat trajtohen, janë të spikatura dhe dallohen qartë në vargje.

Personazhet janë fantastike dhe reale. Urimja lufton me ndjenjat dhe pasqyron ndjesitë e saj që përtërihen e fuqizohen nga pjesa në pjesë.

Figuracioni është i thjeshtë, i goditur, për të përcjellë më qartë idetë dhe mesazhet.

Shihet nga autorja libri si dritare e diturisë, e formimit të saj dhe brezave.

Ky libër, ashtu si dhe libri i saj i parë, besoj se do të jenë shtysë dhe inkurajim për hapa më të rëndësishëm në jetën e saj. I uroj suksese në punën krijuese. Në këtë rrugë sa të bukur, aq edhe të vështirë", përfundon hyrjen e saj Violeta Neziri. .

Ky libër u botua falë kontributit bujar të zotit Shkëlzen Qoka.

Libri shoqërohet edhe me një recensë në fund nga poetët Isuf Miha dhe Dali Tërshalla.



Urime Straka
PËRTEJ ËNDRRËS

Botimet M&B
ISBN: 987-9928-172-29-7
ISBN: Nr. faqeve: 152
Çmimi: 300 lekë



Petitioning The Albanian Government after 2013 general elections

Complete the construction of the Arbëri Road - Ndërtoni sa më shpejt dhe me standarde Rrugën e Arbërit

Sign this petition
with 4,440 supporters
560 NEEDED
First Name
Last Name
Email
City
Why is this important to you? (Optional)
Sign ›
Display my signature on Change.org
By signing, you accept Change.org's terms of service and privacy policy.

Firmos *dhe* **komento peticionit** *në* **change.org**

http://www.change.org/en-GB/petitions/complete-the-construction-of-the-arb%C3%ABri-road-nd%C3%ABrtoni-sa-m%C3%AB-shpejt-dhe-me-standarde-rrug%C3%ABn-e-arb%C3%ABrit?utm_campaign=petition_created&utm_medium=email&utm_source=guides



Të gjitha informatat me rëndësi, si shkrime, intervista, lajme, video dhe audio, lidhur me mbrojtjen e lumit Radika mund t'i gjeni në:

http://saveriverradika.com

Monografia "100 vjet në 36 shkronja" jo vetëm që ka vlera njohëse dhe edukuese, por përbën dhe një dokument të rëndësishëm të arsimit shqip në qytetin e Peshkopisë.

"Certifikatë Mirënjohjeje" për xhaminë e qytetit të Peshkopisë

Më 13 qershor të këtij viti u përkujtua 100 – vjetori i hapjes së shkollës së parë shqipe në qytetin e Peshkopisë. Ajo filloi më 14 prill 1914. Mësuesi i parë i kësaj shkolle ishte Haki Sharofi, që lindi në vitin 1894 në qytetin e Dibrës së Madhe. Ai u mbështet fort në ndihmën e myftiut Raif Kadiu, i cili lindi në vitin 1833 në qytetin e Dibrës së Madhe. Të dy u arsimuan në mejtepin, rruzhdien dhe medresenë e Dibrës së Madhe. Hakiu mbaroi normalen e Elbasanit dhe një kurs pedagogjik 1 vjeçar po aty. Ndërsa Raif Kadiu u diplomua për teologji në Universitetin e Stambollit.

Shkolla e parë shqipe e filloi jetën e saj në sallën e vetme të xhamisë së vjetër të Peshkopisë, e cila ngrihet buzë përroit, tek ura që lidhte dy lagjet e qytetit. Edhe më parë në këtë xhami mësohej.

Në mejtepin e Peshkopisë, në këtë xhami mësohej lexim Kur'ani në gjuhen arabe, pra jo në Turqisht. Mësimet e tjera të fesë, njohuri matematike, gjeografike dhe tregime historike jepeshin me fjalorin e gjuhës shqipe. Nuk kishte tekste mësimore. Edhe pasi Esat Toptani, pas 6 muajsh jetë të shkollës së pare shqipe, grisi flamurin shqiptar në sheshin e qytetit dhe mbylli të vetmen shkollë shqipe, mejtepi vazhdoi në tërë përmbajtjen e tij, pra në gjuhën shqipe.

Këshilli Bashkiak e vlerësoi kërkesën e kryetarit të bashkisë, z. Ilir Krosi dhe të shoqatës së historianëve të Dibrës me kryetar z. Mois Murra dhe i dha xhamisë së Peshkopisë **"Certifikatë Mirënjohjeje"**.

Ky vlerësim i jepet xhamisë dhe fesë Islame sepse e ushqyen këtë popull me dashuri e ndjenja të thella patriotike, gjuhën shqipe dhe me ndjenjën e bashkëjetesës së shqiptarëve me njëri-tjetrin, pa dallim besimi dhe në masën e duhur me popujt tjerë.

Ky çmim u dha me rastin e ceremonisë së festimeve të 100 vjetorit të shkollës së parë shqipe në peshkopi, ku u promovua edhe libri i mësuese Emrie Skuka "100 vjet në 36 shkronja".

Një portret për dy mësuesit e parë, Haki Sharofi dhe Raif Kadiu do ta botojmë në numrin e ardhshëm të gazetës "Rruga e Arbërit", shkruar nga Myftiu i Dibrës, Ahmet Çaushi.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA PESHKOPI
KRYETARI

Adresa:Bulevardi "Elez Isufi",Peshkopi,Albania,nr.tel.00355 218 221 66
E-mail: bashkiapeshkopi@gmail.com
Web: www.peshkopia.com

Çertifikatë

"MIRNJOHJEJE"

(Në kuadër te 100-vjetorit te shkollës sëparë shipe në Peshkopi/Dibër)

I jepet "XHAMISE PESHKOPI", me këtë motivacion :

"Për kontribut në konsolidimin e Arsimit ne Dibër".

Peshkopi, me 14 Prill, 2014.

KRYETARI I BASHKISE
Ilir KROSI

Njëqind vite shkollë në një libër

Në mars të vitit 1914 mësuesi atdhetar Haki Sharofi, sipas një kërkese të bërë Qeverisë së Durrësit, dhe i mbështetur nga prefektit i Durrësit në atë kohë, Mehdi Frashëri, mori emërimin për mësues dhe bashkë me Ramis Qatën, më 14 prill 1914 hapën shkollat e para shqipe në qytetin Peshkopisë e Trebisht. Kjo qe një ngjarje e shënuar për gjithë Dibrën e më gjerë.

Në kujtimet e tij Sharofi ka shkruar: *"Nxënësit kishin prur nga shtëpitë e veta nga një copë lëkurë për tu ulur dhe nga një arkë për të vumë fletoret dhe pllakat e shkrimit. Në vend të tabelës gjetëm një copë llamarinë të zezë sobe"*. Shkolla nuk pati jetë të gjatë. Borgjezia e fuqishme evropiane, më 4 gusht 1914, përgatiti, nxiti dhe shpërtheu Luftën e Parë Botërore, luftë e cila pati pasoja të rënda për gjithë popujt e Evropës, pati dhe për Shqipërinë. Por shkolla shqipe e qytetit të Peshkopisë dhe ajo Trebishtit funksionuan normalisht.

Pushtuesit jo vetëm nuk arritën t'i mbyllnin këto shkolla, por përkundrazi, gjatë vitit 1914 u hapën shkolla shqipe në Trojak, Cetush, Sohodoll e Maqellarë. Por atë që nuk e bëri pushtuesi, e bëri Esat Pashë Toptani, i cili në mesin e tetorit 1914 u fut në Dibër, uli flamurin kombëtar shqiptar dhe ngriti atë turk dhe po atë ditë mbylli shkollën e parë shqipe të qytetit të Peshkopisë.

Shkolla shqipe e hapur nga Haki Sharofi vërtet u mbyll, por shkëndijat ishin hedhur dhe flaka e arsimimit të dibranëve në gjuhën e tyre shqipe, kishte përfshirë gjithë trevën.

Dita e 14 prillit 1914 u gdhend në mendjen dhe shpirtin e dibranëve si ngjarja më e madhe dhe më e rëndësishme e kohës. Që nga ajo ditë ka kaluar një shekull. Një shekull i begatshëm.

Një shekull që ka parë nxënës, mësues, prindër të ulur në bangat e kësaj shkolle, e që na janë dhënë me dashuri, sinqerite e përgjegjësi qytetare në librin "100 vjet në 36 shkronja" të autores Emrie Skuka. Titull i gjetur. Titull shumë kuptimplotë në jubilen e njëqind të shkollës së parë shqipe.

Libri është i ndarë në dhjetë dhjetëvjeçar dhe i pajisur me aparatin



e duhur shkencor. Autorja ka shkruar thjesht e bukur, duke i dhënë librit koloritin e nevojshëm sa letrar, po aq dhe shkencor. Një punim i këtij zhanri, në këtë njëqind vjetor, vjen si një buqetë me lule jo vetëm për nxënëset, nxënësit, mësueset e mësuesit e shkollave, por dhe për të gjithë banorët e qytetit të Peshkopisë.

Në libër janë trajtuar dhe problematika që janë ndeshur në çdo dhjetëvjeçarë nga mësuesit, banorët e qytetit, pushtetarët vendorë e politika arsimore të qeverive të ndryshme.

Autorja, duke grumbulluar të dhëna gojore dhe e mbështetur në dokumente, na ka dhën gjithë fizionominë arsimore të një shekulli.

Me shumë dashuri, ndjenjë e respekt janë përshkruar mësuesit veteranë Haki Sharofi, Myslim Shehu, Mehmet Çadri, Mustafa Shahinaj, Islam Vani, Hava Shehu, Munir Shehu, Adem Shehu, Drita Zhulali etj., etj. Me dhjetëra nxënës e mësues kanë mbushur dhjetëvjeçarët.

Kalojnë dhjetëvjeçarët njëri pas tjetrit, gjeneratë pas gjenerate e të duket sikur gjithë shekulli flet vetëm për arsimimin e vocërrakëve të qytetit të Peshkopisë, në monografinë "100 vjet në 36 shkronja". Dhe kjo nuk është pak. Nga 14 prilli 1914 dhe deri në ditët e sotme shkolla shqipe e Peshkopisë njohu rritje, zhvillime të

Emrie Skuka
100 VJET NË 36 SHKRONJA

Botimet M&B
ISBN: 987-9928-172-27-3
Nr. faqeve: 336
Çmimi: 800 lekë

Haki Sharofi: "Nxënësit kishin prur nga shtëpitë e veta nga një copë lëkurë për t'u ulur dhe nga një arkë për të vumë fletoret dhe pllakat e shkrimit. Në vend të tabelës gjetëm një copë llamarinë të zezë sobe".

reja, pothuajse në çdo dhjetëvjeçar. Në Peshkopi hapet internati "Dibra", shkolla e parë femërore, shkolla unike, 7 vjeçare dhe së fundi 9 vjeçare.

Në monografi i është kushtuar një vëmendje e veçant luftës kundër analfabetizimit në vitet e para të pas çlirimit. Mësuesit veteranë bënë shumë që jo vetëm vocërrakët e qytetit të mos mbeteshin në errësirë, por dhe të rriturit.

Libri, duke qenë se është shkruar me dorë të lirë, është i kapshëm për të gjitha moshat dhe nivelet arsimore. Prandaj dhe për këtë ai duhet të shkojë në çdo vatër dibrane.

Monografia "100 vjet në 36 shkronja" jo vetëm që ka vlera njohëse dhe edukuese, por përbën dhe një dokument të rëndësishëm të arsimit shqip në qytetin e Peshkopisë. Së fundi, duhet thënë se autorja ka shkruar mirë, gjë që na jep të shpresojmë se dhe në të ardhmen do të presim punime të tjera.

Moisi Murra

Çidhnakë në shekuj


Libri "Çidhnakë në shekuj" i Dr.Zyber Gjonit është një punim serioz, i vonuar, por i domosdoshëm, për të njohur lisat e mëdhenj të Çidhnës martire, që në kohë, vende e situata të ndryshme bënë histori, duke i dhënë kësaj krahine një vend në kryevend.

Autori, me dashuri, por me kokë të ftohtë, duke u mbështetur në të dhëna arkivale e literaturë historiografike, i trajton lisat e Çidhnës të pavarur, por dhe në bashkëveprim me figurat atdhetare të tjera të Dibrës, të krahinave të tjera të vendit si: Shkodrës, Lumës, Matit. Dr.Gjoni u mëshon fort bëmave të krahinës së Çidhnës, për të hedhur dritë në të vërtetat historike, në rolin që ka luajtur kjo krahinë dhe bijtë e saj në shekuj nga Antikiteti në ditët tona.

Me shumë interes është përpjekja e autorit për të lokalizuar Oenenë antike në Çidhnën e sotme.

Autori mbështetet jo vetëm në toponimet, por dhe në literaturën e autorëve antikë, gjetjet arkeologjike dhe të dhënat gojore, duke i ballafaquar e lidhur ato, arrin në përfundim se Oenea e dikurshme antike nuk është tjetër veçse Çidhna e sotme. Ashtu si shumë autorë të tjerë dhe z.Gjoni nuk i ka shpëtuar tundimit të Kastriotëve çidhnakë. Ndoshta është i pari, që, i mbështetur në një aparat shkencor të pasur, hedh dritë të plotë mbi Gjergj Kastriotin I. Është apo s'është katragjyshi i Skënderbeut apo vëllai i Gjon Kastriotit, Gjergj Kastrioti I trajtohet si çidhnak, jo për dëshirën e autorit, por për dokumentet që na afrohen.

Autori në këtë libër ka hedhur dritë në 20 figura atdhetare të Çidhnës. Këto figura, të shtrira në kohë, trajtohen në rrafsh me ngjarjet që janë zhvilluar në këtë krahinë e, nëpërmjet tyre, domosdo që është bërë historia e Çidhnës. Shumë nga këto figura që endeshin në kujtesën e pleqve e që u janë transmetuar brezave gojë më gojë, autori i ka nxjerë nga oda dibrane, për një "auditor" më të gjerë e gjithëpërfshirës. Kështu p.sh.: figura si Demir Lusha, Salë Demiri, Sali Noka, Murat Kaloshi, për të cilët ka pasur kufizime, autori i ka dhënë të plota, me realizëm, gjakftohtësi e pa komplekse. Me shumë dashamirësi, objektivitet e çiltërsi autori trajton dy klerikë myslimanë: Hoxhë Gjonin dhe Hoxhë Kutën, të cilët, veç shërbesave



Zyber Gjoni
ÇIDHNAKË NË SHEKUJ

Botimet M&B
ISBN: 987-9928-172-28-0
Nr. faqeve: 200
Çmimi: 1000 lekë

Dr. Zyber Gjoni u mëshon fort bëmave të krahinës së Çidhnës, për të hedhur dritë në të vërtetat historike...

fetare, kryenin dhe veprimtari të tjera në të mirë të Çidhnës dhe çidhnakëve. Çdo figurë e këtij vëllimi meriton një monografi, por dhe me kaq, nuk është bërë pak. Udha është shtruar dhe është shtruar mirë.

Natyrisht, figurat atdhetare të Çidhnës nuk janë vetëm këto që trajtohen në këtë vëllim. Autori ka në proces vëllimin e dytë, që së shpejti do të pasojë të parin. Libri "Çidhnakë në shekuj" i autorit Zyber Gjoni ka vlera njohëse dhe edukuese, prandaj dhe për këtë, duhej të shihte udhën e botimit.

Duke uruar autorin për vëllimin e parë, le të shpresojmë se shumë shpejt do të kemi në dorë dhe vëllimin e dytë. Ashtu u bëftë!

Moisi Murra

mirënjohje

Prezantohet në hotel "Sheraton" në Tiranë libri "Shqiptarët dhe hebrenjtë", monografi nga prof. dr. Shaban Sinani. Botimet "Naimi" e sjellin në versionin shqip dhe anglisht

Ambasada e Izraelit në Tiranë nderon Prof.dr. Shaban Sinanin

"Ambasada e Izraelit në Shqipëri ka nderin t'i japë këtë mirënjohje Prof. Shaban Sinanit, në shenjë vlerësimi për studimin e vazhdueshëm, përgjatë dy dekadave, të burimeve mbi marrëdhëniet ndërmjet shqiptarëve dhe hebrenjve, studim që arriti majat me botimin e veprës së tij monumentale mbi mbrojtjen dhe shpëtimin e hebrenjve gjatë Holokaustit.





Në foto: Autori i librit prof. dr. Shaban Sinani me ambasadorin e Izraelit në Tiranë, David Cohen (foto majtas) dhe me z. Alan Solow, kryetar i Fushatës Presidenciale Obama-Biden 2012, mik i ngushtë i Presidentit Barack Obama (foto djathtas).

Kronika

E vërteta pa mite për lidhjet shqiptaro-hebraike

Nga **NAIM ZOTO**

Libri i prof. dr. Shaban Sinanit "Shqiptarët dhe hebrenjtë: mbrojtja dhe shpëtimi" (Albanians and Jews: the protection and salvation), u promovua më 17 qershor në një mbrëmje të veçantë, organizuar nga Ambasada e Izraelit në Tiranë në bashkëpunim me Orkestrën Sinfonike të Radio Televizionit Shqiptar me mbështetjen financiare të deputetit Tom Doshi. Në këtë promovim ishin të pranishëm Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, z. Ilir Meta, ambasadori i Izraelit në Tiranë, David Cohen, njerëz të njohur të artit dhe politikës ndërkombëtare dhe shqiptare. Deputeti Tom Doshi, në fjalën e tij theksoi se "e konsiderova me rëndësi ta bëja të njohur për gjithë botën kontributin e shqiptarëve në mbrojtje të hebrenjve të rrezikuar nga nazistët dhe ishte kjo arsyeja pse financova botimin e librit në gjuhën angleze".

Pastaj e mori fjalën z. Alan Solow, ish-kryetar i fushatës presidenciale Obama-Biden 2012, mik i ngushtë i Presidentit Barack Obama, ardhur nga SHBA posaçërisht për promovim e librit.

Ambasadori i Izraelit në Tiranë, David Cohen, nderoi autorin Shaban Sinani me një çmim special. Ja, motivacioni i këtij nderimi:

"Ambasada e Izraelit në Shqipëri ka nderin t'i japë këtë mirënjohje Prof. Shaban Sinanit, në shenjë vlerësimi për studimin e vazhdueshëm, përgjatë dy dekadave, të burimeve mbi marrëdhëniet ndërmjet shqiptarëve dhe hebrenjve, studim që arriti majat me botimin e veprës së tij monumentale mbi mbrojtjen dhe shpëtimin e hebrenjve gjatë Holokaustit.

Ambasadori i Izraelit, David Cohen - 17 qershor 2014 - Tiranë, Shqipëri"

Duke e marrë fjalën në këtë promovim, prof. dr. Shaban Sinani, pasi falënderoi organizatorët e këtij promovimi, shtëpinë botuese "Naimi" dhe përkthyesin Arben P. Latifi, dhe të gjithë të pranishmit, tha se "merita e librit është meritë e të gjithë shqiptarëve, që në një kohë mjaft të rrezikshme përkrahën dhe i mikpritën hebrenjtë në shtëpitë e tyre".

Pas disa veprash themelore për kulturën dhe për trashëgiminë shqiptare, si: *Mitologji në eposin e kreshnikëve* dhe *Kodikët e Shqipërisë në 'Kujtesën e Botës'*; pas studimeve mbi veprën e shkrimtarit I. Kadare si dukuri letrare shqiptare me vlerë universale [*Pengu i moskuptimit*, *Për prozën e Kadaresë*, *Letërsia në totalitarizëm dhe "Dossier K."*], që u shoqëruan me botimin e ribotimin në gjuhën frënge të librit *Le dossier Kadaré: la vérité des souterrains* [*Editions Odile Jacob*: 2006, 2013], prof. dr. Shaban Sinani publikoi para disa ditësh librin e ri monografik *Shqiptarët dhe hebrenjtë: mbrojtja dhe shpëtimi*.


Krahasuar me librin e parë botuar në vitin 2009 me titullin *Hebrenjtë në Shqipëri: prania dhe shpëtimi*, në librin e ri *Shqiptarët dhe hebrenjtë*, argumenti zgjerohet, duke iu referuar jo thjesht mbrojtjes së hebrenjve në Shqipërinë shtetërore, por përgjithësisht raporteve të tyre me shqiptarët kudo, një prej pikëpyetjeve më të ndërlikuara që janë trashëguar në kërkime të të huajve dhe vendësve në këtë fushë. Kjo ka bërë të nevojshme të ndryshohet struktura e librit të mëparshëm, të shtohen kapituj të rinj, të zgjerohet problematika e atyre kapitujve që janë ruajtur, të verifikohen dhe certifikohen të dhënat dhe pohimet e dyshimta dhe të konfirmohen të vërtetat thelbësore. Libri *Shqiptarët dhe hebrenjtë: mbrojtja dhe shpëtimi* në një anë e lartëson dhe më qendrimin shqiptar ndaj çështjes së hebrenjve, siç është e vërteta; në anën tjetër e çliron atë nga mitet dhe interpretimet folkloristike që po vërshojnë me shumicë prej vitesh dhe që shpërfillin historinë duke e zëvendësuar me legjendën.

Studiuesit Shaban Sinani i është dashur një punë e stërmundimshme mëse 20-vjeçare për t'i zbuluar, interpretuar, verifikuar dhe analizuar enigma të tilla si ekzistenca e një plani ndërkombëtar në vitet 1930 për ta bërë Shqipërinë *një atdhe rezervë për hebrenjtë*, pra, në prag të shpërthimit të murtajës antisemite naziste në Europë. Dhe kjo është një prej anëve më të panjohura deri më sot në kërkimet për holokaustin [Shoah].

Vepra *Shqiptarët dhe hebrenjtë*, sikurse dhe *Kodikët e Shqipërisë në "Kujtesën e Botës"*, është një monografi shkencore për vlerat e shenjuara në rang botëror të kombit shqiptar: pranimin dhe shpëtimin e hebrenjve para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në të dy rastet, pas punës së këtij dijetari të albanologjisë, shqiptarët ndjehen të rivlerësuar; sepse kultura dhe vlerat e tyre tashmë janë certifikuar botërisht, në njërin rast nga UNESCO dhe, në rastin e hebrenjve, nga *Yad Vashem* [Izrael], *Memorial Museum of Holocaust* [SHBA] dhe Kongresi Amerikan.

Ndryshe nga shpjegimet e dhëna deri vonë, të motivuara kryesisht nga pozicione romantike, që mbështeten vetëm në atë që është quajtur *virtyti shqiptar* [*besa, nderi, ndorja, kulti i mikut* etj.]; që janë shoqëruar dhe me shtrembërime prej frikës për të thënë të vërtetën për qendrimin unik të shqiptarëve si mikpritës dhe mbrojtës të hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore, autori ka arritur të realizojë një vepër pothuaj shteruese për këtë argument. Në këtë studim çështja kthehet nga rrëfenjë në faktologji, dhe kjo është merita kryesore për të cilën mund të çmohet.

Në librin *Shqiptarët dhe hebrenjtë* autori ka përfshirë dhjetëra ilustrime të argumenteve me dokumente origjinale, foto e dëshmi, si dhe qindra referenca të autorëve vendës dhe të huaj që janë marrë me këtë temë. Shumica e dokumenteve dhe dëshmive zbulohen për publikun për herë të parë, ashtu siç shqiptohen për herë të parë fakte, qëndrime dhe këndvështrime krejt të reja për praninë dhe shpëtimin e hebrenjve në trojet shqiptare. Për herë të parë burimet nuk janë të njëanshme: vetëm shqiptare apo vetëm të huaja. Autori ka siguruar bashkëpunimin e institucioneve dhe kolegëve kudo që ruhen burime për argumentin e tij dhe në këtë studim këto burime verifikohen e certifikohen përmes njëri-tjetrit. Burimet që janë shtuar janë nga arkivat e ish-Jugosllavisë, nga arkivat italiane e gjermane, nga arkivat amerikane, nga arkivat e institucioneve të specializuara si banka të kujtesës së dokumentuar.



Skeda e librit versioni shqip:
Botimet NAIMI
ISBN: 978-9928-109-66-8
Nr. i faqeve: 400
Çmimi: 1500 lekë/ 10 euro
Skeda e librit për botimin në gjuhën angleze:
ISBN: 978-9928-109-66-8
Çmimi: 20 euro

Argumenti trajtohet me thellësi historike, duke nisur nga përtakimet e para të shqiptarëve me hebrenjtë, duke zbuluar një shtresë hebraike në kulturën shqiptare [kapitulli i parë: *Prania kulturore hebraike në traditën shqiptare*]; për të vazhduar me qendrimin ndaj hebrenjve gjatë periudhës mbretërore, me qendrimet e ushtrive pushtuese dhe të qeverive kuislinge, deri tek qendrimi i komunistëve ndaj hebrenjve. Theksimi prapavajtës i pranisë kulturore hebraike në hapësirën iliro-shqiptare është dhe në shërbim të shtimit të provave të vazhdimësisë në këto troje përmes dëshmive dhe gjurmëve të shenjuara në kulturat e lashtësisë, si kultura helene, romaniteti dhe hebraizmi.

Autori zbulon fakte, ofron këndvështrime të reja të pashqiptuara apo të keqshqiptuara më parë, si, për shembull, për rolin e ambasadorit të parë amerikan Herman Bernstein [me kombësi hebreje] në Shqipëri në gjysmën e parë të viteve 1930; për një përpjekje ndërkombëtare si nismë e Lidhjes së Kombeve [OKB e sotme] për ta parë Shqipërinë si *një atdhe të mundshëm të hebrenjve* të rrezikuar në Europë. Dokumente për personazhe të njohur të politikës, diplomacisë dhe kulturës hebraike zbulohen në këtë libër, duke nisur nga udhëheqësi i lëvizjes mesianike Sabbatha Zevi, deri tek ambasadori amerikan H. Bernstein e fizikani nobelist A. Einstein; figura të mbretërisë, si A. Zogu, Mehmet e Faik Konica; klerikë të njohur të asaj kohe si Dom Shtjefën Kurti; protagonistë të luftës si Bedri Pejani, Ramiz Alia; oficerë të lartë të Rajhut; figura qendrore të albanologjisë si ajo e Norbert Joklit, deri tek letrat e poetëve të njohur shqiptarë Fan Noli, Gjergj Fishta e Lasgush Poradeci në mbrojtje të hebrenjve.

Autori ka një meritë të veçantë sidomos për zbardhjen e plotë të fatit të hebrenjve të Kosovës. Për ta, deri vonë, ishte formuluar akuza se ishin dorëzuar tek nazistët nga shqiptarët e mobilizuar nga Gestapo. Duke dashur ta izolojnë meritën e mbrojtjes së hebrenjve vetëm tek shqiptarët e Shqipërisë shtetërore, edhe sot botohen studime për *një qendrim ndryshe* të shqiptarëve në Kosovë dhe për *një fat ndryshe* të hebrenjve atje. Sipas studiuesit Shaban Sinani, një rol vendimtar në sjelljen historike të shqiptarëve ndaj hebrenjve ka luajtur etnotipi i tyre, i shpjeguar ky jo vetëm me tolerancën e mirënjohur ndërfetare të shqiptarëve, por dhe me sjelljen e tyre mbrojtëse ndaj të huajve, sidomos në kohë rreziku. Dhe kjo shpjegon dhe qendrimin e njësojtë të tyre ndaj hebrenjve.

Në këtë libër të ri, ashtu si edhe në veprat e mëparshme të këtij autori, do të vëresh studiuesin e kompletuar në disiplina të tilla, si: antropologjia kulturore, etnologjia, gjuhësia, folkloristika, të cilat i japin dorë dhe ndihmojnë njëra-tjetrën për të ndriçuar tërësisht argumentin. Këto cilësi, të bashkuara me stilin elegant dhe pasionin e studiuesit për t'i shkuar së vërtetës deri në fund, e bëjnë veprën më të këndshme dhe më interesante për lexuesin. Kjo është një monografi e jashtëzakonshme dhe me vlera të shumëfishta për kulturën dhe imazhin e Shqipërisë.

Dhe, në vend të një urimi për lexuesit, dëshiroj të sjell para fillimit të leximit të librit atë që ka deklaruar publikisht John L. Withers II, Ambasador i SHBA në Shqipëri, më 27 janar 2010:

Roli i Shqipërisë për të shpëtuar hebrenjtë nga tmerret e holokaustit nuk është i njohur aq sa meriton. Është diçka me të cilën të gjithë shqiptarët mund të krenohen. Shqipëria mund të bëjë gjithmonë më shumë për t'i treguar botës historinë e vet të shkëlqyer për të parandaluar persekutimin e hebrenjve në tokën e saj. Disa shqiptarë janë duke bërë pikërisht këtë. Për shembull, profesor Shaban Sinani. Punimet e tij të shumta dokumentojnë që, edhe në vitet më të errëta të holokaustit, në Shqipëri ndodhi një bashkim i të gjitha kaheve politike dhe besimeve fetare - antifashistë dhe profashistë, komunistë dhe nacionalistë, myslimanë dhe të krishterë, besimtarë dhe jobesimtarë - për t'u siguruar që asnjë hebreu të strehuar në Shqipëri nuk do t'i hynte gjemb në këmbë.

Monografia e re e prof. dr. Shaban Sinanit "Shqiptarët dhe hebrenjtë: mbrojtja dhe shpëtimi" *(Albanians and Jews: the protection and salvation)*, falë mbështetjes financiare të biznesmenit dhe deputetit Tom Doshi, botohet njëkohësisht në gjuhën shqipe dhe angleze, duke futur në qarkullim ndërkombëtar një nga vlerat e pakta për të cilën shqiptarët nderohen sot në botë.

Rruga e Arbërit nr. 98

kujtime

Në fund të muajit maj tek Gjiri i Lalëzit u bë promovimi i librit "Llesh Doçi i Lurës - forca e mendjes, pesha e fjalës".

Një kujtim me Llesh Zef Doçin

Nga **XHAFER MARTINI**

Në fund të muajit maj tek Gjiri i Lalëzit u bë promovimi i librit "Llesh Doçi i Lurës - forca e mendjes, pesha e fjalës". Familja e të ndjerit më nderoi duke më ftuar. Njoftimi qe me telefon dhe unë thashë se e kisha njohur mirë Llesh Zef Doçin dhe se ruaja një kujtim të çmuar prej tij. Kjo mënyrë komunikimi mua m'u duk e mjaftueshme që organizatorët e veprimtarisë t'i linin pak kohë edhe një shkrimtari nga Dibra për dy arsye: së, pari në libër kujtimet për të ndjerin vinë kryesisht nga partiakë dhe pushtetarë të kohës, vështruar nga ai kënd që i shikonin ata punët e mira ose të këqia; së dyti, si autori i librit, ashtu edhe ata që u aktivizuan në atë veprimtari nuk ishin dibranë, kur dihet që Llesh Zef Doçi ka punuar shumë kohë në Dibër dhe ka mbajtur poste të rëndësishme. Por unë nuk isha midis atyre që ishin caktuar për të mbajtur fjalën. Por më mirë që nuk m'u krijua kjo mundësi se do të stonoja me patetizmin dhe glorifikimin që zotëronte. Ngjarja që do të tregoja unë ishte një kujtim i një natyre krejt tjetër. Mbetej, pra, ta merrja fjalën në drekën që u organizua nga familja. Por aty mungonte edhe më shumë intimiteti i nevojshëm. Secili e merrte fjalën me iniciativën e vet dhe, kuptohet, mes zhurmës së ngrënies dhe të pirjes. Mua iniciativa më mungonte dhe zhurma më pengonte, kështu që nuk e mora fjalën. Por nuk dua ta mbaj këtë kujtim përgjithmonë dhe, duke menduar se është i asaj natyre që flet shumë për personalitetin e Llesh Zefi Doçit dhe se në librin për të imtësi të kësaj natyre mungojnë, po e tregoj:

Ishte vitit 1963, kur mua më transferuan nga Fushë Alia ku isha mësues gjuhe dhe më dërguan në Ceren, në lokalitetin e Sllovës. Transferimi ishte krejt i padrejtë dhe për dy muaj nuk shkova në punë.

Më në fund, me shumë vonesë, u paraqita në detyrë, por me mendje që të hiqja dorë përfundimisht prej saj. Për këtë vendim ndikuan edhe kushtet jashtëzakonisht të këqija aty ku flija dhe jetoja. Larg shtëpisë vuanin një pjesë e madhe e arsimtarëve të asaj kohe dhe kjo ka qenë goditja më e rëndë që i jepej arsimit. Me të filluar proceset demokratike, çdo mësues shkoi për të kryer detyrën pranë shtëpisë së vet. Kjo tregonte se mësuesit konsideroheshin si gurë shahu vetëm që t'i pushtonte ndjenja e pasigurisë dhe ta ndjenin veten që ishin shërbëtorë. Unë shkoja një herë në javë në shtëpi për t'u larë e për t'u ndërruar kështu që e thyeja orarin dhe për këtë më doli emri si i padisiplinuar. Drejtori i shkollës nuk la vend pa më raportuar.

Llesh Zef Doçi aso kohe ishte kryetar lokaliteti në Sllovë. Edhe atij i ishte bërë disa herë e njohur thyerja e disiplinës nga ana ime. Më në fund, aty nga muaj nëntor, më vjen një shkresë prej tij që të paraqitesha në zyrë me mundësinë e parë që të më jepej. Nuk më kishte caktuar datë dhe orë duke menduar që isha larg. Këtë unë e konsiderova shenjë delikatese dhe vetëm për këtë arsye vendosa ta takoja. Kisha dëgjuar për të që ishte njeri i ndershëm dhe serioz, por edhe i prerë dhe që nuk bënte lëshime. E kisha parë edhe nga larg: një burrë i gjatë me një pardesy të bardhë, trupdrejt dhe me atë hapin karakteristik të malësorit të vendosur.

Një ditë, ndërsa po udhëtoja nga Fushë Alia për të shkuar në shkollë, më ra ndërmend se ishte koha më e përshtatshme për t'u takuar me Llesh Zef Doçin, megjithëse, siç e thashë, unë kisha vendosur që ta lija arsimin.Trokita në derë dhe e hapa atë pa më thënë kush "Hyr!" Zef Lleshi po rrinte në tyezën e tij. Një zyrë ishin dhe nja dy të tjerë.

- Prit një minutë, se kam punë, - më tha ai mua, por, kur më shikoi si më me vëmendje, sikur iu kujtua diçka dhe ndryshoi mendim. Më pyeti me një ndjenjë kurioziteti:- Mos je mësuesi që vjen nga Fushë Alia?



- Po, - i thashë unë.

- Të më falni se me ju takohem parapë, - u tha ai atyre që kishte në zyrë. – Eja dhe ulu, - më ftoi mua.

U ula në një karrike përballë kryetarit. Ai, sikur donte të më jepte rast ta shikoja nga këmbët tek koka, doli nga skrivania ku kishte zënë vend dhe qëndroi në këmbë në hapësirën boshe në mes të zyrës, përballë meje. Më bëri përshtypje ai njeri: ishte i gjatë, siç dukej edhe nga larg, syzi e vetullzi, me një vështrim ngulmues e disi zhbirues. Buzët e holla flisnin për një zemërim të përmbajtur, tufa e vockëls e mustaqeve nën hundë sikur fliste për një burrëri që aso kohe nuk ishte lehtë ta tregoje deri në fund, fytyra e gjatë dhe mjekrra pak si me majë dëshmonin për një vendosmëri të rrallë, qafa e gjatë fliste për faktin që ai njeri mendohej shumë për fjalët që nxirrte nga goja, kurse ato nofullat pak të shtrënguara, e tregonin burrë qëndrestar dhe të vendosur, sytë e tij kishin vështrimin e shqiponjës kur ajo ngrihet në hapësirë dhe kundron horizontet.

Në zyrë bënte pak ftohtë dhe ai nuk e kishte hequr pardesynë e bardhë që ishte karakteristike për të. Pardesyja ishte akull e pastër dhe e hekurosur. Veshja e pastër është shenjë fisnikërie. Ishte burrë pa asnjë gram peshë të tepër dhe dinamik, ruante një energji të pashuar brenda vetes, por që e shfaqte me kursim e në vendin ku duhej. Ai më shikmonte mua dhe unë e shikoja atë. Na dukej vetja si në arenë. Para se të fillonte ndeshja, ne sikur matnim forcat dhe provonim armët. Llesh Zefi buzëqeshi paksa për ta ngrohur atmosferën dhe për ta çtensionuar situatën. Buzëqeshja e tij ishte çarmatosëse. Unë kisha nevojë për një qëndrim të tillë se me pushtetarët, ç'është vërteta, nuk i peshoja shumë fjalët. Më pyeti si isha dhe qysh i kisha njerëzit në familje. Pastaj i qetë, ngadalë, zuri vend pas skrivanisë dhe për një çast sikur nuk dinte ç'të bënte. Ngriti kokën, më shikon drejt në sy, pak si gjatë, dhe më tha:

- Ti je Xhafer Martini?

- Unë, - i thashë.

- Je bërë problem për displinën, - më tha.

- Jam bërë, - i thashë.

- Domethënë pranon që je i padisiplinuar, - më tha dhe buzëqeshi paksa.

- E pranoj, - thashë unë. – Por dëgjoni si është puna, - nisa të japë sqarime unë sikur doja ta ndihmoja kryetarin për qëndrimin që duhej të mbante dhe fjalët që duhej të thoshte: - Unë erdha për t'ju respektuar, por duhet të dini se kam marrë vendim ta lë arsimin, kështu që çdo qortim nga ana juaj, aq më tepër po ta bëni me zë të lartë dhe pa takt, nuk do të kishte kuptim.

... më lëkundi ky njeri me zemër të madhe, që për mua ishte individualtet, personalitet, me një kulturë që buron prej traditave, një shtetar i një tipi tjetër, jo nga ata arrogantët dhe injoranët e zakonshëm me të cilët kishin të bënim aq shumë...

- Kështu qenka puna?- më pyeti dhe nuk m'i ndau sytë.

- Kështu, - thashë unë dhe ashtu ishte.

- Unë të çova fjalë të vish dhe të bisedojmë, më shumë për t'u njohur, por tani e shikoj se kjo gjë paska qenë e domosdoshme, shumë e dosmosdoshme.

- Përse mendoni kështu?

- Ti dashke ta lësh arsimin, apo nuk dëgjova mirë?

- Ashtu është.

- Ti je poet, - më tha, - dhe unë gëzohem që bisedoj me një poet. Ju nuk jeni një farë aq e shtueshme sa t'ju marrim nëpër këmbë dhe t'u detyrojmë të lini detyrën. Unë nuk marr vesh shumë nga poezia, por vjershat e tua më kanë pëlqyer, edhe të tjerët me të cilët kam biseduar, më kanë thënë se je djalë i talentuar...

Kisha botuar mjaft poezi në shtypin e kohës, por nuk ma merrte kurrë mendja që ato të kishin shkuar deri në dorë të Llesh Zefi Doçit në Sllovë. Flet kështu vetëm për të më bërë qejfin, vetëm se ka dëgjuar që shkruaj poezi, mendova. Në atë kohë ata që shkruanin ishin vërtetë të rrallë, shumë të rrallë, dhe në zona rurale shikoheshin gati si jashtëtokësor. Nuk di si ta shpreh me saktësi qëndrimin e atëhershëm të njerëzve për poetët dhe shkrimtarët: nga një anë vlerësoheshin dhe nderoheshin, por, nga ana tjetër, konsideroheshin si të fantaksur, si jashtë kohe dhe ajo aq të përshtatshëm me moralin në përgjithësi.

Fakti që kishte shkrimtarë të ndaluar, prej atyre që nuk u qarkullonin librat, që ishin të ndaluar për t'u futur në programe mësimore e në shkolla, madje edhe për t'u lexuar në mënyrë individuale, e bënte disi misterioze e të rrezikshme figurën e shkrimtarit. Ishte mirë të mos u përmedej as emri. Kështu, për shembull, veprohej me Fishtën, Konicën, Koliqin e të tjerë. Shkurt, për shkrimtarin kishte një masë tjetër nga ajo e njerëzve të zakonshëm. Kjo i bënte ata edhe interesantë, por edhe të goditshëm më lehtë.

Në vendet ruarale si Peshkopia dhe ca më shumë Fushë Alia nuk kishin përvojë se si të silleshin me shkrimtarët. Krijuesit e letrave në këto vende faktorizoheshin shpejt dhe shumë herë për keq. Mua më kishte marrë puna për keq. Në Fushë Alie, bash në vendlindjen time, më kishin goditur pa turp dhe me ligësi. Në vend që të më donin dhe të më respektonin si poetin e vendit, më kanë krijuar kurthe e poshtërsi pa fund. Ata më dërguan edhe në Ceren.

Unë u suprizova vërtet dhe mbeta si të thuash pa mend kur Llesh Zefi zgjati dorën dhe mori nga një raft i vogël një revistë "Ylli", e hapi në faqen ku unë kisha botuar një cikël me poezi bashkë me fotografi.

- Ti je poet dhe poet i mirë, - më tha dhe më vështroi me butësi. - Unë të këshilloj të mos e lësh arsimin. E di që je në kushte shumë të vështira, por edhe këtë do ta zgjidhim.

Nuk thashë as jo as po. Vendimin e kisha marrë dhe nuk mund të ndërroja mendim aq shpejt.

- Nuk do të lësh arsimin, - tha si me të lutur. -Ti ke bërë gjithë atë shkollë, dhe siç kam dëgjuar, je mësues i mirë. Kuptohet kjo, se një poet është ndryshe nga mësuesit e tjerë. Bëj si të bësh këtë vit, se vitin tjetër nuk do të jesh në Ceren.

Unë u lëkunda, më lëkundi ky njeri me zemër të madhe, që për mua ishte individualtet, personalitet, me një kulturë që buron prej traditave, një shtetar i një tipi tjetër, jo nga ata arrogantët dhe injoranët e zakonshëm me të cilët kishin të bënim aq shumë...

Tani që çdo njeri boton të paktën një libër dhe që zeja e shkrimtarit duket sikur është për të gjithë, ka humbur kënaqësia e të qenurit krijues dhe përgjegjësia që buron prej këtij fakti. Takim i asaj dite me Llesh Zef Doçin, mënyra se si e kishte organizuar ai duke më suprizuar dhe duke më ngjallur ndjenjat më të mira, nuk mund të mos më ngjallte emocione.

- Nuk do ta lësh arsimin, - tha Lleshi prapë por kësaj here si me të lutur. - Ma jep fjalën se nuk do ta bësh një gjë të tillë...

- Ta japë , - thashë.

- A besë burrash, - tha ai dhe më zgjati atë dorën e tij të madhe.

- Besë burrash, - thashë dhe shtrënguam duart.

Po ta kisha lënë arsimin, nuk dija se ç'do të bëja në jetë dhe sigurisht nuk do të ndiqja as shkollën e lartë, nuk do të merrja kulturën e nevojshme që i duhet një krijuesi. Shkurt, po të mos kishte qenë takimi me Llesh Zefin, nuk do të isha ky që jam sot, nëse vërtet jam ndonjë krijues që kam krijuar vepra që do t'u shërbejnë njerëzve.

Shkuam në klub dhe pimë në kafe si dy miq, njeri më i ri dhe tjetri më i moshuar. Dy javë pasi kisha biseduar me kryetarin, m'u afrua një fshatar Cerenas, mjaft i pasur, dhe më tha: "Mua nuk më ngushton as edhe një fije po të rrish tek shtëpia ime. Ke aty një dhomë të vogë, një krevat dhe për të ngrënë dhe për të pirë nuk më shkakton shqetësime as sa një mizë dheu". E dija, thoshte të vërtetën, por unë kuptova se me të kishte biseduar Llesh Zef Doçi. Por tashmë kishte mbaruar gjysma e vitit dhe unë e falenderova fshatarin dhe i thashë se, po të isha vitin tjetër mbase, ky vit kaloi.

Kur u ndave me Llesh Zef Doçin më tha që të shkoja të takoja edhe shefin e arsimit që në atë kohë ishte Selim Alliu. Duhet thënë se në lidhje me mua shefi nuk u ngrit kurrë në lartësinë e Llesh Zefit. Nuk doja ta takoja se ai më kishte dërguar në Ceren, por meqë Lleshi këmbënguli. Më priti ndryshe nga herët e tjera dhe a e dini si më tha: "Bën ç'të bësh, mbaroje këtë vit... Vitin tjetër je prapë në Fushë Alie". Ishin raste të rralla këto, se po të t'i mbathnin opingat një vit, do t'i bëje tri-katër vite se s'bën. "Ti paske pasur mik Llesh Zefin", më tha Selimi.

- Llesh Zefin nuk e kam mik, ai më ka ndihmuar si poet. Ju, shoku shef, nuk duhet t'i lini mësuesit t'ua shkelë baza me këmbë, sidomos kur ata janë poetë si unë.

Selim Alliu nuk më foli, por e mbajti fjalën: vitin tjetër më solli prapë mësues në Fushë Alie.

Ky kujtim i thjeshtë, njerëzor, që ma kishte ndryshuar jetën, sikur nuk kishte kuptim të tregohej atë ditë.

është koha për t'u paguar...
KONTRIBUO PER GAZETEN
merr kopjen tende
email: rrugaearberit@gmail.com
vetëm 600 lekë në vit

bloger

Është e pakuptimtë që shteti të harxhojë miliarda para publike për përmendore të pakuptimta, ndërsa qytetarët çdo ditë përballen me vështirësi të shumta, për eliminimin e të cilave duhet investuar shumë më pak.

Ç'kemi asaj Dibre!

Nga **BUJAR KAROSHI**

"Rally Albania" shkoi këtë vit në Dibër. Nga Peshkopia në Lurë, nga Lura në Selishtë. Një shofer la rrugës dy brinjë dhe një tjetër dogji motorin dhe ky ishte lajm i ditës në media. Ndërsa ne lëmë motorët e makinave çdo ditë dhe brinjët gjithë këto vite, jo vetëm që nuk bëhemi dot lajm kryesor, por as lajm në cepin e fundit.

Disa aktivistë në Dibër ngritën një lapidar me pjesë makinash, si simbol të rrugëve të dëmtuara dhe vuajtjeve të udhëtarëve. Tani e kemi më kollaj të heqim lapidarin, se të shtrojmë rrugën!

Ministri i Mjedisit ishte këtë muaj në Lurë. "Do harxhojmë 1 milionë dollarë dhe do mbjellim 2 milionë pemë. Të presim rezultatin dhe të shohim: ndoshta milionin e dollarëve e harxhojmë, por 2 pemë a do t'i mbjellim?

Pak ditë më parë, forumet sociale përhapën lajmin, se Ataturkut të madh, me origjinë shqiptare, iu hap muzeu në Koxhaxhik. Pllakata në hyrje të muzeut ishte shkruar në maqedonisht, turqisht dhe anglisht. Për shqipen nuk kishte vend pllaka, por kjo nuk u është e rëndësishme për patriotët e mëdhenj të *facebookut*.

Në Bulqizë u organizua festë e madhe për fillimin e punimeve në thellësi. Ishin të pranishëm edhe ministrat Gjiknuri e Veliaj. Para fushatës na kishin premtuar se do t'i prishin koncesionet abuzive, ndërsa tani u presim shiritat e inaugurimit.

Fëmijët punojnë në stoqet e kromit dhe këtë na e zbulojnë gazetarët nga Suedia dhe Kanadaja. Ne që kalojmë çdo ditë dhe i shohim duke mbledhur krom, është krejt normale, derisa të bëhen lajm për kronikën e zezë.

Në fshatrat e Dibrës ka fëmijë që vuajnë për bukë dhe që nuk shkojnë në shkollë. Nuk dinë të shkruajnë dhe as të lexojnë. Por kjo nuk përbën lajm për mjedisin tonë, pasi kalueshmëria zyrtare është 100%.

Këtë muaj, një biznes pularie në Guben falimentoi dhe, kur falimenton, mblidhen të gjithë t'i blejnë pulat me çmim të lirë. Madje hapin edhe sendilet e benzave që u kanë sjellë vëllezërit dhe kunetërit nga perëndimi që t'i mbushin me morra. Ndërsa kur biznesi ecën mirë, njerëzia thonë: "U bë edhe ky me na shit mend!"

Këtë muaj u punua shumë për shtegun malor për turistët në dy anët e Dibrave. Por prapë shtegu te dogana në Bllatë të nxjerr.

Lajmet për rrugën nuk kanë të mbaruar. Ca thonë janë ndërprerë punimet, ca të tjerë janë prerë financimet. Ca të tjerë kanë ikur makinat, të tjerë nuk ka para. Dikush takon kinezët, dikush pret kryeministrin. Dikush lajmëron protesta, të tjerë bëjnë statuse *facebooku*. Dhe rruga është aty në ëndrrat dhe shpresat e njerëzve...

"Rama nuk është dibran, por mund të bëhet dibrani më i madh, duke ndërtuar Rrugën e Arbërit", na thanë lajmet nga matanë kufirit. Në fakt, nuk kemi nevojë që ai të bëhet dibrani më i madh, por që ai të jetë Kryeministri i Shqipërisë dhe Dibrën ta shohë si pjesë të shtetit shqiptar.

Ndërsa çështja "Radika" po bën pushime, kanë dalë problemë të tjera me ujërat: në Valikardhë po bëhen protesta, ndërsa në skenë po rishfaqet Skavica. Duket se para se të ndërtojmë Dibrën, kemi në plan ta thajmë dhe ta mbytim: ndoshta kështu shitet më lirë ...

Doni te informoni komunitetin rreth jush per dicka qe ju intereson atyre?

BASHKËPUNO EDHE TI!

Shkruani ne gazete!
< rrugaearberit@gmail>

Një lapidar në kujtim të makinave të dëmtuara



Një lapidar me pjesë makinash, si kujtesë për "rënien" e shumë makinave në rrugën Dibër - Gostivar është vendosur anash rrugës në Dibër të Madhe. Shoqata "Qendra për Zhvillim të Komunitetit", gjatë një trajnimi për "aktivizimin e qytetarëve" në kuadër të programit për "Qeverisjen e Mirë", u diskutua edhe për problemin e rrugëve në Dibër si dhe aksin rrugor drejt Urës së Radikës. Një grup i të rinjve në këtë trajnim, Miron Mulladauti, Meriton Dovolani, Leonard Abazovski, Fatjona Pocesta, Goce Ljubinovski dhe Edita Mela, ideuan vendosjen e kësaj "përmendorje" të punuar prej pjesëve makinave të prishura në këtë rrugë, me mbishkrim "Shpresojmë që përmendorja të qëndrojë sa më gjatë, që të na përcjellë mesazhin te organet përgjegjëse që të ndërmarrin masa për asfaltimin e kësaj rruge".

Shuip Marku nga shoqata "Qendra për Zhvillim të Komunitetit" tha për gazetën "Rruga e Arbërit" se "ne i përshëndetëm ideatorët dhe realizuesit e kësaj iniciative, pasi është një mënyrë krijuese mjaft interesante, përmes së cilës të rinjtë ngrenë zërin e protestës kundër organeve përgjegjëse ndaj injorimit që ata i bëjnë Dibrës".

Ky segment rrugor është rruga më e dëmtuar në Maqedoni. Ajo është në gjendje të mjerueshme.

Përveçse është rrugë e qytetit, është edhe rrugë kombëtare e ndërkombëtare.

Qytetarët e Dibrës, sidomos të fshatrave të cilët udhëtojnë çdo ditë në këtë pjesë, e përshëndetën këtë iniciativë, por nuk është e vështirë të dallosh në sytë e tyre mosbesimin se, megjithatë, institucionet nuk do të veprojnë në mënyrë që rruga të rregullohet.

Të rinjtë e Dibrës do të vazhdojnë të bëjnë veprimtari të ngjashme për senzibilimin e opinionit për problemet e qytetarëve, si higjiena në qytet, siguria në plazhin e qytetit, mungesa e ujit në sezonin veror etj.

Flamur Mulladauti, njëri nga aktivistët, thotë se "Rruga Dibër-Mavrovë, e cila është e karakterit ndërkombëtar, është rrugë mjaft e rrezikshme, si për jetën e njerëzve, ashtu edhe për dëmtimet në mjetet automobilistike. Edhe pse në një pjesë është bërë rikonstruksioni, cilësia e punimeve ishte mjaft e dobët, dhe ajo nuk u përfundua në gjithë gjatësinë e saj. Në këtë rrugë lëvizin kamionë me tonazhe të lartë, të cilët kontribuojnë në shkatërrimin e saj. Institucionet që duhet ta mirëmbajnë nuk e kanë bërë punën si duhet, dhe kjo zakonisht ka qenë rrezik i vazhdueshëm për pjesëmarrësit në komunikacion". "Indinjata e qytetarëve është shprehur në mënyra të ndryshme, por ajo ka hasur në vesh të shurdhër tek shteti. Besoj se kjo mënyre e protestës do të vërë në lëvizje institucionet përgjegjëse", thotë Mulladauti.

Ndërsa Goce Ljubinovski, thekson se "është e pakuptimtë që shteti të harxhojë miliarda para publike për përmendore të pakuptimta, ndërsa qytetarët çdo ditë përballen me vështirësi të shumta, për eliminimin e të cilave duhet investuar shumë më pak".

Sado që të zgjasë ekzistenca e kësaj përmendoreje, ajo është një simbolikë që tregon jo vetëm realitetin në infrastrukturën në Dibër të Madhe, por edhe një simbolikë tejet kuptimplotë se si duhet ndërtuar rrugën në të ardhmen: Së pari për sigurinë e njerëzve, por edhe të mjeteve të udhëtimi!

Ditari i një vajze...



Jdashur ditar.. e di ç'është qesharake? Që megjithëse unë ty të them gjithçka, jam e sigurt që ti nuk di për mua aq shumë sa dijnë komshijet e mia. Nuk beson? Po ja, duke dalë dje për në shkollë, del komshia përballë.. me demek për të fshirë shkallët. Është e çuditshme se si e dëgjon gjithmonë kur hapet dera jonë dhe del si rrufe. Ndonjëherë kam kontrolluar edhe tavanet e korridorit për ndonjë kamera të fshehtë a mikrofon, se e kam vështirë ta besoj se ka aftësi mbinatyrore. Nejse, doli dhe filloi:

- "Mirmjes mi cuc!"
- "Mirmëngjes..."
- "Qëke tu shku n'shkoll a? Po a s'ke pushim orën e parë tëj, se zysh Dylberja ka operu vocin e kunatit? Ho mi at vocin si u zu me Gonin ktu posht nesh për atë cucën e Bajromit.."
- "Po, pushim kam, por do takohemi me gocat." – dhe nxitova të marr çantën e xhupin.
- "Gocat, po, po. Pahaj paske ble xhup t'ri a? Ke aj butiku n'krëje t'bulevardit e gjeve, at dit si ju erdh daja me xhith nusen e vocit për drekë? Alamet nusje kishte xhet ene aj! Pak e that kshu, pë përçef.. Ene tëj qëke bë e bukur sot.. Ene sëjt bukur i paske li.. Cuca ime m'kërkëj nji ditë tualete, pë unë i thash se ia kum pre durt me vu laps n'sëj!"
- "Ika teta Sanie, se më presin shoqet!"
- "Heee.. Kush mi? Ajë cuca e Gzimit? O cuc e mëjr ajë... Aj shoku asaj kishte ik n'Itali prap, a? Ishalla nuk mërzitët shumë, se mas nji jave keni ene provim n'matematik.. E keni t'sertë msuse Mozën, si të kishte vu 7 ke provimi at dit si erdhe tu qa n'shpëj direkt pas orës s'pestë. Ene tëj mus u mërzit çaç shum se nuk ta prëjsh nji 7 mesataren. Jo për xhë, pë tët atë pagun dhëjt mijë kokrra leku për nji or kurs si bën me Mozën! Gje kishe shku xhims ore me vones n'kurs. Nuk t'pashë kur dule se isha ul n'banjo, po m'tha Leta..."

Aty me xhupin n'dorë, nji atlete të lidhur e një jo, ia futa vrapit! Edhe në shkollë ndonjëherë më duket sikur e kam Sanien mbrapa...

Sania ka vërtetë aftësi mbinatyrore! Me atë memorje do kishte mbaru 5 shkolla historie!

Ndiq linqet e mëposhtëme në Web dhe Facebook për më shumë foto dhe komente nga Peshkopia e Dibra...

http://peshkopidiberalbania.wix.com

https://www.facebook.com/PeshkopiDiberAlbani

Rruga e Arbërit nr. 98

ftesë për diskutim

A janë dibranët pasardhës të Doberëve?

Nga **GAFUR ZOTA**

"...Thesalët quajnë penest jo ata që lindin skllevër, por ata që shtihen në dorë me anë të luftës".

Atheneu, libri IV, 85, 264, b

Dibranët nga historia e Shqipërisë kanë mësuar se janë pasardhës të fisit ilir, të Penestëve. Mirpo kohët e fundit, veçanërisht, në botimin Historia e Dibrës nga Prof. Dr. Kristo Frashëri, shohim të qarkullojnë teza sipas të cilave dibranët janë pasardhës të fisit ilir paion, të doberëve. Mendime të tilla i kam përcjellë pa një ndonjë vëmendje të veçantë, por kur shikon interesimi vazhdimisht në rritje, marr shtysë të shfaq edhe unë opinjonet e mija.

I pari që shfaqi mendimin sipas të cilit qyteti antik Doberos duhet kërkuar në luginën e Drinit të Zi, emër të cilin mbart sot krahina e Dibrës, ishte J. G. von Hahn.[1] Pas Tij, Prof. dr. Kristo Frashëri[2] dhe Apoleon Baçe[3] e lokalizuan Doberin në rrënojat e kalasë së Grazhdanit. Lidhur me këtë Kristo Frashëri shkruan:"...në kushtet e pështjellimit të madh që solli pushtimi romak, doberët u shpërngulën nga atdheu i tyre historik, Paionia dhe u vendosën në viset e penestëve duke i dhënë krahinës emrin e tyre dhe duke sjellë me vehte edhe emrin e malit Orbel, të cilin e mbart fshati Herbel, afër kalasë së Grazhdanit.[4] Më pas tezën e modifikoj duke shtuar:"Kordinatat e gjeografit aleksandrin (Klaud Ptolemeu shën. im) dhe lidhja gjuhësore Debor-Dibër, na detyrojnë t'a kërkojmë qytetin Debor-os diku, në një pikë të trevës Dibrane. [5]

Teza e Prof. Frashërit gjeti mbështetën e studjuesve dibranë: Hilmi Sadikaj, Iljas Kaca, Adem Bunguri, Arjan Kadiu, Besnik Kbej, Ramazan Kica, ...e ndonjë tjetëri, të cilin ndoshta nuk kam arritur t'a konsultoj. Në mbështetje të tezës së mësipërme i ndjeri Hilmi Sadikaj, shkruante:"...Tek autorët antik, në trevën, ku sot shtrihet Dibra, pranë kalasë së Grazhdanit, na përmenden Doberët. Në kohën e pushtimit romak quhej Deborus që sipas hartës së Ptolemeut, shek. II e. jon, vendosej në VP. të Ohrit". [6] Më parë se Prof. Kristo Frashëri ta modifikonte tezën e Tij, studjuesi Iljaz Kaca shkruante:"...Kordinatat e dhëna nga Ptolemeu dhe lidhjet gjuhësore debor-Dibër të shtyjnë për t'a kërkuar qytetin Deboros diku, në trevën dibrane. [7] Prof. asoc. dr. Adem Bunguri tezën e prof. Kristo Frashrit e pranon në mënyrë të kushtëzuar: "...Duke pranuar edhe lëvizjen migracionare të doberëve nga Paionia në Penesti, të propozuar nga Prof. Kristo Frashëri, të gjitha të dhënat të çojnë në Dibër. [8]

Tezën në fjalë e kan lakuar edhe studjues tjerë të cilët edhe pse punimi i tyre nuk ka kurfarë lidhje me temën, e kanë bërë atë pjesë të diskutimit të tyre. Prof. dr. Arian Kadiu shkruan"... Ajo (Dibra shën. im). shfaqet si nuse në hartën e Ptolemeut."[9] Ramazan Kica shkruan: "...Me emrin Dober ajo (Dibra shën. im.) përmendet këtu e 3200 vjet më parë, që në luftën e Trojës". [10] Edhe studjuesi Besnik S. Kbej duke u marrë indirekt me etimologjinë e emrit Dibër shkruan:"...pra, doberanët janë paraardhësit e lashtë historikë të dibranëve të sotëm, d. m. th. emri ka ardhur i njejtë për njëzetë e gjashtë shekuj. ". [11]

Të shkruash: Doberët te autorët antik na përmenden pranë kalasë së Grazhdanit (H.S.), Dibra në trajtën Dober përmendet 3200 vjet më parë (R.K.);se përmendet në hartën e Ptolemeut (A.K.); se emri i saj ka ardhur i njëjtë për njëzet e gjashtë shekuj (B.K.) se...do të thotë se gjithshka është e zgjidhur. Është e qartë se studjuesit e mësipërm janë vënë në një emrues të përbashkët duke u dhënë doberëve qytetarinë, në Dibër. Mbetet kjo të konfirmohet më tej duke e pasqyruar në botimin bazik të historisë së Shqipërisë.

Cituam në ligjëratë të drejtë mendimet kryesore që studjuesit dibranë sjellin në mbështetje të J. G. von Hahn dhe Prof. Dr. Kristo Frashërit. Gjëja e parë që konstaton nga leximi i tyre është mungesa disa kolonave ku teza të mbështetet, mungon pikpamja e kundërt, madje në asnjë rast nuk përcillet dyshimi. Ato në fakt mungojnë te prof. Frashëri, por edhe te kolegët e mij që e kanë mbështetur. Pra janë shumë të vakta përpjekjet për ta provuar një hipotezë të tillë, për ta disaprovuar apo ndryshuar.



Pamje e rrënojave të Kalasë Grazhdanit, monumenti antik, buzë rrugës nacionale. Kalaja mendohet se shtrihet në një sipërfaqe prej rreth 34 ha dhe gjatësia e mureve rrethuese të saj mendohet të jetë 3.5 km. Studimet e deritanishme e lidhin këtë vend me origjinën e emrit "Dibër", gjë të cilën e vë në dyshim historiani Gafur Zota në shkrimin e mëposhtëm.
Foto © Bujar Karoshi.

Profesori i nderuar Kristo Frashëri, por edhe kolegët e mij që e kanë mbështetur Atë, nisen nga dy teza kryesore, nëse mund ti quajmë, teza sprovë. Teza e parë ka në themel të saj shpërnguljen e doberëve nga atdheu i tyre historik Paionia për në Penesti (Në punimin Historia e Dibrës profesor Kristo Frashëri e ka modifikuar mendimin e shfaqur më parë duke bërë fjalë për një grup doberësh). Mendimi i shfaqur për lëvizje të doberëve drejt Penestisë natyrshëm shkakton disa pyetje: Ishte dukuri e fiseve ilire lëvizja migracionare apo vetëm e Doberëve? Kjo lëvizje ishte e dhunshme apo u bë paqësisht? Bëhet për kushte më të mira jetese dhe a ofronte Penestia një mjedis të till fiziko-gjeografik? Nëse po, ishin aq potencial sa të ndryshonin etnikosin e një popullsie? Nëse kjo lëvizje ndodhi me të vërtetë, në ç'raporte u vu popullsia e ardhur me atë vandase? Si është e mundur që një dukuri e tillë, me përmasa dhe pasoja sa të ndyshojë identitetin e një popullsie(fisit ilir të Penestëve), është kaluar pa u vënë re nga studjues që drejpërdrejt apo terthorazi janë marrë me penestët dhe Penestinë?

Asnjëra nga këto pyetje nuk merr përgjigje në mendimin e shfaqur. Profesor Frashëri gjithshka e lidh me luftrat iliro-maqedone kundër Romës, veçanërisht me shkatërimet dhe shfarosjet që Perseu bëri në Penesti. Edhe pse nuk thuhet në mënyrë të drejtpërdrejtë, kuptohet se doberët mbushën "vakumin" që u krijua në Penesti pas shkatërrimit të Uskanës, Draudrakut, Oenes dhe kështjellave të tjera peneste.

Edhe më parë, fiset ilire, veçanërisht dardanët dhe Paionët, kishin qenë objekt i ballafaqimeve të mëdha ushtarake me maqedonët. Madje njihen nga burimet e kohës formimi i "Ilirisë së shkretuar"[12] apo siç shkruan Livi, "Krahinat e shkretuara të Ilirisë"[13] Pra pështjellime kaq të mëdha, kishin ndodhur edhe gjatë konflikteve të armatosure mes maqedonasve, me në krye Filipin dhe mbretërisë ilire të Dardanisë. Studjueit e nderuat Prof. Dr. Selim Islami dhe Skënder Anamali, Beb Jubani edhe pse kanë trajtuar çështje që lidhen me penestët dhe Penestinë nuk bëjnë fjalë për pështjellime të tilla.

Mundësia e lëvizjes së doberëve drejt Penestisë bëhet akoma më e vogël pas modifikimit që Prof. Frashëri i bëri tezës së Tij, rreth lëvizjes të një grupi doberësh. Sigurisht një grup i tillë zor se mund të ndryshonte etnikosin e një popullsie siç ishin penestët. Edhe sikur për një çast të pranonim lëvizjen e doberëve drejt Penestisë, ata do të ndesheshin me kundërshtarët e vjetër maqedon të cilët tashmë zotronin Penestinë. Pra, doberët në Penesti do ballafaqoheshin fillimisht me maqedonët dhe më pas me pushtetin Romak që u rivendos këtu.

Nëse rikthehemi te pyetjet e bëra më parë, lidhur me mundësinë e një lëvizje të një grupi të fisit ilir të doberëve drejt Penestisë, duhet të vështojmë kushtet që ofronte Penestia në karahasim me Paioninë. Sot kemi një lëvizje

Burimi në të gjitha rastet nuk është lexuar drejtë, se gjeografia e emrave është shumë larg dhe se nuk ka kurfar lidhje me Penestinë. Gjithë përpjekjet për të vendosur barazimin mes emrit antik deboros-Dibër përbëjnë në fakt një hipotezë në tentative. Natyrshëm lind pyetja: Ç'u bënë penestët?

të gjërë nga vise rurale drejt atyre urbane. Dhe kjo, për një jetë më të mirë. Vështirë të ketë ndodhur një lëvizje popullsie për shkaqe të tilla drejtë Penestisë. Ajo kursesi nuk ofronte kushte më të mira mjedisore në karahasim me luginën e Vardarit ku banonin doberët. Pjetër Bogdani (1630-1689), doctor në filozofi e teologj, i emruar nga papa Inocenti i XI kryepeshkop i Shkupit, më 1677, përmend malin Orbelia pranë Shkupit "...Mbi Shkup, në drejtim të malit Orbelia, larg nja një milje, gjendet një anije shumë e madhe dhe e përshtatëshme për transport. Aty gjëndet edhe një kështjellë me nja 30 shtëpi...Muret janë pjesërisht të rënuara. Në anën jugore ndahet nga Aksisos(lumi Vardar), kurse nga ana perëndimore, mbi mure, shihet stema e Shën Markut, në formë të luanit, e dëmtuar nga barbarët, shkatrruesit e përhershëm të gjërave të vjetra e me vlerë... Në drejtim të malit Orbelia, toka është pjellore, drujntë e lartë të malit shërbejnë për punim mjeshtërie e për çdo nevojë tjetër. Për rreth shihen vreshtat e mëdha e të panumërta, kështu që nga kjo prodhohet vera e cilësisë së mirë, si e bardha, ashtu e zesa e mushti". [14]

Kushdo që lexon këto rrjeshta të shkruara 200 vjet para Hahnit, afërsisht para 350 vitesh nga sot, zor se mund të besojë që doberët, pa patur ndonjë shtysë madhore, të vendoseshin në Penesti, aq më pak në Herbel i cili kursesi nuk ofron as minimumin e kushteve të sipërthëna. Për më tepër ende përmendet Orbeli antik dhe jo në formën Herbel.

Në të vërtetë një mendim i tillë ka si pararendës tezën sipas të cilës qytetin Doberos që gjeografi aleksandri Klaud Ptolemeu përmend në hartat e Tij, duhet ta kërkojmë në Dibër. Madje, sipas kësaj harte, Prof. Kristo Frashëri, Apoleon Baçi, Hilmi Sadikaj, Iljaz Kaca, Ramazan Kica e ndonjë tjetër Doberosin e vendosin në kalanë e Grazhdanit.

Natyrisht kapja pas saj bëri që të kërkohen faktorë të tjerë që të mund t'i kenë shtyrë doberët drejt Penestisë-Dibrës së sotme. Lind pyetja: Ka ndonjë studim nga rrethe të albanologjisë apo hartografisë mbi sistemit kordinativ që sjell Ptolemeu? Ka mospërputhje që lindin nga krahasimi i tyre me sistemin e sotëm kordinativ? Si janë lexuar të dhënat që sjell Ptolemeu në sistemin hartografik? Cila është gjeografia e emrit doberos dhe trajtave të tij te autorët antik?

Që në fillim më duhet të shpreh vlersimin tim se sistemi kordinativ i përdorur nga Ptoleme të cilin prof. Frashëri dhe kolegët e mij e përdorin si tezë të dytë, nuk është lexuar drejt, se burimi i dhënë nuk shikohet në tërë kontekstin e tij. Nëse shikojmë me vëmëndje, nuk është vështirë të konstatohet se qyteti Lyhnidos, në token e dasaretëve, jepet në kordinatat 47˚40′ gjërësi veriore (shën. im) dhe 40˚20′ gjatësi lindore(shën. im)kurse qyteti Doberos, në Paioni në kordinatat 46˚40′gjërësi veriore (shën. im) dhe 40˚45′gjatësi lindore (shën.im).[15]

Pra sipas sistemit kordinativ të hartës së Ptolemeut qyteti Doberos i bie të jetë më në jug të Lyhnidit, kur Prof. Kristo Frashëri, Hilmi Sadikaj, Iljaz Kaca, Ramazan Kica dhe Apoleon Baçe e japin në vp. të Lyhnidit(Ohrit), në Penesi, gjegjësisht në Grazhdanin e sotëm.

Edhe prof. Eqerem Çabej emrin Dibër e shpjegon me sllavishten e vjetër kishtare "dëbrë" që do të thotë luginë, greminë, humnerë.

Mark Twain shkruan: "Ndryshimi midis fjalës së duhur dhe fjalës gati të duhur është si ndryshimi mes vetëtimës dhe xixëllonjës".

Mospërputhje të tilla sistemi harografik i Ptolemeut ka shumë. Jo vetëm kaq, por Ptolemeu e thekson qartë kur shkruan se Doberosi gjëndet në Paioni. Ai përmend doberët bashkë me fiset: arethusët, antiohët, idomenset... rëzë maleve të Rodopit, Skopit dhe Orbelit. [16] Pra doberët shtrihen në vl të Lyhnidi (Ohrit), larg tij dhe jo në vp. të Ohrit siç pretendohet e vendosen nga kolegët e mijë të nderuar. Referimi që i bëhet hartës së Ptolemeut, mendojmë, nuk e zgjidh problemin. Për më tepër, leximi i gabuar i saj çon në përfundime të gabuara. Siç është e vështirë emërtimi i maleve, lumenjëve, qyteteve, rrugëve, kështjellave te autorët antik, po aq e vështirë paraqitet edhe leximi i sistemit kordinativ të përdorur nga Ptoleme.

Po cila është gjeografia e emrit doberos dhe e doberëve në antikitet? Straboni përmend deuriopët mes lynkestëve brigëve dhe pelagonëve"... Gjithë qytetet e deuriopëve ndodheshin gjatë lumit Erigon...Kur njeriu ecën drej veriut prrej Heraklesë (Në burime të ndryshme e ndeshim edhe Pelagonia-Rafshi i Manastirit-Bitolja)) dhe ngushticave nëpër të cilat kalon Strymoni, duke lënë në të djathë lumin, nga e majta ka Paioninë dhe viset rreth Doberit, Rodopit dhe malit Hem. Aksi (lum) dhe Strymoni (lum) i ka burimet në Paioni". [17] Po ashtu kur bëhet fjalë për itinerarët, Miller përmend se rruga nga Singiduni(Beograd) për Konstandinopojë kalon nga "ad scrofulas", pranë Dobres. [18] Në këtë burim Dobres jepet shumë larg, jashtë çdo lidhje me rrugën Egnatia. Edhe Zosimi me rastin e dyndjeve të fiseve barbare rreth Athos dhe Helespontit (Selaniku) shkruan për plaçkitje më në thellësi, të fshatrave rreth Doberës dhe Pelagonisë (Rafshi i Manastirit). [19] Ngjarjet mendojmë zhvillohen në vl. të Herakleas (Bitoljes). Një gjë të tillë e vërejmë edhe në ndarjen që Konstandini i bëri Perandorisë. Qytetin Dobre e përmend bashkë me thrakinë, Myzinë, Amin, dhe Rodope, si kufi. [20] Dober këtu është shumë larg nga Penestia. Edhe Hieroklis Synecdemus në "Guida e Hierokliut" përmend Dioboros, por nga renditja rezulton përsëri larg Penestisë, mes Bitoljes dhe Gevgjelisë. [21] Duke u njohur me gjeografinë e emrit: Deuriop, Dobere, doberos, Doberës, Dioboros, doberët, doberan, me një vështrim të kujdesshëm, konstatojmë se ato gjenden në Paioni, shumë larg Penestisë. Ato shfaqen nga mali Orbel afër Shkupit, në veri, drejtëPelagonisë (Rafshi i Manastirit), ndërmjet Herakles (Bitoljes) dhe Gevgjelisë. Në asnjërin rast të sipërshënuar, madje as në burimet e shek. I-VI e. jonë, doberët nuk i ndeshim me emër në teritorin e Dibrës së sotme, në vp. të Lyhnidit siç shkruajn Hahn, K. Frashëri dhe disa autor dibran, por në vl. të Lyhnidit e Heraklesë.

Studjuesi Hilmi Sadikaj duke këmbëngulur në lidhjen e emrit të sotëm Dibër me antikiktetin citon emrin Deborus. [22] Prof. Frashëri emrin Debri e përmend në trevën e garamantinëve, fisin debri ose deuri në zonën e dalmatëve, Debria ose Deura në provincën e Remensianës. [23] Mendojmë se burimi në të gjitha rastet nuk është lexuar drejtë, se gjeografia e emrave është shumë larg dhe se nuk ka kurfar lidhje me Penestinë. Gjithë përpjekjet për të vendosur barazimin mes emrit antik deboros-Dibër përbëjnë në fakt një hipotezë në tentative.

Natyrshëm lind pyetja: Ç'u bënë penestët?

Prof. Frashëri shkruan: "...Fati i mëtejshëm i Penestëve dhe i Penestisë u përcaktua me përfundimin fatkeq të luftës iliro-romake dhe maqedone-romake... Madje emri i penestëve dhe i trevës së tyre, Penestia, nuk përmenden në asnjë nga burimet e shkruara të mëvonshme, me përjashtim të rastave kur flitet për luftrat romako-maqedone të vitave 170-169 p. e. s. 22 Nga hulumtimet e bëra, mendoj se burimi nuk është shteruar kënaqshëm. Madje nuk është lexuar drejtë. Penestët përmenden në burime në fund të shek. III p. e. s, d. m. th. më parë se të zhvilloheshin luftrat maqedone–ilire kundër Romës. Plaurati, i biri i Skerdilajdit, në përforcimin e Kasandresë përveç rinisë guximtare

Gafur Zota: Unë i përkas fisit ilir të penestëve për të cilin në vitet 200 e. Jonë Atheneu shkruante: "...Thesalët quajnë penest, jo ata që lindin skllevër, por ata që shtihen në dorë me anë të luftës".

të qytetit edhe 800 agrianëve kishte dhe 2000 penest ilir. [23] Kjo dëshmon se penestët ishin një fis ilir potencial dhe se përmenden në fundin e shek. III p. e. s. Po ashtu edhe pas pushtimit që Peseu u bëri qyteteve dhe kështjellave Peneste, ato vazhdojnë të citohen në burime. Kështu Perseu në përpjekje për ta mbrojtur Kasandrenë nga Ap Klaudi edhe pas rënies së Uskanës, Draudakut, Oenesë dhe kështjellave peneste thiri në mbrojtje 200 kalorës dhe 1000 këmbësorë nga fisi ilir i penestëve. [24] Përveç kësaj Prof Frashëri dhe kolegët e mij kanë kaluar në heshtje faktin që pas afro katër shekujsh, Atheneu, nga Neukrati i Egjyptit i përmend penestët. [25] Si edhe për raste tjera ato përmenden në burime vetëm në ngjarjet ku edhe kanë prezencën e tyre. Është vështirë të besohet se etnikosi i tyre humbi pas luftrave iliro-maqedone kundër Romës apo me pushtimin që Perseu u bëri Uskanës, Draudrakut, Oenesë dhe kështjellave tjera peneste. Luftrat e Maqedonëve, me në krye Perseun, pavarsisht përmasave, kursesi nuk mund të zhduknin një popullsi, madje shumë trime, duke e mbushur "vakumin" e krijuar me një grup i një tjetër popullsie ilire, të fisit të doberëve.

Prof. Frashëri, por edhe kolegët e mij dibran, duke pranuar si të mirëqenë doberët në ish trevën peneste, mendojnë se emri Dibër, dibranë me gjithë trajtat e tij që ne ndeshim te autorët bizantin, është vazhdim i emrit antik Dober. Duke vënë barazimin mes emrit Dober dhe Dibër, mendojnë se tashmë kemi një"rishfaqie"të tij. Pra penestët u zhdukën.

Mungesa e penestëve, por jo vetëm, gjatë shek IV-XI e. jonë, madje "shfaqia" e doberëve në vend të tyre nuk na duket as metodikisht e drejtë. Janë anashkaluar ngjarje që tronditën perandorinë Romake të Perëndimit dhe të Lindjes(Bizantit). Kronikat e kohës janë mbushur me dëshmi rënqethse. Eusebius Hieronymus nga Stridoni i Dalmacisë shkruan:"... Të rënqethet shtati kur mendoj të tregoj për shkatërrimet në kohën tonë...goti, sarmati, kuadi, alani, huni, vandalët dhe markomanët shkretojnë, plaçkisin dhe grabisin Skythinë, Thrakinë, Maqedoninë, Dardaninë, Dakinë, Thesalinë, Ahenë, Epirin, Dalmatinë dhe gjithë Panoninë... Kur shkretohen qytetet dhe vriten njerëzit, ikin dhe rallohen edhe kafshët, zogjtë e peshqit;për këtë është deshmitar Iliriku, deshmitar është Thrakia, deshmitar është vendi ku kam lindur, ku çdo gjë u zhduk, përveç qiellit e tokës, gjëmbave që rriten dhe pyjeve të dendur...[26] Kurse Klaudiani shkruante: "... Eh sa gjëra të mëdha për një kohë të shkurtër zhduken..."[27] Në të njëjtën linjë Zosimi shkruan: "..., një pjesë e hordhive të tyre(skythëve) shkretoi Ilirinë dhe shkatrroi qytetet e saj"...[28]

Jo më pak rënqethëse jan kronikat mbi dyndjet sllave. Prokopi i Cezaresë shkruan: "...Afërsisht në këtë kohë (vitet 547-548 e. jonë)një ushtri sllavenësh duke kaluar lumin Ister (Danubi), bëri shkatrrime të tmershme në gjithë Ilirinë deri në Epidamn (Durrës) duke vrarë dhe kthyer në skllevër të gjithë ata që u dilnin përpara, pa marrë parasyshë gjininë apo moshën dhe duke grabitur pasurinë... Iliria dhe Thrakia iu nënshtruan grabitjes dhe asgjesimit pa asnjë mëshirë nga ana e barbarëve... Në këtë kohë një turmë e madhe sllavenësh u derdh në Iliri dhe bëri atje tmerre të papërshkruara... Ata mbushën rrugët me grumbuj trupash (njerëzish shën. im), morën robër dhe kthyen në skllevër një numër të madh njerëzish. Më tej: "...hunët, sllavenët dhe antët janë dyndur pothuejse çdo vit në Iliri dhe në gjithë Thrakinë dhe gjithë tokat që shtrihen që nga gjiri i detit Jon deri në lagjet e jashtme të Bizantit...kanë kryer akte të padëgjuar kundrejt banorëve të këtyer vendeve...Besoj se çdo dyndje ka pasur më shumë se 200000 romak (kështu quheshin banorët e perandorisë romake të Perëndimit dhe të Lindjes, Bizantit shën. im) të vrarë ose robër dhe gjithë këto vende u bënë aq të shkreta sa edhe shkretëtirat e Skythisë". [29] Sllavët – shkruan Georges Kastellan arritën në bregdetin Dalmat dhe tronditën Solonën, afër Splitit dhe Durrësin ...shkelën në shekujt e mëvonshëm perandorinë Bizantine me vale të ngjeshura që i mbytën të gjithë provincat (e Bizantit shën. im) që nga Istria (lumi Danub shën. im.) deri në Peloponez dhe Kretë". [30] Nga parashtresat e mësipërme kuptohet se jo vetëm penestët, por edhe fiset etjera ilire e më gjërë nuk ndodheshin larg ndikimit të këtyre zhvillimeve.

Me formimin e mbretërisë bullgare, shek. VI e. jonë, mbi sllavinitë e vjetra (vendet e sllavëve) u mbivendosën përsëri sllavë bullgarë. Këto në shek. IX kishin përqafura fenë e krishterë. Futja e shkrimit glagolitik dhe përkthimet e shkrimeve të shenjta në sllavonishte (sllavishtja e vjetër kishtare) u shoqërua me ndryshime të mëdha në Bizant. Georg Kastellan shkruan se pas henelizimit (ndryshimi i parë i madh në Ballkan), Imperium Romanum apo siç njihet romanizimit (ndryshimi i dytë i madh në Ballkan), kemi një simbiozë mes strukturave të shtetit romak, kultures helene dhe kishës së krishterë (ndryshimi i tretë i madh në Ballkan). [31] Dyndjet barabare, veçanërisht ato sllave, lanë gjurmë jo vetëm në toponominë e emrave, por u shoqëruan edhe me modifikime të ndjeshme etnike. Këto dukuri u bënë më të theksuara me caret bullgarë, veçanërisht me Stefan Dushanin e Serbisë(1331-1355). Si rezultat i këtyre ndryshimeve, u fshinë nga burimet jo vetëm penestët, por edhe dardanët, paionët, dasaretët ..., qytetet: Skampa, Ambrakia...dhe dolën në skenë: Deja, Kruja, Himara, Kolonja, ... Dibra. [32] Nën pushtetin e Car Samuelit Dibra, Gllavinica, Bitolja, Velesi, Prizreni... Prespa(kryeqendra e Samuelit)përmenden në burime sllave, por pa një përcaktim se cilës kategori i takonin:"Polis", "Kastra", "Frourion"apo "Ksour". [33]

Pra, në procesin e dyndjeve sllave, organizimin e ri kishtarë, futjes së sllavonishtes(gjuhës së vjetër kishtare), në procesin e ndryshimit të Tret të madh në Ballkan, mendoj se shumë fise, qytete, male, lumej, kështjella na shfaqen jo më me emrat e antikitetit, por me toponimi të ndryshuar, kryesisht sllave. Këto toponime sllave në periudhën e ballkanit greko-sllav(ndryshimi i Katërt i madh i Ballkanit)u konsoliduan më tej. Dyndjet barbare, veçanërisht ato sllave, ishin pështjellime më të mëdha se ato që përmend prof. Kristo Frashëri dhe që janë mbështetur nga kolegë të mij dibranë. Këto zhvillime nuk u bënë pjesë e diskutimit. Pra u kaluan në heshtje të plotë mbi VI-të shekuj, deri në shfaqien e emrit Dibër dhe trajtave të sajë.

Te këto ndryshime, te sllavishtja e vjetër kishtare, e shpjegojnë emrin Dibër një grup studjuesish. Prejardhjen e emrit Dibër nga sllavishtja e vjetër kishtare, nga një fjalë e përgjithshme e leksikut të sajë "Dëbrë" e shpjegojnë: Selishçev, I. Popoviç, Vasmeri, Vladimir Georgiev, Duridanev, Pjanke. [34] Një mendim të tillë e gjejmë të shprehur edhe në historinë e Shqipërisë, vol. I, Tiranë 1967. Edhe prof. Eqerem Çabej emrin Dibër e shpjegon me sllavishten e vjetër kishtare"dëbrë" që do të thotë luginë, greminë, humnerë. Në mbështetje të tezës së prejardhjes së emrit Dibër nga sllavishtja e vjetër kishtare Studjuesit: Selishçev, Popoviç, Vasmer, Georiev, Duridanev, Pjanke sjellin nga viset e: Kroacisë, Hungarisë, Serbisë, Kosovës, Maqedonisë, Bullgarisë, Greqisë, Shqipërisë një mori emrash si: Dobrishtë, Dibri, Dobrica, Dobrinova, Dobrenjë, Dobrane, Dobracan, Dobraç, Dibre, Debren, Dibere, Dibreiv, Debërcë, Dreven, Dobrac, emra të cilë shpjegohen me sllavishten e vjetër kishtare, "dëbrë" grykë, luginë. Studjuesja Anila Omari përmend vendosjen e Grazhdanit në luginën e Drinit të Zi, kurse unë do të shënoja: gryka e Çajës, grykë Noka, Katër Grykët e Murrës, gryka e Vogël, gryka e Madhe, gryka e Radikës, të gjitha mikrorelieve të grykës apo luginës së Drinit. Në gjeografinë e pafund të toponimisë sllave do të shtoja mikrotoponimet Dibravë dhe Dobresh të cilët gjenden në fshatin tim të lindjes, Shimshan, 4 km. në veri të qytetit të Peshkopisë.

Në kontekstin e asaj çka parashtruam, më duket se lidhja Dober – Dibër më shumë ngjan si një sinonim, si një përpjekje patriotike, si një ndërmarrje për të mos e njohur realitetin, toponiminë sllave. Toponimia sllave mbuloi edhe Peloponezin, por fakti që greqishtja ishte gjuhë e shkruar, një dukuri e tillë u zbeh shpejtë. Ndryshe ndodhi me trevat e Arbërisë, ku në mungesë të gjuhës së shkruar, u ruajtën emërtimet sllave, madje kisha dhe shteti sllav i bënë objektiv të politikës së tyre. Në kohën kur Bullgaria ishte një shtet i forte, kur serbët u fuqizuan së tepërmi, por edhe gjatë sundimit të gjatë osman, princër dhe njerëz të thjesht arbër jetonin pa kurfarë komplesi nacional me fqinjët. Bënin me ta ekonomi, por edhe krushqira. Çështja jonë nacionale lindi shumë vonë e kjo favorizoi jo pak veprimtarinë e kishës dhe qarqeve fqinje në konsolidimin e toponimisë sllave, por jo vetëm të saj. Emërin Golem e ndeshim në: Shkodë, Kavajë, Lushnjë, Ersaekë e ku ta dijë unë se sa herë tjera. Kjo tregon intensitetin e toponimisë sllave, ndaj në periudhën e Mbretërisë ka patur iniciative për ti shqipëruar toponime të tilla.

Me të drejt lexuesi pyet: "Po ju çfarë ndjeheni"!?

Mendoj se përgjigjen e ka marrë nga çfarë parashtrove më sipër. Shkrimi gjithmonë zbulon formën dhe shëmbëlltirën e mëndjes. Pra, Unë i përkas fisit ilir të penestëve për të cilin në vitet 200 e. Jonë Atheneu shkruante: "...Thesalët quajnë penest, jo ata që lindin skllevër, por ata që shtihen në dorë me anë të luftës". [35] Pa pretenduar të kemë thënë gjithshka, aq më pak të kemë të drejtë, bëra një ftesë për diskutim. Kjo është e nevojshme pasi prof. Frashëri dhe kolegët e mij bëjnë fjalë për mbivendosje popullsi, në Penesti e për rrjedhim, ndrrim etniciteti.

---

1. J. G. Von Hahn. Albanesische studien, vol. I, Jena 1854, f. 244
2. Kristo Frashëri. Në gjurmë të qyteteve Penest, Studime Historike, 4, viti 1974, f. 151. Më tej Kristo Frashëri. Historia e Dibrës, Tiranë 2012, f. 63, 64, 66.
3. Apoleon Baçe. Fortifikimet e antikitetit të vonë në vendin tonë. Monumentet 1976, Nr. 11, f. 49-50
4. Kristo Frashëri. Historia e Dibrës, po aty.
5. Po aty.
6. Hilmi Sadikaj. Dibra dhe vendi I saj në arealin Arbër. Dibra dhe etnokultura e saj, Dibër, më 1995, vol . I, f. 91
7. Iljaz Kaca. Rrugët e vjetra të Dibrës, Tiranë 2003, f. 32
8. Adem Bunguri. Mbi urbanizimin antik dhe të mesjetës në krahinën e Dibrës (diskutim). Dibra dhe etnokultura e saj. Po aty, f. 52.
9. Arjan Kadiu. Dibra e Madhe, Shehri i Dibrës, Tiranë 2003, f. 15
10. Ramazan Kica. Baba Fejzë Bulqiza-prag dhe pistë e bërjes shtet të kombit shqiptarë. Kumtesë e mbajtur në veprimtarinë shkencore kushtuar 95-vjetorit të Kongresit të Dibrës. Kongresi I Dibrës, Dibër e Madhe 2005, f. 151-155(botuar me shkurtime).
11. Besnik S. Kbaj. Origjina dibrane e Skënderbeut. Tiranë 2010, f. 12-13.
12. Ilirët dhe Iliria te autorët antic, bot. III, Tiranë 2002, f. 67. Polibi. Historitë, Libri XXVIII 8, 3
13. Po aty, f. 123. Tit Livi, Libri XLIII, 20 (1, 2).
14. Mahmut Hysa. Autorë dhe tekste nga letërsia e vjetër shqiptare. Shkup, 1992, f. 232-233.
15. Ilirët dhe iliria..., f. 268. Klaud Ptolemeu, Geografia, libri III 25, 29, 30. Vendi që zë Maqedonia.
16. Po aty.
17. Ilirët dhe Iliria..., f. 160, Libri VI, 6(9).
18. Po aty, f. 310. Itinerarët. Miller, 12. col. 495-516
19. Po aty, f411, Zosimi. Historia e Re, Libri I, 43(1, 2).
20. Po aty, Libri II, 33(1).
21. Po aty, f. 453. Hyeroklis Synecdemus, Guida e Hieroklit. 638, 1 VII, Provinca e Parë Maqedone në Iliri.
22. Kristo Frashëri, Historia e Dibrës, po aty.
23. Ilirët dhe Iliria..., f. 127. Tit Liv, Libri XLIV(6, 7)
24. Po aty.
25. Po aty, f. 284-285. Atheneu, "Gostia e dietarëve", libriIV, 85(264 b)
26. . Po aty, f. 354. Eusebius Hyeronymus, Letrat, XL 16, (t. XXV, 676, col. 1340D, 1341A)
27. Po aty, f. 359, Klaudiani, Poema, V, 45
28. Po aty, f. 411. Zosimi, Historia e Re, libri I, 37, 1
29. Po aty. Prokopi i Cezaresë, Lufta me gotët, libriVII(III) 29(1)
30. Gerorges Kastellan, Historia e Ballkanit, Tiranë 1991, 22
31. Po aty.
32. Historia e popullit shqiptarë, vol. I, Tiranë 2002, f. 203
33. Stjepan Antoljak. Samuel and his state, Skopje 1985 f. 104
34. Anila Omari. Rreth prejardhjes së emrit Dibër. Dibra dhe etnokultura. . , po aty, f. 86
35. Ilirët dhe ..., Atheneu, po aty.

Rruga e Arbërit nr. 98

histori

Bazuar në të dhënat e reja dokumentare dhe përshkrimeve të fushëbetejës së Torviollit, shumica e historianëve bien dakord që beteja e Torviollit është zhvilluar në Fushë-Çidhën të Dibrës së Poshtme.

570 vjetori i Betejës së Torviollit



Nga **HYSEN REPA**

Beteja e Torviollit, 29 Qershor 1444 ku forcat e Lidhjes së Lezhës të komanduara nga Skënderbeu zhvilluan betejën më brilante kundër hordhive Osmane, ka hyrë në historinë ballkanike, europiane dhe botërore.

Historia e luftërave të popullit shqiptar kundër osmanëve nuk mund të jetë e plotë pa historinë e betejave të Skënderbeut. Një ndër betejat më të lavdishme, pa dyshim që është beteja e Torviollit. Autorë shqiptarë që nga M. Barleti, F.Noli, K.Frashëri, A.Hoxha etj, por dhe autorë të huaj e kanë përshkruar këtë betejë të lavdishme sipas këndvështrimeve të ndryshme dhe të bazuar në të dhënat historike osmane, venedikase, të Vatikanit etj. Kjo betejë është tashmë e përshkruar në disa enciklobedi botërore si Oxford, La Russe, Wekipedia, "Historia ushtarake e Ballkanit" dhe në mjaft tekste të historive europiane dhe botërore. Në të gjitha këto enciklopedi, Beteja e Torviollit e zhvilluar në Dibrën e Poshtme (Lown Dibra) është rreshtuar një nga betejat më të lavdishme e zhvilluar kundër Perandorisë Osmane krahas asaj të Fushë Kosovës, Nishit, Varnës etj. Por me një ndryshim se kjo betejë u fitua me forca më të pakta (rreth 15000 forca kundër 25 000 forcave), kurse në betejat e mësipërme, morën pjesë koalicion forcash (Hungari, Bohemi, Serbi, Bullgari, Moldavi etj.), me gjithë luftimet e përgjakshme dhe me pjesëmarrje më të madhe të forcave, përfunduan me humbje.

Përshkrime historike me vlerë kanë dhënë dhe disa nga historianët tanë si K. Frasheri, F. Duka, K.Biçoku etj.

Kjo betejë është prezent dhe mësohet nga shumë ushtri e vende të botës. Nga pikëpamja ushtarake kjo betejë është analizuar gjerësisht nga D. Radeshi, Sh. Leka etj. Mungesa e informacioneve të mëvonshme, glorifikimi i fakteve dhe imagjinata e paargumentuar e luftimeve, kanë krijuar një pamje jo reale të betejës. Kjo dhe për faktin se këto luftime përshkruhen në një territor jo real siç ishte Fusha e Domosdovës në Prrenjas apo në fushën e Vajkalit në Bulqizë.

Nga studimet e mësipërme lidhur me kohën e zhvillimit të betejës dhe pjesëmarrësit në betejë nuk ka shumë diferenca apo kundërshti, por lidhur me vendndodhjen e fushë betejës (Fusha e Torviollit) ka patur mjaft kundërshti si nga autor të huaj dhe shqiptarë.

Disa autorë e vendosin fushëbetejën në Dibrën e Poshtme (Barleti, Frashëri, Noli etj.) pa e percaktuar mirë gjeografikisht.

Disa e vendosin në Dibër, në krah të Drinit të Zi, por duke përshkruar një pozicion gjeografik që nuk i përket Dibrës (D. Radeshi, etj).

Të tjerë e vendosin atë në Dibrën e Poshtme të përcaktuar në Vajkal të Bulqizës (S. Alliu), në Fushën e Shumbatit (K.Frashëri) dhe më saktë sipas përshkrimeve të terrenit nga Barleti kjo i takon Fushës së Çidhnës në Dibrën e Poshtme (A. Hoxha, F.Biçaku etj.).

Bazuar në këto kundërshti, i janë imponuar historisë disa "lapidarë" përkujtimorë për këtë ngjarje. Një në Fushën e Domosdovës në Prrenjas (sipas D. Radeshit) dhe një në Vajkal të Bulqizës (sipas S.Alliut).

Bazuar në të dhënat e reja dokumentare dhe përshkrimeve të fushëbetejës së Torviollit, shumica e historianëve bien dakord që beteja e Torviollit është zhvilluar në Fushë-Çidhën të Dibrës së Poshtme.

Për mendimin tim, argumentet e paraqitura janë të sakta për disa arsye:

1. Plotëson përshkrimin historik dhe letrar të kësaj fushëbetejë.

2. Ploteson argumentet e lëvizjes së ushtrisë otomane të komanduar nga Ali Pasha në drejtimin Shkup –Dibër, nëpërmjet Luginës së Drinit të Zi.

3. Plotëson argumentet së Skënderbeu drejtonte ushtritë e Lidhjes së Lezhës ku komandantët e saj ishin me forca që lëviznin, nga Veriu (Dukagjinët, Balshajt), nga Dibra (M.Golemi) dhe Shqipëria e Mesme (Muzakajt,Topiajt).

4. Kjo fushëbetejë bëhej në vendlindjen e Kastriotëve (Sina e Çidhnës), ku ai (Skënderbeu) ndjehej më i fortë dhe osmanët donin ta ndëshkonin po aty. Sulltan Murati i II e sulmonte Skënderbeun në vendlindjen e tij, ku mendonte se kjo fitore do ishte vendimtare për shpartallimin e ushtrisë së Lidhjes.

5. Rikthimi i ushtrise osmane për të marrë hak në " Masakra e Çidhnës" në vitin 1466, është një argument më shumë për vërtetësinë e Fushës së Torviollit në Fushë Çidhën.

PËRSHKRIMI I TERRENIT

Sipas Barletit, fusha e Torviollit ishte një fushë në formë rombi në Dibrën e Poshtme, në krahun e djathtë të lumit Drini i Zi. Pothuaj dhe autorët e tjerë si të huaj dhe vendas, përshkruajnë një fushë të tillë në Dibrën e Poshtme, pa e përcaktuar plotësisht. Përshkrimet historike dhe letrare të kësaj fushe përputhen me pozicionin e saj gjeografik dhe territorial, me gjithë ndryshimet e pakta të terrenit në vite dhe zhvendosjes së popullsisë.

Sipas të dhënave të defterëve osmanë (A. Hoxha, K. Frashëri dhe H. Përnezha), kjo fushë ka qenë e pabanuar. Qendrat e banimit rreth saj kanë qenë kryesisht në krahun e majtë të Drinit (Sina dhe Gardhi i Poshtëm). Pas viteve 1750-1800, (H.Përnezha), kjo zonë filloi të banohet në banorë të rënë nga Çidhna e Grykë Noka, Sinja dhe Mustafej.

Po t'i referohemi pozicionit aktual të kësaj fushë që sot quhet Fushë Çidhen, (në vitet 1940/50), kemi këtë përshkrim:

Kjo fushë është e rrethuar me kodra me shkurre dhe ferra nga jugu dhe juglindja (kodrat e Çelias, Ostushit dhe të Laçes), nga veriu dhe lindja kodra me pyje të dendura dushku (Rrafshja e Shumbatit, Salbatre dhe Zabelet e Fushe Alie e Topuzit), në perëndim Lumi Drini i Zi. Kjo fushë përshkohet mespërmes nga përroi i Gramës (Blliçes) që rrjedh nga Korabi dhe derdhet në Drinin e Zi. Kësaj fushe nga jugu i paraprin Fusha e Kastriotit. Në këtë fushë gjendet dhe e ashtuquajtura historikisht "Ferra e Pashës", që nga gojëdhënat është vendi ku pas disfatës në Betejën e Torviollit u gjet i fshehur Ali Pasha. Në kujtim të kësaj ngjarjeje, me qindra vjet ky vend u bë historik dhe me kuvendet dhe lidhjet dibrane në luftërat kundër turkut dhe serbit.

FORCAT PJESËMARRËSE DHE ARMATIMI PËRKATËS

Lidhja e Lezhës, arriti të mobilizojë deri 15 000 (8000 kalorës dhe 7000 këmbësorë) forca për t'u përballur me ushtrinë prej 25 000 forcave të komanduar nga Ali Pasha. Në autorë të ndryshëm flitet për 8000-9000 luftëtarë shqiptarë. Po t'i referohemi M. Barletit i cili na konfirmon se ushtria e Skënderbeut luftoi në raportin 1 me 3, më e vërtetë se forcat e Lidhjes ishin diku tek 8000 deri në 9000 luftëtarë.

Mobilizimi ushtarak i Lidhjes bëhej në tre faza.

• Ushtarë profesionistë. Ishin ushtarë të përgatitur që kishin marrë pjesë në fushata ushtarake osmane apo në vende të ndryshme të Ballkanit. Në të shumtën e rasteve ishin kalorës por kishte dhe këmbësorë që njihnin artin e luftimit, kishin përgatitjen e duhur fizike dhe dispononin armatimin bazë (shpata, kama, shigjeta, topuzë, mburoja etj). Kjo pjesë e ushtrisë ishte në gjendje për t'u përballur në luftë frontale. Skënderbeu, e përdorte këtë pjesë të ushtrisë dhe si gardë personale. Të tillë gardë kishte dhe Kont Urani, Karl Topia, Gjergj Arianiti, Zaharia Gropa, Moisi Golemi, Ajedin Muzaka, Gjergj Balsha dhe Pal e Lekë Dukagjini. Këta ushtarë ishin nga 25 deri në 40 vjeç.

• Luftëtarë popullorë (burrë për shtëpi) deri në moshën 50 vjeç. Ky mobilizim bëhej në rast përballimi me ushtri të mëdha në numër, sidomos në fushata lokale. Kjo pjesë e ushtrisë ishin kalorës, por më shumë këmbësorë dhe merrte pjesë si kontigjent reserve në mbështetje të grupit të ushtarëve profesionistë. Ato stërviteshin për një periudhë të shkurtër dhe përdornin armatim të lehtë (Harqe, shpata, kama, sopata dhe cfurqe). Këto forca përdoreshin vetëm në periudha të caktuara dhe komandoheshin nga prijës të përgatitur vendas. Ato përdoreshin dhe në mënyrë të pavarur kur duhej të bënin prita dhe të dëmtonin në vijimësi kollonat ushtarake.

• Mobilizimi "7 e ne 70". Ky mobilizim i përgjithshëm bëhej zakonisht lokal, në ato zona ku zhvilloheshin luftime. Këta luftëtarë, pasi siguronin familjet në strehime natyrore ose kala e kështjella, merrnin pjesë si forcë e tretë si në luftime dhe në furnizimin e ushtrisë së rregullt me ushqim dhe materiale. Zakonisht vepronin në grupe të vogla të komanduar nga prijësit e çdo fisi ose me trimat, duke ruajtur në prapavijë ushtrinë e rregullt. Gjithashtu vepronin dhe si informatorë të komandantëve për veprimet e ushtrisë kundërshtare.

HIERARKIA E USHTRISË SË LIDHJES NË KËTË PERIUDHË ISHTE

• Kryekomandanti i Lidhjes, Gjergj Kastrioti, Skënderbeu.

• Komandant, të gjithë princat pjesëmarrës në Lidhje.

• Komandant grupesh, bajraktarët e fiseve pjesëmarrës në Lidhje.

• Komandantë popullorë, persona në zë për trimërinë e treguar në përpjekje por pa ndonjë post ose ofiq për nga rangu fisnor apo pasuror.

• Luftëtar

MBËSHTETJA MATERIALE DHE EKONOMIKE

Ushtria e rregullt mbahej dhe paguhej me taksat e popullsisë sipas territorit të influencës së princëve, nga plaçka që i grabitej ushtrisë turke dhe ndihma në ushqime e popullsisë ku zhvilloheshin luftime.

Përgatitja dhe kompletimi i ushtrisë me armatime bëhej e përqendruar duke paguar specialistë vendas dhe të huaj të punimit të hekurit, bronzit dhe drurit. Ka të dhëna të besueshme se specialistë të tillë kishte në Mirditë, Dibër, Mat, Krujë, Lezhë, Danjë, Berat dhe Durrës. Skënderbeu mori masa që të kishte dhe specialistë e huaj dhe të punonte armatime në mënyrë të përqendruar në Krujë.

Kalorësia kompletohej me kuaj nga vetë popullsia. Por ushtria kishte arritur të mbarështronte kuaj gjysnë të egër në tufa si në lagunat e Lezhës, Shëngjinit, Albulenës, Zallin e Drinit të Zi etj. Një pjesë e tyre sigurohej dhe nga grabitja e kollonave të okupatorëve dhe tregtarëve që kalonin në zonat ku i kontrollonte Lidhja.

Ushqimi baze ishin produktet e mishit dhe bukës. Për bukë përdorej më shumë elbi, thekri, meli dhe më pak misri dhe gruri. (sipas zonave dhe relievit gjeografik). Si pije përdorej vera e cila në atë kohë prodhohej dhe përdorej në shumë zona të Shqipërisë, falë kultivimit të vreshtave.

Uniforma e ushtrisë së rregullt ishte veshja tradicionale (kryesisht tirq dhe xhupe, xhamadan leshi, çorape leshi dhe opinga me lëkurë lope dhe kishte filluar të përdorej pëlhura e linit për të brendshme. Prijësit, për t'u dalluar përdornin dhe pelerinë leshi të bardhë me gajtan të zi, ose të ngjyrosur në kafe apo në raste të rralla me cohë të kuqe importi. Flamuri i Lidhjes ishte ai që përdorte Skënderbeu, flamur i kuq me shkabë 2 krenare, por princat anëtarë të Lidhjes përdornin secili flamurin e principatës së tyre.

Luftërarët popullorë vinin në luftë me veshjet e tyre të përditshëm dhe në përgjithësi ushqeheshin në zonat ku jetonin dhe zhvilloheshin luftime.

Rrugëkalimet në zonën ku u zhvillua Beteja e Torviollit ishin kryesisht:

Shkup-Dibër-Çidhën-Kala e Dodës-Prizren.

Prizren – Danje-Shkodër-Lezhë- Krujë.

Dibër – Klos – Krujë.


Këto rrugë ishin të kalueshme me kalorës dhe këmbësorë, por jo në të gjithë vitin.

(Vijon numrin e ardhshëm)

Me rastin e 80-vjetorit të lindjes së Shemsi Manjanit

Me punën e përpjekjet e tij, Shemsiu ka qenë i suksesshëm në jetë, duke u bërë i aftë për jetën dhe trashëgimtarët e tij, dhe me veprimtarinë se tij ka ndikuar pozitivisht jo vetëm te individë të veçantë, por në breza të tërë, për zhvillimin e gjithanshëm dhe afirmimin e tyre





Ajo ishte dhe mbetet njeriu që ndikoi pozitivisht më tepër se kushdo tjetër në jetën time shoqërore e familjare", - shkruan Shemsiu për Nevrezin në ditarin e tij.

Nevres Manjani në vitin 1958, mësuese e re në pedagogjiken e Peshkopisë.
Shemsi Manjani në vitin 1957, mësues i ri në pedagogjiken e Peshkopisë

Një jetë me vlera për shoqërinë

Nga **QAMIL SULA**

Studiuesi prof. dr. Shaban Sinani, në vlerësim të kuadrove të Dibrës, shkruan në gazetën " Rruga e Arbërit ", në maj 2012: " Cilido që ka lënë një gjurmë për një hap përpara në përparimin e Dibrës; ata që u luteshin dibranëve t'ia falnin qeverisë një djalë për në shkollë (si Selim Aliu); ata që i nxorën vajzat dibrane nga shtëpia dhe i çuan në aksione (si Sul Baholli e Hajri Hoxha); ata që luftonin për t'u hapur sa më shumë udhë të rinjve nga Dibra për në shkolla të larta (si Shemsi Manjani), meritojnë vlerësimin tonë".

Mesazhi është tepër i qartë për vlerësimin e Shemsi Manjanit, i cili më 7 korrik të këtij viti mbush 80 vite të jetës së tij. Me punën e përpjekjet e tij, Shemsiu ka qenë i suksesshëm në jetë, duke u bërë i aftë për jetën dhe trashëgimtarët e tij, dhe me veprimtarinë se tij ka ndikuar pozitivisht jo vetëm te individë të veçantë, por në breza të tërë, për zhvillimin e gjithanshëm dhe afirmimin e tyre në jetë.

E veçanta e Shemsi Manjanit nga të tjerët që përmend studiuesi, qëndron në atë se dhe ai vetë është "produkt" i kësaj skeme humane. Atij vetë, më 1946, kur tërë populli ishte ngritur në këmbë për të shëruar "plagët e luftës", i trokitën në derë për ta dërguar në Peshkopi, për të kryer shkollën unike të sapohapur. Fati e solli që pas saj të ndiqte shkollën pedagogjike, gjithashtu të sapohapur. Pas përfundimit të saj me rezultate të shkëlqyera, në vitet 1953-1957 kreu studimet e larta në Institutin e Lartë Pedagogjik; dega gjuhë-letërsi (Rusisht).

Menjëherë pas kryerjes së shkollës së lartë, filloi punën si mësues i gjuhës së huaj në shkollën pedagogjike të Peshkopisë, shkollë, në të cilën, pas një viti, pas përfundimit të shkollës së lartë në degën e Gjeografisë, erdhi për të dhënë mësim dhe njeriu i tij më i dashur, shoqja e jetës, Nevrezi. Ata të dy ishin çifti i parë i arsimtarëve dibranë me arsim të lartë.

Sipas ekspertëve, profesioni i mësuesit është i dyti për nga shkalla e vështirësisë, pas atij të kontrollit të trafikut ajror, prandaj dhe nga më të respektuarit kudo në botë. Qoftë vetëm duke u bërë mësues, Shemsiut iu dha mundësia t'ia shpërblente shoqërisë shumëfish atë që ajo i dha atij. Dhe ai, me punën plot pasion e përkushtim, me kërkesë të lartë ndaj vetes për cilësinë e mësimdhënies dhe ndaj nxënësve, jo vetëm që arrinte rezultate të larta, por u ngjallte nxënësve pasionin për gjuhën e huaj dhe për të thelluar në mënyrë të pavarur njohuritë për të. Dhe kaq do të mjaftonte për ta vlerësuar në mënyrë të veçantë atë.

Por, për Shemsi Manjanin do të kishte "sfida" të tjera me një rrezatim me spektër më të gjerë ne dobi të shoqërisë. Në vitin 1967, pasi kreu për disa vite detyrën e mësuesit e të drejtorit në shkollën Pedagogjike, e pas mbylljes së saj, një vit drejtor i shkollës 12-vjeçare të qytetit, iu ngarkua detyra e shefit të seksionit të arsimit e kulturës të rrethit të Dibrës.

I njihte vështirësitë që kishte përpara; Dibra, një nga rrethet më të mëdha të vendit, me një terren tepër të hapur e malor, me objekte shkollore tepër të dobëta, të ndërtuara me punë vullnetare apo nga kooperativat bujqësore, me mungesë të theksuar kuadri me arsimin përkatës etj. Shemsiu, me besimin te ndjenjat arsimdashëse të popullit dibran, te përkrahja dhe mobilizimi i masës së mësuesve, shumica e të cilëve kishin qenë ish-nxënës të tij, në shkollën pedagogjike, iu përvesh punës dhe shpejt u dukën rezultatet.

Me punën më të mirë të mësuesve dhe me hapjen e disa shkollave të reja u arrit që asnjë nxënës të mos mbetej pa e kryer shkollën tetëvjeçare. Arsimi parashkollor u shtri në tërë fshatrat e rrethit duke arritur numri i kopshteve në 212, ndërsa numri i shkollave të mesme me degë profesionale e të përgjithshme arriti në 22, duke u shtrirë në tërë zonat e rrethit e duke mundësuar shumëfishimin e të drejtave për studime të larta, duke hedhur bazat për sigurimin e specialistëve të lartë vendas, për çdo zonë e çdo fushë, në bazë të studimeve të kryera nga seksioni ynë.

Për të pasur kushte sa më optimale pune, nxënësit vendas u stabilizuan me punë në shkollat pranë familjeve të tyre. Edhe kualifikimi i tyre u vu mbi baza shkencore. Mësuesit u përfshinë në nismën për pasurimin e bazës materiale-mësimore si dhe në ngritjen e klasave-kabinete dhe shkollat u pajisën me laboratorë, biblioteka, terrene sportive etj. Si rezultat i kërkesës këmbëngulëse dhe të argumentuar, Ministria e Arsimit dhe Kulturës miratoi në vitin 1971 hapjen e filialeve të ILB-së së Tiranës dhe ILP-së së Shkodrës në qytetin e Peshkopisë, ku në këtë të fundit morën arsimin e lartë, pa shkëputje nga puna, qindra mësues dibranë.

Përmirësimi i ndjeshëm i ndihmës dhe kontrollit në bazë me moton "Të ndryshojmë gjendjen e jo vetëm të konstatojmë të metat dhe dobësitë", puna sistematike për përgjithësimin e përvojës së përparuar, sollën një hap cilësor në punën e mësuesve dhe në interesimin e organeve të pushtetit e atyre të ekonomisë në bazë për problemet e arsimit e të kulturës. Nxënësit dibranë, edhe nga zonat më të thella, ishin të suksesshëm në shkollat e mesme jashtë rrethit, madje edhe në ato të larta. Për të ilustruar këtë nivel cilësor të arritur, mjafton fakti që në vitin 1975, në Olimpiadën e Parë Kombëtare të Matematikës për shkollat e mesme, ekipi i gjimnazit të Peshkopisë zuri vendin e parë.

Ngritja, e veçanërisht vënia në funksionim nga mësuesit dhe punonjësit e kulturës të rrethit e objekteve social-kulturore në çdo fshat, si kopshteve, shtëpive e vatrave të kulturës, muzeumeve e bibliotekave, e ngritja pranë tyre të grupeve artistike etj., bënë jo vetëm që Dibra të vlerësohej me titullin e lartë " Hero i Punës Socialiste", por të bëhej flamurtare në këto drejtime për tërë vendin. Në bashkëpunim me qendrat e punës e të prodhimit u zgjidh problemi i bërjes së punës prodhuese e të stazhit në prodhim të nxënësve dhe me të ardhurat që siguroheshin u jepej drekë nxënësve në të gjitha shkollat e rrethit. Gjatë verës, me ndihmën e tyre, shkollat organizonin kampet verore të fëmijëve në vendet më piktoreske të rrethit, madje dhe larg vendbanimeve të tyre.

Karakteristikë e veçantë e Shemsiut ishte besimi te vartësit. Sektorët e arsimit, kulturës dhe fizkulturës, vetëvepronin, por ndihma dhe prania e tij kurrë nuk iu mungonte. Ai me kujdes të veçantë ndiqte punën kualifikuese të mësuesve, përgjithësimin e përvojës së përparuar në shkolla, plotësimin e kontingjenteve për shkollat e mesme e të larta, lëvizjet e kuadrove dhe plotësimin e kushteve të tyre. Veçanërisht në aktivitetet kulturore, artistike e fizkulturore-sportive (ku ai kish qenë i afirmuar deri në futbollist në kategorinë e parë, volejbollist dhe ping-pongist, që dhe tani në moshë të shtyrë, në gjendje të mirë shëndetësore, mori pjesë në aktivitetin ndërkombëtar për veteranët në ping-pong në Kosovë, Maqedoni dhe Shqipëri.

Shemsiu kujdesohej që në këto aktivitete të zbuloheshin talentet e reja, të cilët, jo rrallë tërhiqeshin pranë institucioneve në rreth, ose dërgoheshin në shkolla të mesme e të larta. Shumë prej tyre u shquan si artistë apo sportistë në shkallë ndërkombëtare.

Për realizimin me sukses të detyrave të ngarkuara, Shemsi Manjani është dekoruar me "Urdhrin e Punës". Si anëtar i Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit, Shemsiu me guxim kritikonte qëndrimet nënvleftësuese të disa drejtuesve të ekonomisë e pushtetit në bazë ndaj ndërtimeve shkollore, për trajnimin e mësuesve në zona të ndryshme etj. dhe kundërshtonte ndonjë urdhër të Komitetit të Partisë për të hequr nxënësit nga mësimi për fushata bujqësore, duke dëmtuar realizimin e programit, ndonjë ndërhyrje në kompetencat e seksionit për kuadrin etj. Kjo ngjallte reaksionin e dashakeqësve të cilët, në një kohë kur arsimi dhe kultura në Dibër kish arritur nivelet më të avancuara dhe në shkallë vendi për atë kohë duke shfrytëzuar ardhjen e një sekretari të Parë të ri në rreth, meqenëse shumë objekte shkollore ishin në gjendje të keqe (për faj të atyre e jo të seksionit), u mohua gjithçka e arritur dhe "fajtori", shefi i seksionit të Arsim-Kulturës, Shemsi Manjani, pas 9 vitesh në këtë detyrë (1967-1976) u degdis mësues në fshat. Ky vendim i padrejtë nuk e dekurajoi Shemsiun. Edhe si mësues fshati punoi me përkushtim dhe pas 4 vitesh po ai komitet partie e emëroi kryeredaktor të organit të tij, të gazetës "Ushtima e Maleve". Këtë gazetë ai e drejtoi me kompetencë për 4 vjet duke shkruar dhe vetë njëlloj si gazetarët e tjerë. Gjatë kësaj periudhe, gazeta pasqyroi me vërtetësi jetën e rrethit me tërë aspektet e saj, duke evidentuar arritjet, por edhe duke kritikuar me guxim dhe të metat; zgjeroi tematikën, duke tërhequr me bashkëpunimin e tyre specialist nga rrethi e nga institucionet qendrore, në të u lihej hapësirë krijuesve të rinj, që më vonë u afirmuan në fushat e krijimtarisë letrare, të gazetarisë etj.

Vitet e fundit, deri sa doli në pension në vitin 1987, dha me sukses gjuhën e huaj dhe filozofinë në shkollën e mesme bujqësore të Peshkopisë.

Tani, ndonëse prej shumë vitesh banon familjarisht në Tiranë, në të gjitha aktivitetet që organizohen për Dibrën e dibranët, ai kontribuon me mendimet e tij me vlerë. Madje ai ndjek edhe shumë aktivitete që organizohen në Dibër, siç edhe vazhdon të shkruajë në dy gazetat e Dibrës.

Kontributi në jetë, veçanërisht në zhvillimin e arsimit në Dibër nuk ndahet nga ndihma që i ka dhënë Shemsi Manjanit bashkëshortja e tij, Nevrez Manjani, e cila ndërroi jetë shumë para kohe, në moshën 54 vjecare. "...Ajo na la të pikëlluar, por me krenari për tiparet dhe virtytet e saj, që rrallë mund të bashkohen në një qenie...

Veçanërisht unë, që kalova jetën me të, që lidhëm e rritëm fëmijë, do ta kujtoj gjithmonë. Nuk do të më harrohen kurrë vitet e punës së përbashkët në shkollën pedagogjike të rrethuara nga dashuria e nxënësve dhe prindërve të tyre...

Ajo ishte dhe mbetet njeriu që ndikoi pozitivisht më tepër se kushdo tjetër në jetën time shoqërore e familjare", - shkruan Shemsiu për Nevrezin në ditarin e tij.

Mësuese Nevrezi e pasionuar pas profesionit, në të gjitha shkollat ku punoi e drejtoi u shqua jo vetëm për përkushtim e përkujdesjen plot ngrohtësi ndaj nxënësve, respektimin e personalitetit të tyre e lidhjet me prindërit, marrëdhëniet shembullore me kolegët, për korrektësinë në kryerjen e detyrave të ngarkuara, por edhe për rezultate të larta në procesin mësimor e edukativ.

Ja se si e përshkruan Xhafer Martini, ish-nxënësi i saj, dhe më vonë koleg i saj: " Për mua ajo mbetet përfaqësuesja më e mirë e botës femërore në atë kohë dhe më vonë... E donte profesionin e mësuesisë dhe jepte maksimumin për të formuar nxënësit nga ana shkencore... Jepte mësim me kaq lehtësi, me kaq bukuri e thjeshtësi sa thoshe se kishte një jetë të tërë në këtë profesion, kur ajo sapo kish filluar punën".

Për merita e rezultate në punë u dekorua gjatë viteve me medaljen "Naim Frashëri" dhe me urdhrat " Naim Frashëri " të Klasit III, II dhe I. Për aktivizimin në organizatën e Gruas, që kur erdhi në Peshkopi si nuse e re, u dekorua me urdhrin "Për shërbime të shquara shoqërore e shtetërore". Por, ndonëse ajo ka mbi 20 vite që është ndarë nga jeta, Nevrezi me veprën e saj rron në zemrat tona e në mendjet e ish-nxënësve, ish-kolegëve dhe të gjithë atyre që e kanë njohur.

Gazetari Abdurrahim Ashiku, në gazetën " Zëri i popullit ", 11 ditë pas vdekjes së saj, ndër të tjera do të shkruante: "... Duke udhëtuar kokulur drejt varrezave, të gjithë meditojnë për Nevrez Manjanin, për këtë pishtar të arsimit tonë, pishtar, që ndonëse fizikisht u shua, përsëri është flakë, jep dritë. Dibra nuk e harron. E ka bijë të saj Nevrez Manjanin, e mban në krye të vendit". Dhe me të vërtetë, duke shprehur respektin e tërë qytetarëve të Peshkopisë, për kontributin e dhënë gjatë gjithë jetës në arsim dhe për virtytet e larta qytetare, Këshilli Bashkiak i Qytetit, më 25 shtator 2005, e shpalli (pas vdekjes) të paktën në Dibër, " Qytetare Nderi të Peshkopisë ".

Duke mbyllur këto rreshta, pa menduar se kemi thënë gjithçka për kontributin e Shemsi Manjanit në zhvillimin e arsimit, kulturës e sportit në Dibër, i urojmë Profesorit dhe kolegut tonë të nderuar jetë të gjatë e të lumtur, duke besuar se në këtë urim me ne bashkohen jo vetëm ish-nxënësit dhe ish-bashkëpunëtorët e tij, por tërë populli dibran, i cili di të vlerësojë bijtë e tij, që e meritojnë këtë vlerësim.

**** Ish-Kryeinspektor i Arsimit, Dibër***

Rruga e Arbërit nr. 98

besim

Disa të dhëna historike për teqenë bektashiane, Bllacë

Teqja bektashiane Bllacë, vatër e patriotizmit dhe atdhedashurisë

(Vijon nga numri i kaluar)

Në këtë Teqe shërbente një Dervish tjetër i Baba Jesharit, Rushit Tollja nga fshati Strikçan i Malit të Grykës së Madhe. Ky që në fillim ishte njeri shumë i përkushtuar për shërbimet e teqesë Bllacë. Dervish Rushiti erdhi në këtë Teqe mbas kalimit nga jeta të Baba Jesharit në Martanesh.

Një herë Baba Sufa i II e kishte dërguar Dervish Rushitin në fshatin Gotvi për të marrë pëlqimin (miratimin) e fisit Pucaj që të pajtoheshin me fisin Jangulli. Dervishi vajti tek fisi i Pucajve dhe u tha: se e kishte çuar baba Sufa me u marrë miratimin që të pajtoheshin me Jngullinjtë. Megjithëse Pucajt ishin zahir ia dhanë menjëherë fjalën meqë ishte porosia e Baba Sufës. Dervish Rushiti i uruoi dhe i bekoi edhe u nis për te Jangullinjt për t'u marrë edhe këtyre miratimin, megjithëse këta ishin edhe bektashinj. Dervish Rushiti shkoi me dy veta, pikërisht me atë që ishte edhe tek Pucajt me Hajdar Sulën dhe me Ali Hankun nga fshati Zerqan. Ata e gjetën Ali Jangullin të shtrirë në krevat dhe ky nuk lëvizi nga vendi kur ata hyinë në shtëpi. Dervish Rushiti e hapi menjëherë bisedën:

- Ne jemi të dërguar nga Baba Sufa i Teqes Bllacë që të na lësh në dorë gjakun me Pucallarët, se ata si zahira që janë na e lanë në dorë, kurse ti si bektashi që je, besojmë se do të na e lësh.

Unë, tha Aliu, nuk ia lë në dorë Baba Sufës, se unë jam i hidër Babës në Kuçovë.

- Dervishi kur dëgjoi këto fjalë të Aliut dhe meqenëse ai nuk lëvizi edhe nga krevati, u zemërua shumë, u ngrit doli nga dera e dhomës dhe duke hapur krahët tha: "Përse or Ali kështu? Ne që nuk jemi të Hidër Babës, mos jemi gjë dobiçë, vetëm ti je i mirë. Në këtë moment nisi një tërmet, sa që gati rrafshoi shtëpitë e Jangullinjt. Me të shpejtë u ngrit nga vendi Ali Hanku, kapi Dervishin përdore dhe i thirri:

- Ulu bre se na fike e na lë fëmijët rrugëve... se çdo gjë do të rregullohet. Kur e pa këtë veprim Ali Jangulli, u ngrit shpejt nga krevati, iu lut Dervishit duke i thënë, aman në dorën tuaj jam. Bëni si të doni, vetëm mos më bëni ndonjë zullum (dëm) se me të vërtetë edhe ti qenke Hidër Baba.

Teqja filloi të luajë një rol të madh në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Ishte koha kur ndërgjegja kombëtare ishte rritur shumë. Kërkesat e rilindasve për autonomi, për çlirim kombëtare e shoqëror dhe për mësimin e përdorimin e gjuhës amtare shqipe kisthe arritur kulmin. Edhe në teqe këtë periudhë erdhën abetaret e para dhe librat e shkruar në gjuhën shqipe. Këto i sillnin Seit Najdeni (Hoxhë Voka), Dervish Jahja, mehypë e besimtarë që ishin në emigracion në Stamboll e në vende të tjera ku ishin ngritur shoqëritë kulturore jashtë atdheut, dhe këto njerëz kishin marrë në dorë e ishin bërë mehypë në teqet bektashiane andej.

Baba Sufa i II pati suksese në veprimtarinë e tij fetare, ai fitoi popullaritet të madh në të gjitha fushat e jetës shoqërore por ai ndërroi jetë aksidentalisht. Ai u vra nga një trung lisi, i cili e zuri përposhtë kur disa druvarë po prisnin dru për teqen. Thuhet se kjo ka ndodhur në muajin prill të viti 1915. Dervish Rushit Tollja që shërbente pranë kësaj Teqeje nuk u ndodh në teqe prezent, kur ndodhi aksidenti.Dëmtimi trupor qe i rëndë dhe Baba Sufa ndërroi jetë. Baba Sufa i dytë u varros në Tyrbe pranë Baba Sufës së parë.

Që nga kjo kohë në krye të Teqes Bllacë u vu Dervish Rushit Tollja dhe ky u thirr e dekretua baba Rushit. Baba Rushiti punoi shumë mirë. Ngritën teqen në dy kate, shtoi bagëtinë. Shkoi në fshatin Zogje u kërkoi fshatarëve të këtij fshati ujin ë dilte në Malin Zogje për nevojat e Teqesë. Kishte shumë pak ujë. Baba Rushiti organizoi punën, hapi kanalin, e shtroi atë me lugje druri dhe brenda një kohe të shkurtër solli ujin në Teqe.

Baba Rushiti mori në Teqe edhe motrën e tij Rabijen. Këtu shërbente pastor, punonte shumë dhe ka shërbyer gjatë në këtë teqe, deri në kohët e vona kur në teqe drejtonte Baba Xhemali. Hajria ishte pak e ashpër në kërkesën e llogarisë gjithmonë për mbarëvajtjen e punës në teqe. Ajo ishte e përkushtuar për punë. Vetë Hajria punonte bulmetin dhe ishte një administratore shumë e zonja. Çdo gjë kalonte nëpër duart e saj në Teqe.

Rabija, e motra e Baba Rushitit, ishte grua e urtë, shumë besimtare dhe e ndërgjegjshme. Këto shkonin shumë mirë me njëra-tjetrën. Hajria ishte plakë dervishe dhe siç urdhëronte ajo bëhej përbrenda në Teqe për problemet e kuzhinës. Ajo së bashku me Rabijen hartonte menutë e ushqimit, përgatisnin darka e dreka dhe administronin të gjitha sendet ushqimore.

Në teqe më vonë shërbente edhe një vajzë nga fshati Lenë i Martaneshit. Kjo isthe bijë në fisin Rushaj.

Kur Hajria u sëmur dhe në teqe nuk kishte kush t'i shërbente, Baba Xhemali që drejtonte Teqen e dërgoi në fshatin Sopot tek Ramadan Gjikolin për t'i bërë shërbim më të mirë. Të gjitha shpenzimet i paguante Teqja e Bllacës. Kur Hajria vdiq, ajo u varros me shpenzimet e Teqesë. Teqja e Bllacës dhe populli i krahinës së Grykës së Madhe bënë llokëm të madhe për të. Nga duart e saj kishin ngrënë e pirë disa herë në Teqen e Bllacës.

Pas datës 3 nëntor 1924, Baba Rushiti ngeli Baba për dy Teqet, për Martaneshin dhe për Bllacën. Sigurisht kjo isthe një ngarkesë e madhe dhe për vetë largësinë e terrenin e thyer, megjithë përpjekjet e baba Rushitit puna do të çalonte dhe diku do të ngelej diçka më mangut.

Në një rast Baba Rushiti isthe për darkë ke Selman Brata në Zerqan. Gjatë bisedës babai i thotë: - Ti ke dy vajza dhe shpesh më ke kërkuar të kesh një djalë dhe ky djalë do të vijë në jetë, emrin do ta ketë .... Me të vërtetë Selman Brata në krye të nëntë muajve u bë me djalë në ....

Baba Rushiti gëzonte dashuri dhe respekt të madh në masën e popullit, në krye shërbesa të mëdha fetare dhe kishte shpirt të gjerë, të pastër, korrekt, i përkushtuar për punët në Teqe dhe solli ngritje ekonomike e ndryme të mëdha në teqen bektashiane në Bllacë.Pas një periudhe kohe në Teqen Bllacë erdhi Baba Sejdiu dhe Baba Rushiti ngeli Baba i teqesë së Martaneshit. Baba Sejdiu shërbeu Baba në Teqen Bllacë nga viti 1927 deri në vitin 1930. Edhe ky punoi e luftoi me gjithë forcat mendore e fizike për mbarëvajtjen e punës në Teqe.

Në vitin 1930 në Teqe erdhi Baba Zeneli nga krahina e Gjirokastrës. Në dekretin (ixhazetin për Baba e mori nga Kryegjyshi Sali Njazi Dede dhe e caktoi të shërbejë në Teqen Bllacë. Baba Zeneli ndërtoi faqen mbi themelet e teqes që kishte ndërtuar Baba Sufa i dytë. Ky jo vetëm ndërtoi por edhe e zbukuroi. Ai luftonte me të gjitha forcat për të shtuar pasurinë e teqes Bllacë. Rezultatet qenë të ndjeshme. Teqja në ... e tij kishte më shumë se 100 kokë bagëti të imta, kishte një penë qe, pyje e disa hektarë tokë. Bashkëkohësit e tij flasin se Baba Zeneli ishte punëtor i madh dhe kursimtar. Ai punonte vetë me qetë duke thyer dhe mbjellë tokën. Ai punonte në kositje dhe prashitjen e bimëve. Kush shkonte në teqen Bllacë dhe qëndronte më shumë se njëzet e katër orë i bënte thirrje të shkonin të punonin së bashku punë të ndryshme. Në biseda të ndryshme e të lira shpesh herë përdorte fjalën se njëzetekatër orë je mik.

Ky ishte organizator i mirë në të gjithë fushat, marrëdhëniet me popullin e krahinave të Grykës së Vogël dhe të Grykës së Madhe i kishte shumë të mira. Me personelin e teqes kishte të shkuar të mirë. Ai ishte kërkues i vetvetes dhe ndaj të tjerëve.Tokën e punonin dy punëtorë që paguheshin nga teqja, por duhet theksuar se i gjithë personeli i teqesë, që nga Baba Zeneli e të tjerë dhe ata njerëz që shkonin në teqe e ndihmonin në fushatat bujqësore si në periudhën e prashitjes së misrit, të korrjes së barit, të grumbullimit e të vënies mullar të barit dhe në kohën e prerjes së dushkut për bagëti. Bagëtitë i mbanin dimër-behar në stallat e Teqesë dhe i ushqenin me dushk e me bar të bollshëm. Delet në disa raste i dërgonin në stane, disa nga bahëtitë e imta në periudhën e dimrit i shpërndanin për t'i dimëruar (nxjerrë për dimër) nëpër besimtarë e simpatizantë të teqesë, kryesisht në Grykë të Madhe. Kjo bëhej me dëshirën e atyre që i merrnin në muajin nëntor (shëmitër) dhe i kthenin në Teqe në muajin maj, për Shëngjergj.

Në teqe ishte edhe Dervish Elmaz Tollja nga fshati Strikçan. Këtij iu dha një besim i madh, nisur nga prejardhja e tij si afërt i Baba Rushitit, atij i bëheshin nderime të mëdha nga besimtarët. Kohët treguan se ai nuk e justifikoi besimin që iu dha. Dervish Elmazi e tradhtoi vijën e Haxhi bektash Velisë, atë e zhveshën si të padëshiruar për Dervish dhe përfundimisht u largua i turpëruar nga teqja e Bllacës.

Baba Zeneli mbështetej kryesisht në fisin Tasha në Bllacë. Fisi Tasha ishte i dëgjuar për besnikëri ndaj fesë bektashiane. Kishte mjaft muhibe, kishte nxjerrë baballarë dhe dervishë, prej të cilëve janë Baba Sufa i Parë, mydelil dhe Baba Sufa i dytë myxheret. Në teqe ishte nënë Hajria, dervishe. Nga i njëjti fshat dhe fis ishte edhe dervish Isuf Tasha që u dënua dhe mbasi u lirua nga burgu ndërroi jetë në kohën e monizmit.

Në Teqen Bllacë nëpërmjet Bilal Halilit nga fshati Homesh erdhi edhe ... jetimi Ahmet Miftar Dede nga fshati Brataj i Vlorës. Ky u bë muhyp i Baba Zenelit dhe byrazer gjaku me Bilal Halilin. Ahmet Miftar Dedeja u bë djali i Baba Zenelit dhe i nënë Hajries. Ky shkoi me banim pranë Teqes bektashiane në Kryegjyshatën bektashiane botërore në Tiranë. Ishte njeri shumë i përkushtuar për punën, për mbarëvjajtjen e të gjitha problemeve të fesë bektashiane në Teqe. Gëzonte dashuri e respekt kudo që shkonte nëpër besimtarë.

Në një rast Dervish Ahmeti i propozon Baba Zenelit që t'i jepte leje për të shkuar në lokalitetin e Kuçit, në Kote, në Drashovicë e në fshatra të tjrë të Vlorës për të kërkuar e mbledhur bagëti për llogari të Teqesë së Bllacës. Baba Zeneli pranoi propozimin e Dervish Ahmetit. Ky shkoi atje doli në Tatzot e më pas në Ripas se aty ishte mekami i Dervish Bajramit dhe çirakun e ndizte njëri nga fshati. Kur e panë fshatarët e asaj ane Dervishin e ri, jetimin, djalin e tyre, Ahmet Miftar Dedenë, u magjepsën dhe kërkuan me çdo kusht ta mbanin aty në fshat. Ata i premtuan, Dervish Ahmetit, se bagëtitë e mbledhura për llogari të teqes Bllacë do t'i dërgonin në fshatin Bllacë me tre fshatarë nga krahina e Vlorës. Porsa arritën fshatarët vlonjatë me bagëtitë në Teqen Bllacë i pyetën, ku ishte Hajria e bregosur, u tha atyre: "Në plënca (bagëti) kemi sa të duash, por neve duam djalin tonë. Fshatarët vlonjat u përgjigjen; - kjo ishte detyra jonë, mbetshi me shëndet dhe ata u larguan. Baba Zeneli dhe dy plakat, Hajria e Rabia, u indinjuan aq shumë sa ata harruan t'i mbanin edhe për drekë fshatarët vlonjat.

Për Baba Zenelin një bashkëkohës kujton, ai ishte shenjtor edhe kishte pirë hyjnor. Ai shpjegonte se babai ishte njeri merakli për tokën e mbjellë, livadhet he bujqësinë në kompleks. Ai nuk duronte dëme në livadhet dhe në të mbjellat e teqes. Kur ndonjë bashkëfshatar Bllacas bënte dëme me bagëti ai revoltohej, nuk mallkonte fshatarët se ishte njeri i matur, por mallkonte shpesh herë duke u shprehur: "E mbuloftë uji këtë vend"! Edhe me të vërtetë ai vend së bashku me livadhet e teqesë u kthye në liqen dhe u ndërtua rezervuari i Bllacës, pra për disa vjet rresht e mbuloi uji.

Mbasi ndërroi jetë Zeneli në vitin 1946, në teqen Bllacë u caktua nga baba Xhaferi Baba Avdullai nga Kruja. Pas Baba Avdullait shërbeu Baba Muharremi me origjinë nga Kosova i veshur dervish në teqen e Fushë Krujës, i cili erdhi nga Kryegjyshata Tiranë. Baba Avdullai iu përkushtua punës dhe shërbimeve fetare. Ai ndërtoi marrëdhënie shumë të mira me popullin dhe tërhoqi mbas vetes shumë besimtarë, ndërsa Baba Muharremi ra në pus dhe e nxorrën plakat e teqesë, ky pak në dorë ishte vrarë. Këshilli i teqesë Bllacë i dërguan telegram Dede Ahmetit i cili ishte vënë në postin e kryegjyshit në kryegjyshatë në Tiranë dhe ai e hoqi nga posti Baba Muharremin dhe e ktheu përsëri në kryegjyshatë.

Si rregull thuhet: - Se baballarët kudo që shkojnë në çdo teqe e kanë shtëpinë e tyre. Ata duhet t'i vihen punës jo vetëm për shërbesat fetare por për të ngritur në një nivel sa më të lartë ekonominë në teqe e të tërheqin sa më shumë ndihmën e besimtarëve dhe të simpatizantëve të fesë.

Duhet të kemi parasysh se këto Baballarë jetuan e punuan në teqen Bllacë në vite të vështira ku nga partia në pushtet bëhej propagandë e madhe kundër fesë islame e në veçanti kundër Teqeve bektashiane. Nga ana ekonomike, teqeja detyrohej krahas përballimeve të shpenzimeve për të përballuar jetesën, duhej të paguante detyrimet ndaj shtetit për pronësinë e tokës.

Mbas transferimit të Baba Muharremit, sollën në teqen Bllacë Baba Xhemal Selcën. Ky përpiqej të ruante ekonominë që ishte e ngritur. Ishte njeri i urtë, i dashur. Interesohej për shërbesat fetare, por ekonomia e teqesë filloi të bjerë, numri i bagëtive ishte pakësuar. Teqja paguante detyrime, plane mishi, lesh, vezë, bereqet, fasule dhe tatim në të holla.

Baba Xhemali në vitin 1953 veshi Dervish Isuf Seit Tashën nga fisi Tashajve në fshatin Bllacë për të cilin folën edhe më sipër. Në këtë kohë tokën e teqesë që isht epronë e saj në fshatin Gjoricë e kishte marrë reforma agrare, por me ngritjen e kooperativës bujqësore në vitin 1956, toka i kaloi kooperativës bujqësore Gjorica. Në sajë të luftës propagandistike që i bëhej fesë nga partia e punës Shqipërisë njerëzit kishin filluar të largoheshin, numri i besimtarëve dhe muhypëve ishte pakësuar, nuk ndihmonin teqenë në punët e bujqësisë dhe nuk kishte interesime për problemet fetare.

Mbas transferimit të Baba Xhemal Selcës, në Teqenë Bllacë erdhi baba Muharrem Toska dhe pas tij Baba Bilali, që të dy këto filluan punën me të gjitha forcat por ekonmoia dhe autoriteti i teqesë çdo ditë e më tej po tregonte ulje. Numri i bagëtive kishte rënë dhe toka nuk punohej si duhej e pak prodhime merreshin.Mbas Baba Bilalit, në teqen Bllacë me urdhër nga Kryegjyshata u caktua Baba Xhemal Dinollari. Ky ishte njeri i urtë, i sjellshëm dhe i dashur me popullin. Përpiqej të afrohej sa më shumë me shtresat e masat e popullit.Moshat e reja nuk shkonin në teqe dhe as e pranonin të bëheshin muhype. Ekonmia çdo ditë e më tej shënonte rënie. Detyrimet ishin të mëdha. Më tepër për fushatat e bujqësisë teqenë e ndihmonin populli i Malit të Grykës së Madhe. Në këtë periudhë në Teqe shërbente Baba Xhemali, Dervish Isuf Tasha i cili jetën e tij e kishte lidhur me teqenë, dy plakat dhe Lim Hysa nga Fshati Peladhi (Myslim Hasa). Teqesë i ndalohej të mbante punëtor me meditje se quhej shfrytëzim i njeriut prej njeriut.

Baba Xhemal Dinollari dhe Dervish Sufa qëndruar deri në vitin 1967, kur si kudo në shqipëri, teqet u shkatërruan. Ndërtesat dhe tokat i kaluan pronë e kooperativës bujqësore. Baba Xhemali u largua nga Dibra për në vendlindje, ndërsa Dervish Sufa ngeli në fshatin e tij në Bllacë. Ai ishte i pafuqishëm për të punuar punë krahu, ishte i sëmurë dhe vuante nga ulcera në stomak, në dueden. Dervish Sufa pinte duhanin, ai nuk kishte mjete financiare për të përballuar vështirësitë e jetës, punonte djepa për fëmijë e i shiste ata. I detyruar nga kusthet ekonomike, Dervish Sufa filloi të reagonte kundër masave që kishte marrë partia e punës në drejtim të fesë dhe për kushtet e vështira ekonomike që po kalonte vendi.

Për këtë në vitin 1978, ai u arrestua dhe u dënua me 10 vjet heqje lirie për agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor. Mbasi doli nga burgu, jetoi disa vjet dhe ndërroi jetë. Jeta e tij para dhe pas arrestimit ishte me vërtetë një izolim i plotë. Atij kudo që shkonte i bëhej luftë klasore se kishte një vëlla të vrarë nga partizanët gjatë luftës dhe e demaskonin si fetar, Dervish. Njerëz të afërt të tij me kushte të mira ekonomike nuk kishte që ta mbanin dhe të krijonin kushte për jetesë. Krahas Babait që drejtonte i gjithë veprimtarinë fetare dhe ekonomike në teqe funksiononte dhe këshilli i teqesë.Këshilli i Teqesë përbëhej prej më shumë se 5-7 e më shumë anëtarë. Këto zgjidheshin nga muhype të mençur e që kishin eksperiencë për drejtim ekonomie në familjet e tyre, mund të ndihmonin me mendime për mbarëvajtjen e punës fetare dhe mbarëvajtjen e ekonomisë së teqesë. Këto vetë duhet të ishin të vendosur e të përkushtuar për problemet fetare.

Gjatë kohës kam njohur anëtarë të këshillit të teqesë Bllacë Adem Xhepën nga fshati Cerenec, Sadik Tashën nga fshati Bllacë, Bilal Halilin nga fshati Homesh, Riza Hankun e Islam Sulën nga fshati Zerqan e të tjerë. Në periudha të ndryshme këto janë zgjedhur e janë zëvendësuar me të tjerë. Gjithmonë në krye të këshillit të teqesë ishte babai i teqes. Këshilli i teqesë mblidhej sa herë që Babai e shikonte të nevojshme për dy tri herë në vit duhej të mblidhej! Këshilli analizonte probleme ekonomike të rëndësishme për teqenë, ndërtime të reja, vepra me rëndësi si ujësjellës. Në këshill babai herë pas here jepte llogari për problemet ekonomike e financiare. Në këshill analizoheshin probleme të figurës së punonjësve të teqesë, cënimit të marrëdhënieve me popullin, në qoftë kishte raste të prishjes së figurës morale, thashëetheme e konflikte si dhe shtimin e radhëve të besimtarëve të muhypëve të teqesë e tjera.

Pas viteve 1990, me vendosjen e demokracisë e lënien e lirë të ushtrimit të fesë edhe përfaqësuesit e sektit fetar bektashian në Bllacë reaguan pozitivisht në drejtim të fesë. Në kërkesën dhe me ndihmat e popullit të Grykës së Madhe dhe Grykës Vogël u ngrit Teqeja e Bllacës në themelet e teqesë së vjetër. Filluan të vijnë besimtarë nga të gjitha moshat e burrave, grave dhe të rinjve e të rejave. Thuhet se ndihmoi për përhapjen e saj pas ardhjes së demokracisë dhe Baba Selim Kaliçani.

Fillimisht këtu shërbeu Dervish Seit Zogu nga Valikardha, pas tij Dervish Sefedin Gjoka dhe në vitin 1998 erdhi Baba Ismail Jangulli nga fshati Gotvi i cili u dekretua nga Kryegjyshata Tiranë. Ka qenë i persekutuar nga regjimi komunist dhe për propagandë kundër pushtetit popullor kryesisht me karakter fetar është dënuar me 10 vjet heqje lirie. Mbasi vuajti 5 vjet nisur nga origjina e varfër dhe e pastër në të kaluarën u lirua nga burgu me kusht. Ky i është përkushtuar punës në teqe. Ka ndërtuar teqe. Ka ndërtuar teqenë e re, ka ngritur nivelin ekonomik të teqesë dhe kjo duket në shtimin e numrit të kokëve të bagëtive. Ka marrëdhënie të mira me popullin e besimtarët në krahinën e Grykës së Vogël dhe të Grykës së Madhe. Ka shtuar numrin e muhypëve. Në teqe ka tërhequr të rinjtë e të rejat. Populli ka besim te Baba Ismaili. Ka veshur Dervish Shefki Tashën, Xhafer Dedën në Sofraçan, Selim Jangullin në Gotvi dhe Hysen Dukën në fshatin Sopot. Ai është shumë i përkushtuar për të ngritur më tej bazën ekonomike të teqesë dhe shërbesat fetare.

TË TJERË PËR TEQEN BEKTASHIANE BLLACË

Në krahinën e Grykës së Vogël dhe Frykës së Madhe dhe kryesisht në teqen Bektashiane të Bllacës erdhën për të parën herë abetaria dhe libra të tjera të shkuara në gjuhën shqipe e të shypura në shoqëritë kulturore të krijuara në mërgim nga shqiptarët, në Stamboll dhe në Sofje të Bullharisë. Ata i sillnin në qytetin e Dibrës së Madhe, në Bllacë direkt të adresuara për në Teqe. Kjo literaturë që vazhdonte të vinte ilegalisht nga gjysma e shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX shpërndahej nëpër besimtarë bektashinj në fshatrat e Grykës së Vogël e Grykës së Madhe dhe me fshatra të tjerë përreth.

Ky aktivitet i madh kultural kishte qëllim për të zgjuar ndërgjegjen kombëtare, për të ngritur në këmbë shqiptare, për të fituar të drejtat e tyre, autonominë, pavarësinë kombëtare dhe për të mësuar shkrim e këndim në gjuhën e tyre amtare. Kombi shqiptar të kishte gjuhën e tij të shkruar dhe në administratë, të futej gjuha shqipe e të kishte nëpunësit e tij. Në këtë drejtim përveç Seit Najdenit (Hoxhë Vokës), rol të madh ka mbajtur Hasan Muglica (Hoxhë Muglica) nga fshati Okshtun, Dervish Hima e të tjerë. Këto sillnin libra në gjuhën shqipe jo vetëm në Bllacë, në Grykë të Madhe, pranë sheh Sulejmanit në Zerqan por edhe në fshatra të tjerë të Gollobordës e të Dibrës.

Teqja Bllacë në këtë periudhë vazhdonte të ishte si gjithmonë një qendër në rëndësi patriotike dhe luante rol të rëndësishëm në interes të atdheut dhe të kombit shqiptar. Këtu mblidheshin shumë njerëz, zhvilloheshin biseda me karakter historik, flitej për të kaluarën e lavdishme të popullit shqiptar, këndoheshin këngë trimërie e patriotike, recitoheshin vjersha të shkruara në gjuhën shqipe në mërgim, si Hatikaja e shkruar nga Naim Frashëri në gjuhën shqipe, lufta e Qebelesa, Bagëti e Bujqësi e të tjera. Lulet e verës, fletore bektashiane etj.

Në teqenë Bllacë erdhi e qëndroi për disa ditë edhe Abdyl Frashëri i cili ishte ideaotir e ideologu i Lidhjes Kombëtare Shqiptare të Prizrenit, atë e shoqëronte Myfyt Shehu. Abdyli bisedonte me besimtarët dhe me popullin, u zbërthente atyre programin e Lidhjes Kombëtare Shqitpare të Prizrenit. Abdyli shkoi edhe në shtëpinë e patriotit Hysen Skara në Bllacë. Ai mori takim me Ram Osmanin, Hysen Tashën, Jeshar Zenelin, Osman Xhekën, Seit Tashën, Rexhep Krosin, Selman Jellën nga fshati Bllacë dhe me Rrahman Lekën e Shahin Metën nga fshati Kovoshicë. Solli disa libra në Teqe dhe qëndroi disa ditë. Atë ditë u kthyen në ditë shkolle për mësimin e shkrimit dhe këndim në gjuhën shqipe. Abdyl Frashëri vinte nga një rreth familjar, besnik dhe ideator të fesë bektashiane, populli i afrohej jo vetëm i shtyrë nga ndjenjat fetare por edhe atë kombëtare e shqiptare. Fshatarët e Bllacës ishin trima, punëtorë të mirë, të afrueshëm dhe me ide përparimtare. Një ndikim të madh patriotik e atdhetar ka luajtur edhe Jeshar Zeneli nga fshati Bllacë. Ky ishte myhip i teqesë dhe anëtar i "Klubit Bashkimi". Jeshari hapi të parën shkollë shqipe në Bllacë me librat që vinin me librat që vinin nga shoqëritë kulturore në mërgim. Për këtë jo vetëm që kujtohet e përmendet nga bashkëkohësit por shkroi edhe gazeta "Dielli" më datë 18 janar 1912. Jeshar Zeneli ka luftuar kundër okupatorëve osmanë, Serbë, fashistëve italianë e nazistëve gjermanë. Ky ka një aktivitet të pasur atdhetar e patriotik.

Gazeta "Rilindja Demokratike" datë 18 mars 1994 shkruan ndër të tjera gazetarja franceze Nathalia Klayer ka botuar një libër, "Shqipëria vendi i dervishëve". Ky libër flet për përhapjen e fesë islame e sektit Bektashian në Shqipëri. Përmenden kryesisht disa rrethe të Shqipërisë së mesme dhe të jugut. Dibra nuk përmendet si rreth, por vetëm teqja Bllacë.

Studimin kjo gazetare e shtrin në një periudhë rreth 55 vjeçare, nga viti 1912 deri në vitin 1967. E ndarë në katër periudha. Periudha e parë nga viti 1912 deri në vitin 1916.

Periudha e dytë nga viti 1916 deri në vitin 1939.

Periudha e tretë nga viti 1939 deri në vitin 1945.

Periudha e katërt nga viti 1945 deri ën vitin 1967, kur në shqipëri u morën masa kundër fesë dhe u dhunuan objektet fetare e u prishën teqetë.

Teqja bektashiane, shënon gazetaria, Natalia Klayer, krye këto veprime të mira:

1. Këshillime; 2. Shërime; 3. Ndihma; 4. Edukim.

Ajo shkruan se sekti bektashian ka luajtur një rol të madh në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare për çlirim kombëtar e shoqëror, për mësimin e gjuhës shqipe, për arsim, kulturë dhe për futjen e ndjenjës kombëtare tek shqiptarët. Në këtë libër jepen hollësira për teqen Bllacë, për aktivitetin e saj edukativ, atdhetar e patriotik në Grykë të Vogël e në Grykë të Madhe.

Për të hartuar këtë material gazetarja ka marrë takim me Osman Xhekën nga fshati Gjoricë e Poshtme, babain e Dalip Xhekës. Në materialin e përgatitur nga ajo shënohet se në teqenë Bllacë vinin libra në gjuhën shqipe dhe teqja Bllacë ka luajtur rol të madh në mësimin e shkrimin e gjuhës shqipe. Edhe në librin e përgatitur nga ajo përmendet Jeshar Zeneli, Demir Tasha, Hysen Tasha, Seit Tasha, Selman Jella, Ram Osmani nga fshati Bllacë, Tush Meta e Shahin Meta nga fshati Kovoshicë, të tjerë persona nga fshatrat e Grykës së Madhe si nga Sofraçani, Sopoti, Valikardha, Peladhia e Zerqani.

Në libër flitet edhe për periudhën që kryegjyshata bektashiane Botërore u largua nga Stambolli në fuqi dhe erdhi në shqipëri e u vendos në Tiranë në vitin 1926 në kohën e regjimit të Ahmet Zogut.

Në teqenë Bllacë ka pasur disa libra, shënime, ditare që përbënin fondin e një biblioteke të pasur, por në vitin 1967 kur u prish teqeja u morën dhe u grabitën nga njerëz të pandërgjegjshëm e kurioz librat fetarë, artistikë, materiale të tjera shkresore, historik, shënime të ndryshme me vlera historike, ekonomike, shkencore dhe edukative.

Disa nga bashkëkohësit kujtojnë se këto materiale u morën nga shokët e muzeut hsitorike të rrethit Dibër në Peshkopi, ku ishte dhe Haziz Ndreu nga qyteti i Peshkopisë. Në muzeun Historik të Peshkopisë pothuajse nuk ka materiale të tilla.

***Nga* XHELAL ROÇI**

REFERENCA:

1- Libri Shenjtor të Ehli Bejtit, faqe 134-135, shkruar nga Dervish Hysen Shehu.
2- Libri "Historia e Bababllarët e Teqes Martanesh", autor Baba Selimi, faqe 47.
3- Tregime gojore nga Ramiz Roçi në Sofraçan.
4- Libri i Baba Selimit, vepër e cituar, faqe 125, 126, 127
5- Libri i Baba Selimit, vepër e cituar, faqe 128.
6- Libri i Baba Selimit, vepër e cituar, faqe 128-145.
7- Libri Shenjtorët e Elhi Betit, faqe 135, vepër e cituar.
8- Libri Dede Ahmeti i gjallë mes nesh, shkruar nga Baba Selim Kaliçani, faqe 7-23.
9- Libri Shenjtroët e Eli Betit, faqe 136, vepër e cituar.
10- Monografia e Seit Najdenit (Hoxhë Voka) faqe 29, 30 dhe 80-81.
11- Tregime gojore nga Sul Osmani, Bllacë, kujtime nga i ati Ram Osmani.

Për përpilimin e këtij materiali janë studiuar këto dokumente:

1) Materiale në Muzeun Historik të rrethit Dibër.
2) Libri i shkruar nga Baba Selimi, Historia e Bektashizmit si sekt mistik islam.
3) Historia e Baballarët e teqes Martaneshit i shkuar nga i njëjti autor.
4) Dede Ahmeti i gjallë mes nesh. Shkruar nga Baba Selimi.
5) Libri "Seit Najdeni" (Hoxhë Voka), monografi.
6) Dibra në prah të historisë, dorëshkrim, shkruar nga Haki Stërmilli.
7) Tregime gojore nga Ramis Roçi, Sul Osmani e të tjerë.
8) Libri Kujtime nga autori Haki Sharofi.
9) Monografi Dervish Hima, shkruar nga Kristaq prifti.
10) Libri shenjtorët e Elhi-Betit, shkruar nga Dervih Hysen Shehu.

homazh

Ndërsa gazeta po shkonte për shtyp dhe ky shkrim ishte faqosur, morëm lajmin e hidhur të ndarjes nga jeta të z. Miftar Fana. Gjithashtu, u nda nga kjo jetë edhe miku ynë, poeti Naim Plaku. Redaksia u shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjarëve të të ndjerëve. Në numrin e ardhshëm do kemi një portret për mikun tonë, të paharruarin Naim Plaku.

Gjeneral **Miftar Fana,** medalionisti që i ndrit Korabit

Nga **MEVLUD BUCI**
Studiues-kulturolog-master



Një jetë me dritë, djersë e plot lavdi, një jetë që bleron fisnikëri për breznitë dhe kohërat, kurrë s'ka të shuar. Janë bëmat e provat, thjeshtësia dhe shpirtbardhësia, të cilat e lartësojnë njeriun në sytë dhe zemrat e cilitdo, në altarin e kohërave. Kështu të ndodh me Miftar Ramadan Fanën e Shumbatit, me birin e Dibrës e të llogoreve të atdheut, me këtë medialonist që i ndrit Korabit. Është vërtet sa e bukur dhe e thjeshtë, aq edhe e vështirë dhe e rëndë në shpirt të gdhendësh fjalë për Miftar Fanën. Përse? Njeri i vuajtjeve dhe i përkushtimit, i udhëve të vetmohimit, i pasionit për punën, i dritës për aftësimin; i respektit dhe mirënjohjes për familjen, fisin, vendlindjen, për shokët e miqtë intelektual virtuoz në shërbim të brezave, ushtarak i shquar e organizator i kudondodhur. Ka shumë kohë që e mbaj peng për të shkruar për Miftar Fanën, këtë burrë të urtësisë e fisnikërisë dibrane, për këtë pasionant të rrallë e prijsi të talentuar të radioamatorizmit shqiptar. Ashtu siç gdhendet në dëshmitë e dekorimeve, në faktet e madhështisë së punës shumë vjeçare Miftar Fana ka meritën e rrallë: "Për kontributin e padiskutueshëm në forcimin dhe zhvillimin e lëvizjes olimpike shqiptare dhe të sportit në shqipëri". (Asambleja e 15-të e KOKSH, Durrës, më 11 shtator 2011). Çdo dibran i thjeshtë e i nderuar, çdo shqiptar që krenohet me dritën e djersës e të diturisë ndjen krenari legjitime në shpirt për gjurmët e jetës e arritjet e Miftar Fanës. Me propozimin e Këshillit të Lartë të Sportit Shqiptar, me vendimin nr.91, datë 15 mars Presidenti i Republikës z. Alfred Moisiu, i ka akorduar z. Miftar Fana "Medalje Ari", "Nderi i Kombit", me motivacion: "Për kontribut të veçantë në zhvillimin e sportit dhe veçanërisht radioamatorizmin në veprimtaritë kombëtare e ndërkombëtare".

Miftar Fana pa mëdyshje, pa as më të vogëln hiperbolë mund të quhet dhe e meriton një legjendë e punës – një legjendë e radioamatorizmit, oficer akademik, president i federatës së radioamatorizmit, mjeshtër sporti, nderi i Dibrës dhe i Kombit. Pra, nisur nga bëmat e djersës e të diturisë, nga talenti e atdhetaria, nga nderimet e fituara nëpër vite me plot të drejtë e meriton nderimin e brezave të kohës. Gjenerali Miftar Fana është medalionisti që i ndrit Kombit.

Një dëshmi përjetësia e rrezatimi në kohëra është krahas të tjerave libri i Miftar Fanës.

"Të paharruarit" (kujtime), ku autori na jep modelin e gjurmëve të jetës, fisnikërisë për familjen, fisin, traditat, fëmijërinë e dashurinë për vendlindjen Shumbatin si dhe mirënjohjen e rrallë për të gjithë njerëzit në udhët e dijes përballë dallgëve të vështira të jetës. Të emocionon fakti se si në hyrje, në faqen 5 janë portretizuar dy prindërit e nderuar, ata që e sollën në jetë Miftarin, motrat e vëllezërit, dy pridnërit Dan e Meleqe Fana, foto ku gdhenden: Kafilja, Haziri, Havaja dhe Minushja (rreshti i parë) dhe rreshti i dytë: Mala, miftari, Shivari dhe Ismetja. Përsëri një foto emocionuese, një fakt njerëzor, përmallimi i fisnikërisë, një fakt njerëzor, përmallimi, fisnikërie në faqen 11 Hazizi, Zhazivari, Abazi, Xharia, Fatmira, Lekja me përparimin dhe Mynyrja, më tej Hazizi vëllai i Miftarit, Hazizi dhe Miftari (1989). Një pasqyrë malli e krenarie, një pasqyrë e shpirtit ku shprehet tradita e vyer familjare, gjithçka e thjeshtë, e bukur, e paharruar, e madhërishme e gjurmëlënëse. Studiuesi i talentuar Faik Ahmet Xhani (Lisus Dea) "Të paharruarit", e quan një libër homazh për njerëz me emër të mirë dhe kontribute të veçanta (f. 15).



Libri "Të paharruarit" – vijon studiuesi Xhani – është një kontribut shtesë i dibranit të nderuar Miftar Fanës, që ndriçon historinë e Sportit të Radioamatorizmit Shqiptar si pjesë xhevahiri në obeliskun e nderit të Sportit Shqiptar (f. 16).

Libri hapet me kullën e Fanajve, një relikë e dashur dhe e shtrenjtë. Në faqet e para shpërfaqet tradita, vlerat njerëzore të familjes, fisit, vendlindjes. I gjithë brezi im i Fanajve dhe më të rinjtë – shkruan Miftar Fana – duhet të jenë shumë krenarë për të parët tanë trima e bujarë. Ata kurrë nuk u bënë vegël e pushtuesit, përkundrazi kontribuan më së miri ndaj pushtuesve turq e serbë. Qysh në vitin 1470 i pari ynë Gjon Fana dhe nga viti 1530 Sejdi Fana u ndeshën dhëmbë për dhëmbë me pushtuesit turq dhe u bënë për to të padëshiraur e kundërshtarë të fortë. Edhe më vonë, babai im Ramadan Fana luftoi me guxim dhe trimëri kundër pushtuese osmanë dhe në vitet 1913-1917, 1920-1921 kundër pushtuesve serbë (f. 21). Libri i gjeneral Miftar Fanës është një testament i pasqyrimit të urtësisë, fisnikërisë dhe gjurmëve të jetës së familjes, fiset dhe njerëzve të mirë e të paharruar të vendlindjes. Autori Fana krenohet me gjurmët e jetës, që të cilën na e jep në shkrimin "Kur kthen kokën pas". Miftar Fana në këtë libër është edhe një kronikan i shquar i apsqurimit të gjenezës së fisit Fana, i përshkrimit të traditave të njerëzve të paharruar. Një zemër e madhe, një mendje e ndritur, një ballë i ndriçuar, një pendë dhe zemër e frymëzuar e krenare si kjo e Miftar Fanës bën që të gdhendën fakte, ngjarje, emra, portrete, mundime mençurie e vargje plot sens poetik, mesazhe e ide, të cilat u rrezatojnë udhëve të njerëzve të thjeshtë, udhëve të brezave tanë.

"Kam shumë dëshirë – shkruan Miftar Fana – që nëpërmjet këtyre kujtimeve t'ju lë trashëgim pasardhësve të mi të fisit Fana", rrënjët e fisit tim të hershëm. Qysh në kohën kur Shumbati quhej "Shënmateu", fisi Fana me përkëdheli e respekt kishte epitetin e "Ujkut", i cili zhduk kopenë sa hap e mbyll sytë. Fisi Fana, Luigi, Gjergji dhe Pali, bashkë me motrën Marie erdhën nga Xhuxha e Fanit dhe u vendosën në Perëndim të një maje, rreth Drinit të Zi. Me kalimin e kohës tre tre vëllezërit u ndanë. Pali mbajti bregun e Drinit që do të quhet Lugjaj, Gjergji mbajti mesin e tokës, midis Luigjit dhe Palit, të cilin e emëruan Xhuxhe që shtrihet tek mali Xhuxhe deri tek livadhi i Fanës në Zall-Kalis. Ndërsa, Pali mori tokat që ka fshati Palaman me emrin e tij. Maria, motra e madhe e tre vëllezërve u martua në Shënmateu (Shumbat) dhe lindi tre fëmijë. Sipas gojëdhënës njëri ishte Gjoni, që bashkë me nënën e tij, Marien, vulosën mbiemrin Fana, që sot e kemi me krenari ne që jemi pasardhësit e tyre" (f. 24). Gjenerali i radioamatorizmit, prijësi dhe kampioni i talentuar vendos bukur bedenat e kalasë së historisë së fisit, shkruan me urtësinë e dlirësinë e mendjes e të shpritit. Kronika e jetës më 1950 në PTT Dibër ku përshkruan mjeshtërisht në shkrimin "Si shtëpi e dytë dhe universitetet për mua", "Trokitje në mesnatë", "Në shkollën e bashkuar "Enver Hoxha", "Renkimet e Tomorrit" (në kujtim të shërbimit me gjeneral Petrit Dumën) "Gjenerali në kabinetin e radios", "Itifaku i vakëfit", "Mirënjohje për jetë njerëzve të dashur". Shkrime monument për traditat, vlerat njerëzore, udhët e jetës. Dëshmi të shpirtit hyjnor, të njeriut të sakrificave sublime në shkallët e dijes e të përkushtimit.

Shpërfaqin fotot e Mynyres (bashkëshortja e Miftarit, ndjesë pastë). Neshatit e Shkëlqimit (dy djemve fisnikë, thesarë siç i quan Dibra) dalë bashkë me Miftarin në vitin 1973 Mynyrja, neshati, Shkëlqimi dhe Miftari në vitin 1981, Neshati dhe Shkëlqimi më 1981, Shkëlqimi dhe Mynyrja më 1999. Foto që pasqyrojnë fisnikëri, gjurmë djerse, thjeshtësi e urtësi njerëzore. Gjithçka në foto e shkrime ka jetë, ka dritë, ka rrezatime bujarie, dhimbjeje, krenarie, ka dritë loti gëzimi, dritë shpirtrash të praruar. Në ceremoninë e 75 vjetorit të Miftarit, Defrim Methasani gazetari brilant dibran e mbarëkombëtar dhe mbesa Frenki Sokol Morina duke përshëndetur. Defrimi, Miftari, Lavdija, Xhevati, Neshati dhe Frenki... Sokol e Eli Morina, Lavdija, Miftari dhe Sabri Karoshi (f. 109).

Përshëndetjet e Gaqo Miçit, Hasan Çipurit, Ali Matës, Dr. Hasan Lekës (ndjesë pastë), Dukagjin Hata, Hasan shehu, Mevlud Buci, Alban Daci, Shaqir Skarra, Idriz Pasha, Stavri bello (mjeshtër sporti), Gjergj Vyshka, Ahmet Keça (ndjesë pastë) etj. Krahas albumit fotografik nga jeta e veprimtaria e z. Miftar Fana. E veçantë, kuptim plotë dhe mjaft domethënëse janë edhe 10 poezitë e krijuara me shpirt urtësie ku ... tonë saritike, mençuria e filozofia e vendlindjes dhe e Dibrës.

Miftar Fana – punëdashësi, shpirtdrita, njeriu i përkushtimit, ai që me sakrifica bëri epikë, ngjiti shkallët e dijes pa mëdyshje. Gjeneralit që i ndrit Korabit.

Miftar Fana i Dibrës, i fisnikërisë së brezave të atdheut tonë të shtrenjtë, të cilit falë bardhësisë e shpirtit, dritën e mendjes, shembullin si Nderi i Dibrës, Nderi i Kombit – sinonimi me Korabin e patundur nëpër dallgët e historisë. Urimi i përzemërt i Miftar Fanës është edhe për kryetarin e bashkisë Dibër, inxh. Ilir Krosi, këshillin bashkiak. Kurdoherë Miftar Fana i përfalet mirënjohjes. Ky është virtyti më burrëror, më i fisnikëruar. Ai meriton dhe gëzon nderimin e shokëve e të miqve, nderimin e Dibrës e të kombit ndaj është vërtet medalionisti e gjenerali që i ndrit Korabit.

Maj 2014

Homazh për mësuesin Elez Xheka



Më datë 3 qershor, populli i Gjoricës dhe i fshatrave përreth në Grykën e Vogël përcollën për në banesën e fundit veteran Elez Xheka.

Lindi më 3 prill 1935 në një familje patriote e njohur në luftën për liri, pavarësi e shkollë shqipe. Shkollën fillore e atë 7-vjeçare e mbaroi në Gjoricë e Shupenzë. Në moshë shumë të re filloi punë si mësues në vitet 1951-52 në Zogje, më '52-'53 në Tuçep, '53-'54 në Muhurr, '54-'55 në Okshatinë. Pas mbarimit të ushtrisë më 1956, punoi në kooperativën bujqësore si brigadier ku u dallua jo vetëm si organizator i punës por edhe si veprimtar shoqëror me organizatat e rinisë në fshat. Kjo përvojë dhe eksperiencë e nxiti të mbarojë shkollën e mesme pedagogjike, bashkë me institutin pedagogjik 2-vjeçar në degën kimi-biologji në Tiranë në vitin 1961.

Në vitet 1962-73 e gjejmë si drejtor i shkollës 7-vjeçare Shupenzë, drejtor zone në Grykën e Vogël, por edhe mësues në Gjoricë (1973-'80).

Kontributin si profesionist i arsimit, Elez Xheka e filloi në fshat nga lufta kundër analfabetizmit në forcimin e konsolidimin e arsimit fillor e zgjerimit e arsimit 7-vjeçar e të mesëm. Në historikun e arsimit për Grykën e Vogël me siguri do të radhitet krahas Jashar Zenelit, Haxhi Ademit, Abaz Xhafës, Hidër Manjanit, Fasli Camit, Hamit Manjanit, Zenel Çelës, Ramiz Lekës, Osman Patrisë, Emin Ruçit, Menduh Demës, Osman Lekës etj. Elez Xheka ishte një mësues model, çështjen e arsimit dhe shkollës e shikonte si mision dhe e vlerësonte si të tillë, prandaj erdhi përsëri drejtor shkolle në Shupenzë për 10 vjet të tjera (1980-1990).

Gjithnjë energjik në punë me përvojë të gjatë në arsim, ai u bë drejtues kompetent e serioz, shembull për brezin e mësuesve jo vetëm të Shupenzës, por edhe të Dibrës. Mijëra nxënës të Grykës së Vogël kanë njohur dhe ndjerë nga afër ndihmën, përkrahjen, këshillat dhe kujdesin e Elez Xhekës për të mësuar në shkolla të ndryshme të vendit tonë. I madh e i vogël kushdo që e ka njohur Elezin flasin me respekt e admirim për mësuesin e palodhur e të përkushtuar. Në sajë të kësaj pune në luftë me qëndrimet konservatore qindra djem e vajza mbaruan shkollat e mesme dhe të larta e sot punojnë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë sonë.

Elez Xheka ka pjesën e vet të kontributit për gjallërimin e jetës kulturore e sportive në shkollat, vatrat e shpitë e kulturës duke i parë gjithnjë si veprimtari të pandarë nga mësimi dhe mësuesin të pashkëputur nga fshati. Këto aty janë arsyet që atë e njohin të gjithë brezat fëmijë, të rinj e të moshuarit. Ai ndërtonte marrëdhënie të barabarta e të sinqerta, përpiqej të ndihmonte të gjithë, kishte një zemër të madhe e bujare.

Elezi ishte modeli i qytetarisë ,i kujdesshëm në veshje, sjellje, i matur, i dashur, me humor, krijonte marrëdhënie shumë dashamirëse me njerëzit, kishte vlera intelektuale, profesionale, humane dhe njerëzore.

Pas daljes në pension më 1991-2004, erdhi në Peshkopi, ndërsa nga 2004-2014 në Tiranë. Me gjithë respektin dhe dashurinë që e rrethonin Elez Xhekën, kudo ku ka punuar e jetuar ai asnjëherë nuk e ka harruar vendlindjen Gjoricën. Kam mall dhe e dua Gjoricën, shprehej gjithnjë Elezi. Kjo ishte e vërtetë, por edhe Gjorica e deshi atë. Në prill 2012 Elez Xhekën komuna e shpalli "Qytetar Nderi" të saj.

Jeta dhe vepra e Elez Xhekës është luftë dhe punë për forcimin dhe përparimin e shkollës, begatinë e fshatit dhe jetën e begatë të gjeneratave që do të vijnë.

Shembull frymëzimi brez pas brezi.

Elmas Lala, Nazmi Koçi, Laze Dauti, Ismet Abdiu,
Emin Cami, Bukurie Kaja, Osman Patria,
Islam Uka, Ukë Deda, Zabit Lleshi

Megjithëse prania e përfaqësueses së zemrës të tifozëve shqiptarë në Kupën e Botës Brazil 2014 mbeti një ëndërr e parealizueshme, të paktën deri tani, janë tifozët shqiptarë ata që nuk mungojnë në Brazil - por mbi të gjithë janë 7 yje me gjak shqiptari që luajtën për tre shtete të tjera në këtë kampionat.

Dibra në Brazil





- **Lojtarët shqiptarë të Zvicrës, Admir Mehmedi dhe Granit Xhaka, u dhuruan bluzat e tyre dy tifozëve dibranë në stadiumin Amazonia Arena në Manaus dhe marrin prej tyre flamurin kuq e zi...**
- **Në mesin e dhjetëra shqiptarëve në Brazil dhe aty ku luajnë shqiptarët - u ndodhën edhe dy vëllezërit nga Dibra, Gazmend dhe Afrim Kërkurti. Ata kanë përjetuar si kurrë ndonjëherë një nga gëzimet e krenarisë shqiptare...**

Nga **BEQIR SINA**

Shqipëria, emri i saj - flamuri, simbolet tona kombëtare, dhe natyrisht adhuruesit e futbollit për herë të parë, në historinë e shqiptarëve, nuk kanë qenë ndonjëherë kaq të pranishëm në një ngjarje gjigande Botërore. Kupa e Botës - Brazil 2014, sa ajo e 7 futbollistëve, 7 yjeve me gjak shqiptar që shkëlqyen në kampionatin botëror

Pjesëmarrja me 7 futbollistë, shqiptarë, të cilët bota e futbollit i ka cilësuar - cilësorë, shqiptarët në tri kombëtare, të cilat janë në 16 skuadrat më të mira të Kupës Brazil 2014 (Zvicëra: Xherdan Shaqiri, Valon Behrami, Admir Mehmedi, Blerim Xhemaili dhe Granit Xhaka - Gjermania Shkodran Mustafi dhe Belgjika: Adnan Januzaj) por, edhe nga prania sado e vogël e tifozëve shqiptarë, që kanë fluturuar për në Brazil, vetëm për të parë shqiptarët, e kanë ngritur në "kup të qiellit" krenarinë shqiptare.

Madje tash shqiptarët kan edhe një futbollist që ka hyrë në librin e historisë së Federatës Botërorë të Futbollit.... Xherdan Shaqiri, është lojtari i parë - shqiptarë në historinë e futbollit që arrinë të shënoj 3 gola në kampionate Botërorë .... Një moment historik si për Helvetët ashtu edhe për ne tifozët shqiptarë kudo që frymon shqiptarizmi. .... Xherdan Shaqiri zhvilloi një ndeshje spektakolare me kombëtaren e Zvicrës në ndeshjen me Hondurasin sa mahniti botën.


Në mesin e dhjetëra shqiptarëve në Brazil dhe aty ku luajnë shqiptarët - u ndodhën edhe dy vëllezërit nga Dibra, Gazmend dhe Afrim Kërkurti. Ata kanë përjetuar si kurrë ndonjëherë një nga gëzimet e krenarisë shqiptare, pas ndeshjes Zvicër - Honduras, e cila përfundojë me fitoren e helvetëve 3:0 me tre gola të yllit të futbollit Xherdan Shaqirit

"Ishte, një nga momentet më të bukura, shkruajnë ata në një postim në rrjetin social facebook, që përjetuam këtu në Brazil, dhe që asnjëherë s'do t'a harrojmë, ishte rasti kur Admir Mehmedi dhe Granit Xhaka na dhuruan fanellat e tyre. Ata na gjetën në mes të 41.000 spektatorëve, ngaqë në dorë po valëvitnim flamurin kombëtar shqiptar, flamurin kuqezi me shkabën e zezë me dy krena - dhe zemra, shpirti dhe gjaku shqiptar që u vlon nëpër vena, i drejtoi ata drejt flamurit tonë."

Fotoja ku Granit Xhaka ndërron bluzën e tij të Zvicrës me flamurin shqiptar që mban Afrim Kërkuti në dorë, është fiksuar edhe nga fotografët e agjensicë së lajmeve AFP.

Megjithëse, edhe pse prania e përfaqësueses së zemrës së tifozëve shqiptarë në Kupën e Botës Brazil 2014 - pra Kombëtares së Shqipërisë , mbetet një ëndërr e pa realizueshme, të paktën deri tani, janë tifozët shqiptarë ata nuk mungojnë në Brazil - por mbi të gjithë janë 7 yje me gjak shqiptari, që luajnë, për tre shtete të tjera në Brazil.

Vëllezërit Kërkuti janë edhe dy lexues të rregullt të gazetës "Rruga e Arbërit". Afrimi na ndjek çdo muaj nga Dibra e Madhe, ndërsa Gazmendi është një bashkëpunëtor i rregullt i gazetës, me foto dhe materiale, dhe gjithashtu një prezantues shumë i mirë i Dibës dhe Rrugës së Arbërit në rrjetet sociale: me foto dhe video të mrekullueshme, që na e sjellin Dibrën e mirë dhe të bukur, pa kufinj, në çdo cep të globit.



"Gjimnazi Maqellarë, në ceremoninë e shkëlqyer dhe të rrallë që organizuan me rastin e diplomimit të maturantëve, nderuan me çmim mirënjohje edhe gazetën "Rruga e Arbërit" me motivacionin: "Për përhapjen e jehonës së Gjimnazit Maqellarë në hapësirat shqiptare dhe kullë transmetimi në Univers. Ne besojmë, se misionin e shenjtë e kryeni me nder dhe përgjegjësi të plotë. Urimet më të mira për suksese në arritjen e qëllimeve fisnike".
Drejtori: Gëzim Qoku. Maqellarë, 1 qershor 2014.

Mirënjohje nga Haxhi Maqellara

Dua të falënderoj pronarët e Restorantit "SHOQERIA' kushëririn tim Gaz Tominin së bashku me Tan Pecin të cilët më kanë ofruar një ambient të ngrohët dhe ku unë e ndjeja veten si në familjen time. U jam atyre e theksojë përjetësisht mirënjohës. Dua të falënderoj dhe deputetin e partisë çame, mikun tim z. Tahir Muhedini, për përkrahjen dhe angazhimin e tij- për dhënien e këtij titulli. Gjithashtu, dua të falënderoj Kryetarin e Peshkopisë Z.Ilir Krosin për akordimin e titullit "Nderi i kulturës Dibrane" mikun tim, drejtorin e Pallatit të kulturës së Peshkopisë z.Veli Vraniçin dhe kompozitorin e madh dibran z. Përparim Tomçini, duke qenë edhe atyre përjetësisht mirënjohës.

Në mbrëmjen Gala kur mora titullin e nderit të Tiranës, unë dua që ti falënderoja, edhe shokët e miqtë e mi. Në radhë të parë zotin Lulëzim Masha President i Institutit arsimor Uillson në Tiranë, i cili ka sakrifikuar për dhjetë vitet e fundit, jashtëzakonisht shumë së bashku me familjen e tij dhe shokët e tij, për shoqatën dhe unë e falëmderoj jashtë mase, dhe urojë që perëndia dhe Zoti i madh të lëshojë bekimin ndaj tij dhe familjes së tij.

Gjithashtu dua të falënderoj dy miqtë e mi të shtrejtë, poetin e madh Jorgo Papingji edhe kompozitorin Edi Balili, si dhe kompozitorin Saimir Çili, sepse edhe puna e tyre, profesionale më çuan deri tek marrja e këtij titulli të lart.

Njëkohësisht, dua të falënderojë edhe kryetarin e Shoqatës Tirana – zotin Arben Tafaj, i cili pati mirësinë të më ftoj në "Sofrën e Tiranës 2007", ku më dhanë mirënjohjen e asaj shoqate. Dhe duke dhënë propozimin nga ana e shoqatës në Këshillin e Bashkisë së Tiranës, për marrjen e titullit :"Mirënjohje e Qytetit të Tiranës", shfrytëzojë rastin t'ju shpreh edhe një herë atyre falënderimet për këtë mirënjohje, që ish Kryetari e Këshillit të Bashkisë së Tiranës zotin Njazi Kosovrasti dhe të gjithë anëtarët që votuan unanimisht në marrjen e titullit.



Një falënderim të veçantë ruaj në zemrën time dhe të familjes time për Shoqatën Atdhetare Dibra, për vlerësimin që më bënë në këtë 101 vjetor të pavarësisë së Shqipërisë me certifikatën "MIRENJOHJE DIBRANE". Por, një falënderim të posaçëm me këtë rast rezervoi edhe për kryetari i Bashkisë së Dibrës së Madhe, magjistër Ruzhdi Lata. Ka qenë ai që më ka përkrahur dhe mbështetur gjithmonë, por jo vetëm mua por edhe të gjithë artistët dibranë. Këtu në Amerikë falënderimet e para i takojnë familjes sime të ngushtë, bashkëshortes sime Fatbardhës dhe fëmijëve, nuses dhe nipit tim Eduartid, të cilët më kanë përkrahur vazhdimisht.

Dëshirojë të falënderoj gjithashtu edhe një nga bashkëpunëtorët e mi të ngushtë këtu në Amerikë, artistin e madh Edi Xhani, me të cilin kam bashkëpunuar një kohë shumë të gjatë dhe instrumentistët e Grupit Fisnikët. Si dhe Shoqatën Atdhetare "Dibra", e cila më ka sjellë një kënaqësi të veçantë.

cyan magenta yellow black